

Të bindur
në fitore



FAQE 2

Konkursi,
rregulla dhe
kritere të reja



FAQE 4

Të stimulohet
teknologjia
informatike



FAQE 5

Filloristët
bëhen
"shoferë"



FAQE 7

Koha

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3186 • E hënë 2 tetor 2017 15 DEN



Klubi nga ku
dalin futbollist
të njohur

FAQE 12-13



Dy milionë banorë, 1.8 milionë votues

Shkup, 1 tetor - Shkup, 1 tetor - Në zgjedhjet lokale më 15 tetor, të drejtën e votës e kanë më shumë 1.8 milion banorë nga rreth dy milionë sa ka Maqedonia, sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës. Ky numër më nuk u bën përshtypje partive politike, të cilat gjatë

zgjedhjeve të parlamentare të dhjetorit të vitit të kaluar zhvilluan polemika e debate të shumta në lidhje me numrin e votuesve. Lidhja Social-Demokrate e Maqedonisë, që tani është në pushtet, për disa muaj me radhë pati mbajtur peng Listën e votuesve me pretendimet

se ajo nuk pasqyron numrin real të votuesve, apo se numri i votuesve nuk mund të jetë më i lartë se 1.5 milion shtetës. Kjo kishte bërë që lista të pësonte ndryshime duke larguar nga e njëjta më shumë se 30 mijë votues që dyshoheshin për të dhëna...

FAQE 3

Ligji për amnisti miratohet pas zgjedhjeve lokale

Rreth 600 shqiptarë pritet të amnistohen



Duke ju referuar burimeve brenda institucioneve ndëshkuese përmirësuese, nga burgu i Idrizovës pritet të amnistohen rreth 477 shqiptarë, nga ai i Shutkës 36, nga burgu i Tetovës 51, pastaj nga burgu i Strugës 25 të burgosur shqiptarë, nga Prilepi 15, nga Kumanova 29 të burgosur, nga Manastirit shtatë dhe nga burgu i Shtipit 11 shqiptarë, të cilën e vuajnë dënimin me burg

FAQE 4

Fabrikë pa shqiptarë në fshatin shqiptarë



Manastir, 1 tetor - Edhe burimet, edhe fabrika për eksploatimin dhe përpunimin e ujit mineral "Pelisterka" i njohur në tregun të vendit dhe jashtë tij, gjendet mu në qendër të fshatit shqiptarë Mexhitli, fshat ky vetëm pesëqind metra larg kufirit dhe pikë-kalimit kufitar me Greqinë fqinje. Eksploatimi i

kësaj pasurie natyrore ka filluar diku në vitet e largëta të gjashtëdhjetës, fillimisht me teknologji primitive, pastaj me teknologji moderne. Falë cilësisë së lartë, uji i këtyre burimeve pushtoi tregjet në vend, por dhe jashtë vendit. Fabrika punon 24 orë në ditë pandërprerë, proces ky që ka imponuar edhe numër të

dukshëm të të punësuarve e që arrin diku rreth pesëdhjetë. Dikur në këtë kapacitet industrial kanë punuar edhe shqiptarë nga fshati Mexhitli, të cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në ruajtjen e kapacitetit gjatë turbullirave që ndodhën në kohën e privatizimit të pronës shoqërore...

FAQE 7

IGLOBI

Kërkesat për pavarësi në Evropë janë të mëdha



Në gjysmën lindore të Evropës shpërbërja e Bashkimit Sovjetik dhe e ish-Jugosllavisë kanë bërë që të krijohen shumë shtete të reja. Në Evropën Perëndimore në të kundërt duket se shtetet e vjetra nacionale janë të konsoliduar prej kohësh...

FAQE 17

NË FOKUS

Si përfunduan armët e Skënderbeut në Vjenë?

FAQE 8

SPECIALE

Sa makiavelist ishte vetë Nikolo Makiaveli?

FAQE 19

PROFILE

Zotëria që shpëtoi botën



FAQE 19



BDI, ASH dhe BESA vlerësojnë fushatën dhe pritjet nga zgjedhje

Të bindur në fitore



Ahmeti: Stop përçarjes së votës, bashkë jemi më të fortë

Shkup, 1 tetor - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, në kuadër të bashkëbisedimit me anëtarë, simpatizantë të partisë si dhe me qytetarë, qëndroi në Komunën e Bërvenicës me ç'rast arsyetoi qëndrimin e BDI-së që në këtë komunë të konkurrohet vetëm me listë këshilltarësh e të mbështetet kandidati i pavarur, Enver Pajaziti. "Ne vlerësuam se bolla shqiptarët copëtohen. Ne nuk deshëm të jemi pjesë e copëtimit. Tash e sa kohë ne po bëjmë thirrje për bashkimin e shqiptarëve, sepse të copëtuar vërtet dobësohen, nuk janë të rëndësishëm. Ne nuk dëshiroam të jemi në shërbim të fragmentarizimit të votës së shqiptarëve", tha lideri i BDI-së duke siguruar të pranishmit se BDI do të çojë përpara projektet për investime në infrastrukturën rrugore, atë shkollore, për zgjidhjen e problemit të ujërave të zeza si dhe të ujtitjes, edhe në këto anë dhe përgjithësisht në Rrafshin e Pollogut. Kreu i BDI-së, me këtë rast u është përgjigjur shqetësimeve të ngritura nga qytetarët lidhur me disa probleme aktuale, në radhë të parë lidhur me arsimin.

Sipas tij, cilësia në arsim është shqetësim në nivel kombëtar dhe duhet bërë çmos për avancimin e arsimimit, duhet të kemi qasje serioze për rritjen e cilësisë në të gjitha shkallët e shkollimit - nga ai fillor e deri në atë të lartë, duke siguruar edhe bursa sidomos për krijimin e kuadrit arsimor fillor. Ndërkaq, i pyetur për zvarritjen e regjistrimit të popullsisë, kryetari BDI-së, Ali Ahmeti, tha se çështja është problematizuar dhe politizuar pa nevojë. Tendencat e qarqeve nacionaliste për uljen e përqindjes aktuale të shqiptarëve, Ahmeti i cilësoi si synim për të vënë në dyshim Marrëveshjen e Ohrit që ka të bëjë me entitetin që ka mbi 20 për qind, tha ai duke bërë publik angazhimin që në Entin Shtetëror të Statistikës të përfshihen edhe ekspertë shqiptarë - në sektorin e përpunimit të të dhënave, në mënyrë që ato të jenë të besueshme.

Si BDI, ashtu dhe ASH - atmosferën e llogarisin pozitive dhe deri në fund shpresojnë se fushata do të kalojë pa incidente, ndërsa sa i përket fitoreve - këto dy parti shpresojnë të fitojnë në disa komuna që në rrethin e parë. Fitore në shumicën e komunave shqiptare presin edhe nga Lëvizja BESA

Koha **Fatos RUSHITI**

Shkup, 1 tetor - Fushata parazgjedhore po hyn në fazën më të nxehtë të saj kur partitë kanë përqendruar maksimalisht forcat në terren për të bindur qytetarin shqiptar për dhënin e votës. Por cilat janë vlerësimet partive politike shqiptare për rrjedhën e fushatës deri më tani dhe cila janë pritjet reale në këto zgjedhje sa i përket fitoreve në komunat shqiptare. Si BDI ashtu dhe ASH, atmosferën e llogarisin pozitive dhe deri në fund shpresojnë se fushata do të kalojë pa incidente, ndërsa sa i përket fitoreve - këto dy parti shpresojnë të fitojnë në disa komuna që në rrethin e parë. Fitore në shumicën e komunave shqiptare llogarisin edhe nga Lëvizja BESA, duke shpresuar se sovran, siç thonë nga BESA, do të thotë PO për Bilall Kasamin në Tetovë dhe PO për Zeqirja Ibrahimin në Çair. Në BDI vlerësojnë se fushata parazgjedhore deri më tani është pozitive dhe demokratike, ndërsa përcaktimi fillestar i kësaj partie nga kontaktet e drejtpërdrejta me qytetarët po jep frytet e veta dhe shpresojnë që kjo frymë pozitive të shkojë deri në fund të fushatës. "BDI vlerëson se fushata parazgjedhore po kalon në një atmosferë të qetë dhe pozitive, kur ne si parti kemi ofruar kandidatët më të mirë që kanë përvojën e duhur dhe vizionin e qartë për zhvillimin e komunave shqiptare, gjë që nuk mund ta vërejmë dhe tek rivalët politikë. Shpresojmë që kjo frymë pozitive të shkojë deri në fund të fushatës dhe urojmë që zgjedhjet të mbahen



pa incidente. Përcaktimi i ynë fillestar për fushatë të drejtpërdrejtë me qytetarët tanimë po jep frytet e veta duke parë një interesim të madh të qytetarëve për të dialoguar me kandidatët tanë për kryetare komune. Të njëjtit, pra kandidatët - mbajnë shënime në çdo takim duke evidentuar pikë për pikë brengat dhe problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët dhe duke u zotuar se do t'ua zgjidhin ato gjatë mandatit të ri katërvjeçar", theksoi zëdhënësi i Shtabit zgjedhor të BDI-së, Arbër Ademi. Lidhur me kritikën e partive tjera se gjatë mandateve të kaluar jo të gjithë kryetarët e komunave nga BDI kanë realizuar ato që kanë premtuar, Ademi thotë se qytetarët janë koshient dhe dinë të ndajnë, siç u shpreh ai, të përgjegjshmit dhe punëtorët nga ata që përhapin gënjeshtria dhe dezinformata. Ademi shton se të gjitha të arriturat e BDI-së në pushtetin lokal mbajnë vullën e kryetarit Ali Ahmeti. "Qytetarët janë koshient dhe dinë të na dallojnë prej të tjerëve, prej atyre që gënjejnë dhe japin dezinformata se ne nuk kemi realizuar ato që kemi premtuar. Hidhni një sy komunave shqiptare dhe do të shihni se aty tashmë kanë ndërëruar fizionomi në çdo pikëpamje. Kjo, si rezultat i njerëzve të përgjegjshëm të BDI-së që kanë udhëhequr me ato komuna. Çdo sukses i BDI-së në çdo komunë mban edhe vullën e kryetarit Ali Ahmeti. Diku me shumë diku ndoshta jo aq sa është dashur, po çdoherë është punuar në të mirën e përgjithshme kur kanë përfituar qytetarët shqiptarë", tha Ademi. Sa i përket pritjeve të BDI-së në këto zgjedhje, Ademi thotë se BDI që në rrethin e parë

do të shihet fituese duke fituar me Kërçovën, Dibrën, Sarajin dhe Zhelinën. Nga Aleanca për Shqiptarët, shefi i Shtabit, Elmi Aziri, thotë se partia e tij angazhohet për një fushatë të qetë dhe pa incidente, duke shtuar se strukturat e ASH dhe anëtarësisë së gjerë nuk janë të prirur drejt dhunës dhe dezinformatave si partitë tjera. Aziri siguron se struktura e ASH-së po punojnë që procesi zgjedhor të kalojë në një atmosferë evropiane dhe demokratike. "Ne si ASH angazhohemi maksimalisht çdo ditë që fushata parazgjedhore të kalojë e qetë dhe pa incidente. Përkundër qëndrimin tonë se do të jemi korrekt në të gjitha format e paraqitjes gjatë fushatës, këtë nuk e shohim edhe tek partitë tjera duke u marrë me dezinformata dhe tentime ta bindin opinionin se këto dhjetë vite gjithçka ka qenë në rregull, kur realisht nuk ka qenë sa i përket zhvillimit të komunave shqiptare. Ne nuk jemi të prirur drejt dhunës dhe provokimeve, por strukturat tona partiake dhe anëtarësia e geërë punojnë në atë drejtimin që procesi zgjedhor të kalojë në një atmosferë sa demokratike po aq dhe evropiane", tha Aziri. Sa përket pritjeve të ASH në këto zgjedhje, Elmi Aziri thotë se që nga Konventa në Tetovë, në partinë e tij ka një interesim të madh që ti bashkëngjiten Aleancës për Shqiptarët jo vetëm të rinjtë, por edhe shumë intelektualë. Në ASH, Aziri thotë se shpresojnë që ky trend i interesimit për këtë parti të vazhdojë deri në fund, duke çuar ASH-në drejt fitores që në rrethin e parë edhe atë në disa komuna, mes tyre dhe dy nga qytetet kryesore të Maqedonisë Perëndimore. Por fushata parazgjedhore nuk

ka shkuar pa probleme deri më tani. Të shtunë në mbrëmje është thyer dhe demoluar shtabi i Lëvizjes BESA në Komunën e Butelit. Nga kjo parti kanë reaguar të dielën gjatë një konference për shtyp, duke dënuar një rast të tillë dhe duke u kujtuar partive tjera nënshkrimin e Deklaratës në KSHZ për zgjedhje fer dhe demokratike. "Pas vandalizmit të mbrëmshëm nga persona të papërgjegjshëm, me ç'rast u thyen xhamat e zyrës të Lëvizjes BESA në Butel, Lëvizja Besa shpreh shqetësimin e thellë lidhur me këtë akt barbar që bëhet nga persona të papërgjegjshëm dhe dashakeq. Ju kujtojmë këtyre personave si dhe porositësve të tyre se nëpërmjet këtyre veprimeve, ato vetëm edhe njëherë e tregojnë fytyrën e vërtet të tyre, të jotolerancës ndaj të gjithë të tjerëve, si dhe i porosisim që veprimet e këtilla neve si parti nuk na dëmtojnë aspak, por përkundrazi - ndikojnë te ne që të punojmë dhe angazhohemi edhe më tepër që këto keq-bërës njëherë e përgjithmonë ti largojmë nga skena politike shqiptare, si dhe t'ia kthejmë këtij populli të përvojatur lirinë në plotkuptimin e fjalës të humbur qe 15 vjet", thanë nga shtabi lokal zgjedhor në Butel i Lëvizjes BESA. Nga kjo parti theksojnë se do të vazhdojnë me fushatën e tyre pozitive dhe se janë të vendosur ti shërbyjnë vetëm popullit shqiptar. Ndërkaq sa i përket pritjeve në këto zgjedhje, nga Shtabi qendror zgjedhor thonë se fitorja e BESËS po shihet në sfond dhe se kjo fitore ka alarmuar qarqet antishqiptare për ta dëmtuar së të mundem deri në votime. "Ashtu siç korrëm fitore në zgjedhje parlamentare, edhe në zgjedhje lokale BESA do të fitojë shumicën e komunave shqiptare dhe kjo fitore prej tash po shihet në sfond. Fitorja e BESËS ka alarmuar BDI-në, por ajo s'do mundet ta pengojë atë meqë sovran do ta thonë fjalën e vetë më 15 tetor edhe atë do të thotë PO për Bilall Kasamin në Tetovë, PO për Zeqirja Ibrahimin në Çair dhe PO për kandidatët e BESËS në të gjitha komunat tjera", thonë nga Shtabi Qendror i Lëvizjes BESA.

Gruevski në Gostivar

Do të vazhdohet me vepra akoma edhe më të mëdha

Gostivar, 1 tetor - Përgatitëm dokument, erë të re për dhjetëvjeçarin e ardhshëm, pasi që kjo errësirë që e solli LSDM-ja do të largohet, ndërsa kjo do të ndodhë në zgjedhjet lokale në të cilat populli do ta japë mendimin e tij për kryetarë të komunave dhe këshilltarë", deklaroi sot në tubimin e Koalicionit të

kryesuar nga VMRO-DPMNE-ja të mbajtur në Gostivar, lideri i partisë Nikolla Gruevski. Qytetarët e Gostivarit, siç tha, përmes votës së tyre të dhënë për kandidatët e Koalicionit do të përzgjedhin që të vazhdojnë të ndërtojnë shtetin e përbashkët, shoqërinë në të cilën qytetarët do të jetojnë në harmoni dhe paqe, pa

ndarje, urrejtje, me respekt reciprok. Era e re, siç shtoi Gruevski do të vazhdojë me projekte më të mëdha dhe vepra më të mëdha: kopsht të ri për fëmijë, ndërtimin e një stacioni për qentë endacakë dhe dislokimin e depozitës së shumëllojshme të tjerë dhe prandaj është shumë e rëndësishme që më 15 tetor të gjithë të

dalin me përkrhaje për erën e re në Gostivar. Kandidatja për kryetare e komunës së Gostivarit nga Koalicioni i kryesuar nga VMRO-DPMNE-ja, Dafina Stojanoska vlerësoi se ka ardhur koha për përzgjedhje midis atyre që i krijuan problemet dhe atyre që qëndrojnë pas premtimit të dhënë.





Sela në Zvicër me diasporën shqiptare



Lideri i Aleancës për Shqiptarët Ziadin Sela se bashku me bartësin e listës për Këshillin e Strugës, Ymer Ymeri, zhvilluan një takim me mërgatën shqiptare në Winterthur të Zvicrës. Vizita e tij u prit mjaft me interesim, ku ta pranishmit parashtruan pyetje jo vetëm për zgjedhjet lokale por edhe për situatën politike, duke i premtuar Ziadin Selës mbështetje të pa rezerve.

Sela nga mërgimtarët shqiptarë në Zvicër është cilësuar si shpresa e vetme e artikullimit të kërkesave të shqiptarëve që kanë të bëjnë me barazinë dhe perspektivën politike, zhvillimore dhe integruese të shqiptarëve.

Kasami: Do ta zgjidhim problemin me deponinë



Kryetari i Lëvizjes BESA dhe kandidat për kryetar të Komunës së Tetovës, Bilal Kasami në konferencë për shtyp në selinë e partisë në Tetovë foli për zgjidhjen e problemit me hedhurinat i cili është një ndër kryesorët me të cilat po përballën tetovarët. "Ne si Lëvizje Besa kemi zgjidhje për mjedis të pastër në qytet dhe komunë dhe kemi angazhuar ekip të ekspertëve sloven me çfarë do ta zgjidhim problemin edhe me deponinë dhe me ndotjen. Planifikojmë riorganizim të ndërmarrjes komunale publike që të mundet të punësuarit t'i mbledhin të gjitha hedhurinat, për çfarë fillimisht u duhen paga përkatëse dhe pajisje me mekanizëm përkatës dhe nevoja të tjera. Ndërtim të kapacitetit për selektim të hedhurinave me ç'rast një pjesë e kësaj do të shfrytëzohet si repromaterial për industrinë. Dhe si pikë e fundit - parashikojmë edukim të popullatës në pikëpamje të hedhjes së mbeturinave dhe trajtimin e tyre. Ne kemi strategji afatgjatë për këtë problem që parashikon zero ndotje në Tetovë, ndërsa me të edhe mjedis më të pastër dhe jetë dinjitoze për qytetarët", tha Kasami.

Lika: Na duhet krahu i të gjithëve



Në Tearcë u mbajt takim me simpatizantët dhe mbështetësit e BDI-së ku të pranishëm krahas liderit të BDI-së, Ali Ahmeti ishte edhe zëvendëskryeministri për sistem politik dhe implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, Hazbi Lika. Në këtë takim me elektoratin në komunën e Tearcës, Lika ka thënë se BDI-së i duhet mbështetja e të gjithëve. "Na duhet krahu i të gjithëve që të çojmë proceset përpara", ka deklaruar mes të tjerave në fjalimin e tij para të pranishmëve në Tearcë, zëvendëskryeministri Lika.

Dauti premtonte hapjen e bulevardit "Bllagoja Toska"



Kandidati i PDSH-së për kryetar të Komunës së Tetovës, Bardhyl Dauti, së bashku me kandidatët për këshilltarë komunal si dhe me anëtarët e shtabit të degës - Tetovë, vizituan bulevardin "Bllagoja Toska" në Tetovë.

Dauti siç njofton Zyra për Informim e PDSH-së, theksoi se ekipi i tij ka plan konkret për hapjen e këtij bulevardi të rëndësishëm i cili, siç thotë, është lënë pas dore nga pushteti lokal, gjegjësisht, me vende për parkingje, si dhe me ndriçim publik, që ndjeshëm do ta lehtësojë trafikun e ngarkuar dhe kaotik në Tetovë.

(ekipi i gazetës KOHA)

Ndryshe nga një vit më parë, kur LSDM mbajti peng Listën zgjedhore, tani kjo parti, sikurse dhe të tjerat, nuk kanë bërë asnjë reagim për listën e votuesve që është miratuar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. E derisa partitë heshtin, njohësit e çështjeve politike dhe juridike vlerësojnë se lista nuk pasqyron realitetin pasi, sipas tyre, është absurde të mendohet se nga 2 milionë banorë, më shumë se 1.8 milion të kenë të drejtë vote

Shkup, 1 tetor - Në zgjedhjet lokale më 15 tetor, të drejtën e votës e kanë më shumë 1.8 milion banorë nga rreth dy milionë sa ka Maqedonia, sipas të dhënave të Entitetit Shtetëror të Statistikës. Ky numër më nuk u bën përshtypje partive politike, të cilat gjatë zgjedhjeve të parlamentare të dhjetorit të vitit të kaluar zhvilluan polemika e debate të shumta në lidhje me numrin e votuesve. Lidhja Social-Demokrate e Maqedonisë, që tani është në pushtet, për disa muaj me radhë pati mbajtur peng Listën e votuesve me pretendimet se ajo nuk pasqyron numrin real të votuesve, apo se numri i votuesve nuk mund të jetë më i lartë se 1.5 milion syresh. Kjo kishte bërë që lista të pësonte ndryshime duke larguar nga e njëjta më shumë se 30 mijë votues që dyshoheshin për të dhëna jo të sakta, ndërsa rreth 200 mijë të tjerë ishin vendosur në një vend të posaçëm të listës zgjedhore, pasi mendohej se ata janë shtetas, por që ndodhen jashtë vendit me punë të përkohshme. Tani kjo parti, sikurse dhe të tjerat, nuk kanë bërë asnjë reagim për listën e votuesve që

Asnjë ndryshim në Listën zgjedhore



Dy milionë banorë, 1.8 milionë votues!

është miratuar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. E derisa partitë heshtin, njohësit e çështjeve politike dhe juridike vlerësojnë se lista nuk pasqyron realitetin pasi, sipas tyre, është absurde të mendohet se nga 2 milionë banorë, më shumë se 1.8 milion të kenë të drejtë vote.

"Kjo lë hapësirë për dyshime se lista zgjedhore nuk është e pastuar sa duhet dhe se do të ketë numër shumë më të madh të votuesve se sa që duhet të jenë realisht. E gjithë kjo është pasojë e pengesave dhe manipulimeve të ndryshme që e bëjnë të pamundur që ky proces të përfundojë një herë e përgjithmonë, që të kemi një qasje reale ndaj këtij problemi të ndjeshëm, që, vazhdimisht, që nga vendosja e pluralizmit, është përdorur për manipulime të ndryshme", thotë Temelko Risteovski, profesor në Fakultetin Juridik në Universitetin FON të Shkupit.

Xhelal Neziri, njohës i çështjeve politike dhe drejtues i Qendrës për

gazetari hulumtuese, thotë se lista e papastuar zgjedhore, hap dyshime për rezultatin zgjedhor. Ai konsideron se nuk do të ketë parti, e cila do t'i humbë zgjedhjet dhe për këtë të mos e fajësojë listën zgjedhore. Neziri vlerëson se listë zgjedhore reale është vështirë të ketë, pa regjistrimin e popullsisë, proces ky që nuk po mund të zhvillohet tani dhjetë vjet. "Me një listë zgjedhore të papastuar, të paazhurnuar, do të shkohet në zgjedhjet lokale dhe natyrisht se kjo do të sjellë shumë dyshime për rezultatet që do të dalin. Nuk besoj se do të ketë parti që do t'i humbë zgjedhjet në komuna të caktuara e që nuk do të drejtojë gishtin apo nuk do ta hedhë fajin te manipulimi me listën e votuesve, ndërkohë që KSHZ-ja nuk mund të bëjë asgjë më tepër pa pasur një regjistrim të qartë të popullsisë", vlerëson Neziri. Ai shton se në një situatë të tillë mbetet që procesi zgjedhor të paktën t'i nënshtrohet një monitorimi më të madh nga ana e organizatave joqeveritare që mer-

ren me këtë proces, por edhe nga vëzhguesit ndërkombëtarë. Lista zgjedhore, sipas ish-anëtarit të KSHZ-së, Aleksandar Novakovski, mund të ketë pësuar ndryshime, duke marrë parasysh vërejtjet e OSBE-së, por, kjo sipas tij, vështirë të ketë rritur besimin në opinion për një listë zgjedhore reale.

"Më duhet të them se numri i votuesve për zgjedhjet e kaluara parlamentare dhe zgjedhjet e tanishme lokale, ka një dallim shumë të madh. Besoj se numri i madh i votuesve që janë futur në listë, është bërë pas rekomandimeve të OSBE ODIHR-it nga raporti i fundit se në listën zgjedhore duhet të përfshihen edhe personat që kanë dokumente me afat të skaduar, por që me Kushtetutë kanë të drejtën e votës. Por, jam i bindur se besimi në listën zgjedhor nuk është kthyer, kjo edhe me faktin se ende KSHZ-ja nuk ka dalë me qëndrim nëse e ka nënshkruar këtë listë dhe nëse ajo mendon se ajo paraqet gjendjen reale në vend", thotë Novakovski. (REL)

Rritet përkrahja për vreshtarët dhe për bujqit

Negotinë, 1 tetor - Lideri i LSDM-së dhe kryeministri Zoran Zaev në tubimin në Negotinë vreshtarëve i premtoi ndihmë shtesë financiare nga dy denarë për çdo kilogram që ia dhanë kantinave të verës, ndërsa paralajmëroi edhe shpërblimin e prodhimtarisë cilësore. Ai theksoi se nëse kandidati i LSDM-së dhe Koalicioni do të marrë përkrahjen e qytetarëve do ta zgjidhë problemin me furnizimin e ujit, se komuna do të jetë në shërbim të qytetarëve, ndërsa paralajmëroi edhe se garanton përkrahje nga pushteti qendror që ajo të stabilizohet dhe të ecë përpara.



Premtoi edhe gazifikimin e Negotinës, modernizimin e shkollave, kopsht të ri për fëmijë... Ai është i bindur që në Negotinë fitorja do të

jetë bindshëm për LSDM-në dhe koalicionin dhe se kandidati i tyre do të fitojë që në raundin e parë. Duke u fokusuar edhe në kandi-

datët për kryetarë të komunave dhe për këshilltarë tha se ata janë ata që do t'i rregullojnë të gjitha padrejtësitë në tërë këtë periudhë. Përkujtoi edhe në të gjitha ato që ka bërë Qeveria në periudhën e kaluar. Në tubim u paraqitën edhe kandidatët për këshilltarë dhe kryetari i komunës Toni Delkov, i cili premtoi zgjidhje të problemit me shtëpinë e lindjeve, ndërtimin e kopshtit të ri për fëmijë, zgjidhjen me mbeturinat komunale, rikonstrukcionin e rrugëve, treg të mbyllur, hapësirë për parking, projekte për efikasitet më të madh energjetik...

**Kronikë****Kafkë dhe eshtra
njeriu gjenden në deponinë
e Berovës**

Kafkë dhe eshtra njeriu janë gjetur në vendin "Cërven Breg", në afërsi të deponisë për hedhurina ndërtimore në Berovë. Siç është theksuar në buletin e policisë, pardje rreth orës 14:30 në Stacionin Policor Berovë, A.S. (43) nga Gjermania, me vendbanim në Berovë, duke lëvizë në vendin "Cërven Breg", në afërsi të deponisë për hedhurina ndërtimore, ka vërejtur një pjesë të kafkës e cila i ka ngjarë si e njeriut. Pas ekspertizës së kryer dje nga ekipi i SP Berovë në afërsi të drejtpërdrejtë është gjetur edhe një thes në të cilin ka pasur eshtra të cilat kanë ngjarë si eshtra njeriu. Eshtrat janë ngritur nga vendi i ngjarjes nga ana e ekipit hetimor nga SP-Berovë për procedurë të mëtejshme.

**Vdes nëna 30-vjeçare,
foshnja mbijeton**

Një grua 30-vjeçare e cila ka qenë për të lindur vdiq dje në spitalin e Tetovës, ndërsa foshnja ka mbijetuar dhe është dërguar në Klinikën e Fëmijëve në Shkup. "Në gjendje të rëndë mbrëmë është sjellë një shtatzënë nga Zhelina me tension të lartë të gjakut. Menjëherë i është dhënë terapia përkatëse, por pacientja ra në komë. Kolegët arritën që të nxjerrin të gjallë foshnjën", deklaroi shefi i pavijonit të Gjinekologjisë pranë Spitalit klinik në Tetovë, doktor Nagip Raufi. Ai sqaroi se ishin thirrur ekupe mjekësore shtesë anesteziologë, internistë dhe specialistë të tjerë, por edhe përkundër tentativave të shumta ata nuk arritën që të reanimojnë pacienten. Për gruan kjo ka qenë shtatzënia e dytë.

**Rrëmbehet 11-vjeçari,
detyrohet të bëhet lypsar**

Dhjetë minuta para mesnate, në stacionin policor në Gjorçe Petrov, 27 vjeçarja S.B. nga fshati Çiçino, ka denoncuar rrëmbimin e fëmijut të saj 11-vjeçar te pika e fundit e pritjes së autobusëve në Saraj, nga ana e 3 personave, njërin prej të cilëve ajo e ka njohur. Ata kanë qenë me një veturë, pas çka në mënyrë të dhunshme e kanë marrë dhe e kanë dërguar në një shtëpi në të cilën ka jetuar njëri prej kidnapuesve. Më pas e kanë çuar fëmijun në më shumë vende në qytet që të lypë. Në njërin prej pikave në të cilat e kanë dërguar fëmijun që të lypë, e ka vërejtur babi i fëmijut dhe ka vrapuar drejt tyre, ndërsa personi që e ka sjellur fëmijun ka ikur në drejtim të panjohur. Në lidhje me këtë rast është arrestuar Q.K. (60) nga Shkupi dhe ndërmerren të gjitha masat për zbardhje të plotë të rastit.

**Në MPB tashmë nuk
përgjohet në mënyrë të
paligjshme**

Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, pohon se në MPB tashmë nuk përgjohet në mënyrë të paligjshme dhe se për atë mundet në çdo kohë të bëhen kontrole ekspertësh dhe parlamentare. "Me përgjegjësi pohoj se tashmë nuk përgjohet në mënyrë të paligjshme dhe për atë mund të kemi kontroll nga ekspertë, kontrole nga Kuvendi në çdo kohë. Ne qëndrojmë në dispozicion dhe jemi të hapur, në bazë të dispozitave ligjore, të bëhen kontrole të tilla", thotë ministri Spasovski në intervistë për Radio Evropa e Lirë. Në pyetjen pse MPB ngriti kallëzime penale kundër disa kryetarëve të komunave para zgjedhjeve, Spasovski u përgjigj se MPB punon sipas fakteve dhe argumenteve dhe çështja është pse rastet kanë qenë të ruajtura në sirtarë.

Ligji për amnisti miratohet pas zgjedhjeve lokale

**Rreth 600 shqiptarë
pritet të amnistohen**

Duke ju referuar burimeve brenda institucioneve ndëshkuese përmirësuese, nga burgu i Idrizovës pritet të amnistohen rreth 477 shqiptarë, nga ai i Shutkës 36, nga burgu i Tetovës 51, pastaj nga burgu i Strugës 25 të burgosur shqiptarë, nga Prilepi 15, nga Kumanova 29 të burgosur, nga Manastirit shtatë dhe nga burgu i Shtipit 11 shqiptarë, të cilën e vuajnë dënimin me burg



Koha Omer XHAFERI

Shkup, 1 tetor - Ligji shumë i përfolur për amnisti, sipas të gjitha gjasave, do të përfshijë një numër të konsiderueshëm të burgosurve shqiptarë në Maqedoni. Në bazë të të dhënave që gazeta KOHA i ka siguruar nga institucionet përkatëse, del se në tetë burgjet e shtetit, dënimin me burg për vepra të lehta penale e vuajnë

rreth 647 të burgosur shqiptarë, numri më i madh i të cilëve janë të vendosur në Idrizovë të Shkupit. Procesi i amnitisë, i cili pritet të fillojë në nëntor apo dhjetor të këtij viti, nëse nuk pëson ndryshime shtesë - sipas informacioneve jozyrtare, do t'i përfshijë pothuajse shumicën e të burgosurve shqiptarë, respektivisht ato shqiptarë, të cilët nuk janë të dënuar me

burg të përjetshëm apo vepra tjera të rënda kundër rendit kushtetues të Maqedonisë. Duke ju referuar burimeve brenda institucioneve ndëshkuese përmirësuese, nga burgu i Idrizovës pritet të amnistohen rreth 477 shqiptarë, nga ai i Shutkës 36, nga burgu i Tetovës rreth 51, pastaj nga burgu i Strugës pritet të falen 25 të burgosur shqiptarë, nga ai Prilepit 15, nga

Kumanova 29 të burgosur, nga Manastirit shtatë dhe nga burgu i Shtipit njëmbëdhjetë shqiptarë, të cilën e vuajnë dënimin me burg. Ndërkohë, të dhënat zyrtare të institucioneve përkatëse përmbyllur me 31 dhjetorin e vitit të kaluar, tregojnë se në maqedoni dënimin me burg e vuajnë rreth 3000 të burgosur, prej të cilëve rreth 800 pritet të amnistohen. Lidhur me këtë çështje,

Ashtu edhe si u paralajmërua ky edicion vjen i riformuar, me rregulla dhe kriteret e reja konkurrimi, konform strategjisë së re për zhvillim e kulturës. Cilësi dhe jo sasi, është motoja e sivjetshme. Modeli i ri i konkurrimit do të përjashtojë institucionet nga konkurrimi, duke i dhënë mundësi vetëm personave fizikë dhe juridikë nga kultura për të aplikuar. Dokumentet e aplikimit janë unifikuar për të gjithë sektorët, ndërsa projektet po ashtu do të duhet të jenë të dedikuara vetëm për një kategori dhe jo të përmbajnë më shumë të tjera

Koha Evis HALILI

Shkup, 1 tetor - Ministria e Kulturës ka shpallur Konkursin vjetor për projekte me interes nacional në kulturë. Ashtu edhe si u paralajmërua ky edicion vjen i riformuar, me rregulla dhe kriteret e reja konkurrimi, konform strategjisë së re për zhvillim e kulturës. Cilësi dhe jo sasi, është motoja e sivjetshme. Modeli i ri i konkurrimit do të përjashtojë in-

stitucionet nga konkurrimi, duke i dhënë mundësi vetëm personave fizikë dhe juridikë nga kultura për të aplikuar. Dokumentet e aplikimit janë unifikuar për të gjithë sektorët, ndërsa projektet po ashtu do të duhet të jenë të dedikuara vetëm për një kategori dhe jo të përmbajnë më shumë të tjera. Ministri Robert Alagjovovski në pres konferencën sqaroi se vonesa në

shpalljen e konkursit lidheshin me kohën që u nevojiti për transformimin e konkursit i cili në vite nuk kishte ndryshuar.

"Edhe pse opinioni vazhdimisht ka pasur vërejtje dokumentet e konkurrimit nuk ndryshuan, ndërsa modeli që ne ofrojmë tani do të jetë në përputhje me nevojat e tyre. Ato do të kontribuojnë në një përfshirje më të madhe dhe më

shumë shanse për të gjithë veprimtarët në kulturë, në mënyrë që të sigurojmë kulturë deri tek të gjithë, akses të barabartë dhe të decentralizuar, i cili do të tregojë vlerat e vërteta të sferës së kulturës dhe të kulturës bashkëkohore", ka sqaruar ministri.

Konkursi do të qëndrojë i hapur deri më 15 nëntor, ndërsa rezultatet do të publikohen në fund të muajin

Ministria e Kulturës sjell formatin e ri

**Çelet konkursi, rregulla
dhe kriteret e reja**



ministri i Drejtësisë, Bilën Saliji, për gazetën KOHA, ditë më parë tha se për momentin nuk disponon me të dhëna të saktë se sa është numri i plotë i të burgosurve në Maqedoni, me çka në kuadër të përgatitjeve për Ligjin e amnistisë, ai tha se i ka angazhuar të gjithë drejtoritë që të përgatisë raporte me numrin e saktë të të burgosurve. "Zyrtarisht kam kërkuar nga Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve të më informojë se sa të burgosur vuajnë dënimin me burg në të gjitha Institucionet ndëshkuese përmirësuese në vend. Meqë për momentin Ligji për amnisti është në debat publik, ashtu siç afrohet koha e miratimit të Ligjit, për opinionin e gjerë do të publikoj edhe këto të dhëna", tha ministri Saliji. Dënimin me burg nga 3 deri në 5 vite në Maqedoni e vuajnë mbi 700 të burgosur, respektivisht këto sanksione - sipas propozimit Ligjit të ri për amnisti, pritet të zvogëlohen për 30 për qind. Ndërkohë, po aq të burgosur e vuajnë dënim prej 5 deri në 10 vite heqje lire, derisa dënimin me burg prej 3 deri në 6 muaj, masë kjo e cila pritet të përfshihet në amnistinë e plotë, e vuajnë mbi 100 persona. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të të burgosurve, rreth 40 persona janë të dënuar me burg të përjetshëm, për të cilat kohë më parë - gazeta KOHA njoftoi se gjysma e këtyre të burgosurve janë shqiptarë, gjegjësisht shumica prej tyre burgun e vuajnë në Idrizovë. Ndryshe, ditë më parë, Shoqata e ish të burgosurve politik shqiptar, tha se para votimit të Ligjit për amnisti, duhet të përfshihet edhe rikualifikimi i veprave penale të të burgosurve, për shembull fjala "terrorizëm" të zëvendësohet me "armëmbajtje pa leje", "tentim vrasjeje", "plagë të rëndë" e kështu me radhë. Kryetari i kësaj shoqate, Shpëtim Pollozhani, në komentimin e përmbajtjes të Propozimit Ligjit për amnisti, u shpreh se askush nga ish të burgosurit politik nuk është kontaktuar dhe konsultuar nga asnjë institucion përkatës. Kjo situatë, siç tha ai, vazhdon të ndodhë përkundër faktit se ata, në çdo deklaratë deri më tani janë prononcuar për kushtet mizore nëpër burgjet, përfshi dhe nevojën e amnistisë dhe rikualifikimit të veprave të të dënuarve.

dhjetor. Për të gjithë të interesuarit Ministria e Kulturës organizon edhe sesione informativ gjatë ditëve të konkursit, në mënyrë që aplikuesit të marrin asistencën e duhur për të konkurruar sipas rregullave të reja. Të drejtën e konkurimit e kanë vetëm shtetasit e Maqedonisë, individët dhe organizatat, ndërsa janë të privuara institucionet e kulturës që financohen nga shteti për programin e tyre vjetor. Për çdo veprimtari me konkursin e ri do të ketë vetëm një aplikim, dhe jo pesë, për shembull si në kategorinë e botimit. Kjo për shkak se janë vërejtur anomalitë mes të gjitha veprimtarive dhe dokumentet e aplikimit kanë qenë të ndryshme, për disa sektorë më të detajuara dhe për të tjerë më të thjeshtësuar.

"Më parë kishte shumë diversitet dhe ne u përpoqëm që të gjithë dokumentet e aplikimit t'i harmonizojmë dhe të zbatojmë një model të unifikuar për të gjitha sferat. Risi është se konkursi më parë ishte për projekte të ndërlikuara, që përfshinin më shumë kategori në një të vete. Për shembull, projektet për publikimet që kanë lidhje me artin figurativ, ose teatrin do të aplikohet tek arti figurativ dhe drama, dhe jo tek botimi", ka thënë Oliver Musoviq, nga grupi i punës. Po ashtu ai ka sqaruar edhe prioritetet e reja. Për shembull për sektorin e muzikës orientimi do të jetë nga muzika xhez dhe rok dhe jo folklori si deri tani ku numri i projekteve ka qenë jashtëzakonisht i madh. Më shumë cilësi dhe me pak kuantitetet ky do të jetë rregulli i ri, sipas të cilit projektet do të miratohen jo për të shtuar numrat, por për të shtuar cilësinë. Konkursi vjetor zhvillohet në shtatë kategori, artet vizuale, arkitekturë dhe dizajn; folklor muzikë dhe aktivitet skenik-muzikor; veprimtaria dramatike; literatura dhe veprimtaria botuese; projektet interdisiplinare; mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe veprimtaria ndërkombëtare.

Ekonomistët thonë se ndër adutet me potencial më madh eksportues të Maqedonisë janë shërbimet dhe prodhimet e teknologjisë informatike për shkak se në botë - rritje e sipër është edhe kërkesa dhe vëllimi për shërbimet e ndryshme në sektorin e teknologjisë informatike. Ndryshe, në shtatë vitet e fundit vlera e shërbimeve kompjuterike, të telekomunikacionit dhe informatikës prej 87 milionë euro në vitin 2011, në 150 milionë euro në vitin 2016

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 1 tetor - Edhe pse Maqedonia vlerësohet si vend bujqësor dhe me industri të zhvilluar metalike që janë të orientuar në eksport, megjithatë vitet e fundit teknologjia informatike me hapa të mëdhenj po tejkalon vlerën e eksportit të tyre. Të dhënat e Entit të Shtetëror të Statistikës tregojnë se vitin e kaluar kemi eksportuar prodhime të hekurit dhe çelikut në vlerë prej afër 150 milionë euro, ndërsa eksporti i pemë-perimeve në këtë periudhë ka arritur në afër 172 milionë euro. Nga ana tjetër, është rritur në shtatë vitet e fundit vlera e shërbimeve kompjuterike, të telekomunikacionit dhe informatikës prej 87 milionë euro në vitin 2011, në 150 milionë euro në vitin 2016. Ekonomistët thonë se ndër adutet me potencial më të madh eksportues të Maqedonisë janë shërbimet dhe prodhimet e teknologjisë informatike, për shkak se, siç shprehen ata, në botë në rritje e sipër është kërkesa dhe vëllimi për shërbime të ndryshme në sektorin e teknologjisë informatike. Edhe pse nuk duhet anashkaluar as adutet e tjera eksportuese të Maqedonisë si perimet e hershme, duhani, vera, metalet apo tekstili, megjithatë një vëmendje dhe kujdes më të madh meriton sektori i IT-së, edhe për shkak të faktit se kompanitë e këtij sektori vite me radhë tregojnë rezultate të mira eksportuese me tendencë që një ditë - të jenë edhe ndër veprimtaritë kryesore eksportuese në Maqedoni. Nga Oda e Teknologjisë informatike pranë Odës

Potencial më i madh se pemë-perimet

Të stimulohet teknologjia informatike



Ekonomike të Maqedonisë - MASIT, vlerësojnë se sektori i teknologjisë informatike në shtet është në përparësi të madhe në raport me degët e tjera eksportuese, pasi edhe oferta e tyre është "vlerë për para". Kjo, për shkak se në këtë sektor, punon një fuqi punëtore lartë e kualifikuar dhe e trajnuar e që ka çmimin e saj në tregun e punës, njeh mirë jo vetëm gjuhën angleze, por edhe disa nga gjuhët e tjera botërore, ka njohuri të mëdha teknike dhe është e gatshme të punojë sipas teknologjive dhe standardëve më të reja dhe moderne që kërkohen në tregjet e jashtme.

Njëherësh, në vend punojnë edhe mjaft kompani të huaja të këtij sektori si dhe kanë bashkëpunim mjaft të mirë me kompanitë në Bashkimin Evropian. Në fillim të kësaj jave, NGA MASIT kanë kërkuar ndryshime ligjore që të mund sigurojnë stimulime me të cilat do të mbajnë në punë inxhinierët e që së fundmi, po ikin jashtë shteti. Kompanitë kërkojnë ndryshimin e rregullativës së deritanishme që pengon që edhe në Maqedoni të shfrytëzohen praktikisht botërore të stimulimit siç janë puna nga shtëpia, bonuset e ndryshme, koha e stazhit e kështu me radhë.

Sipas paralajmërimit të Aneta Pesheva nga MASIT, me Qeverinë shumë shpejt

do të bisedohet për rregullativë speciale për shkak se firmat punësojnë inxhinierë menjëherë pas përfundimit të shkollimit dhe i trajnojnë ata, ndërsa të njëjtët pas fitimit të gjitha certifikatave, po ikin jashtë.

"Sistemi tatimor nevojitet të jetë më specifik dhe më preciz lidhur me të ardhurat e inxhinierëve të IT-së, për shkak se ata nuk mund të mbani në punë pa një rrogë prej 1000 apo 1500 euro, ndërsa ai nuk ka as banesë, si dhe fillon të krijojë familje", shton Pesheva. Nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale thonë ndërkohë se propozimet dhe vërejtjet e sektorit të Teknologjisë Informatike do të jenë pjesë e analizës gjatë përgatitjes së Ligjit të ri për marrëdhënie pune që duhet të miratohet në vitin e ardhshëm. Në ndërkohë, nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës thonë se ndër prioritetet e këtij dikasteri është edhe mbështetja institucionale për shfrytëzimin sa më të madh të potencialeve dhe përfitimeve që mund të sjellë sektori i teknologjisë informatike.

Ndër angazhimet e Qeverisë së re janë edhe lehtësimet tatimore për të gjitha kompanitë eksportuese të shërbimeve dhe prodhimeve të teknologjisë informatike e që do të sjellin edhe më shumë prurje devizore, si dhe

përkrahje financiare për rikualifikimin me qëllim të krijimit të kuadrove të reja të këtij sektori. Nga Odat e tjera informatike kanë kërkuar edhe masa të tjera të mbështetjes për këtë sektor. "Nevojiten masa cilësore për të ulur mungesën e kuadrove në këtë sektor, shfrytëzim i teknologjive më moderne për zhvillimin e shoqërisë informatike dhe përmirësimin e punës së IT kompanive. Kompanitë vendore të këtij sektori duhet të stimulohen dhe të hapin vende të reja të punës, si dhe të zhvillojnë softuer dhe shërbime jo vetëm për në Maqedoni, por edhe për në eksport", thotë kryetari i Odës së Teknologjisë Informatike pranë Lidhjes së Odave Ekonomike të Maqedonisë, Sasha Ognevovski. Sipas tij, zhvillimi i teknologjisë informatike ka efekte të shumëfishta për shoqërinë dhe ndikim direkt ndaj produktivitetit më të madh, inovacioneve dhe efikasitetit të sektorit privat dhe publik, e që krijon edhe vende të reja të punës me vlerë të shtuar.

Ndryshe, nga shtetet fqinje - rezultate mjaft të mira në eksportin e shërbimeve të teknologjisë informatike realizon Serbia me 740 milionë euro, por që ka shtatë milionë banorë dhe më shumë studentë dhe fakultetet që nxjerrin inxhinierë të informatikës.

Nis puna për ndryshimin e ligjeve për arsim fillor dhe të mesëm



Shkup, 1 tetor - Tre grupe të punës në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës këtë fundjavë punojnë në propozime për ndryshimin

dhe plotësimin e ligjeve për arsim fillor dhe të mesëm dhe në përcaktimet e ligjeve të cilat kanë të bëjnë për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Ministria e Arsimit dhe Shkencës bëri të ditur se në grupet e punës janë përfshirë ekspertë nga Ministria, Byroja për Zhvillim të Arsimit, Qendra për Arsim të Mesëm Profesional.

Inspektorati Arsimor Shtetëror, përfaqësues të SASHK-ut dhe MESO-s. Lidhja e Defektologëve të Maqedonisë, Oda e Psikologëve të Maqedonisë, Plenumi i Mësimdhënësve, përfaqësues të profesorëve nga të gjitha rajonet në shtet, si dhe përfaqësues të organizatave civile. Sipas ministres Renata Treneska-

Deskoska, propozimet e marra nga grupet e punës janë thelbësore në procesin e sjelljes së ndryshimeve dhe plotësimeve cilësore të ligjeve për arsim fillor dhe të mesëm, ndërsa propozimet publikisht do të jenë të qasshme dhe të hapura për debat me qëllim që të arrihet deri te zgjidhjet më të mira ligjore.

Në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 pikën 3, nenin 8 paragrafin 1 alinën 6, nenin 8-a, 8-b, 8-v të Ligjit të Byrosë së zhvillimit të arsimit („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 37/06, 142/08, 148/09, 69/13, 120/13, 148/13, 41/14 dhe 30/16), nenin 91 paragrafin 6, 7, 8, 9 dhe 10 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17), nenin 2 nga Rregullorja e formularit të fletëparaqitjes për pjesëmarrje në shpalljen publike për zgjedhjen dhe akreditimin e programeve për trajnime dhe ofertues të shërbimeve për aftësim profesional të kuadrit edukativ – arsimor në shkollat fillore dhe të mesme të Republikës së Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 144/16) Planin strategjik të Byrosë 2015-2017 nr. 01-959/8 nr. 24.11.2015, Programin vjetor për punën e Byrosë së zhvillimit të arsimit nr. 10 – 111/3 prej 15.02.2017, Programin vjetor nr. 12-9830/2 prej 04.07.2016 për aftësimin profesional dhe avancimin e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional në shkollat fillore në Republikën e Maqedonisë caktuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës, neni 5 paragrafi 1 alineja 2, 6, 8, 9 dhe 10 nga Rregullorja për zgjedhjen dhe akreditimin e programeve për trajnim dhe ofertues të shërbimeve për përsosje profesionale të kuadrit edukativ – arsimor në shkollat fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë nr. 01-729/2 prej 22.05.2016 dhe nr. 01-106/2 prej 22.05.2017, dhe Procedura për realizimin për realizimin e trajnimeve në shkollat fillore dhe të mesme nr. 02- 1107/2 prej 21.07.2016, Byroja e zhvillimit të arsimit publikon

SHPALLJE PUBLIKE

për përzgjedhjen dhe akreditimin e programeve për trajnim dhe ofertues të shërbimeve për aftësimin profesional të kuadrit edukativ – arsimor (mësimdhënës) të shkollave fillore në Republikën e Maqedonisë me temë: „Nocioni i algoritmit dhe programet, përvetësimi i mendimit algoritmik përmes lojës dhe krijimit të programeve të zakonshme (për klasën III, IV dhe V)

Trajnime do të realizohet për 4450 – 4650 mësimdhënës në katër (4) rajone në territorin e Republikës së Maqedonisë, edhe atë:
- rajoni 1 (Shkup, Kumanovë, Kriva Pallankë, Kratovë, Veles), trajnimi i 1930 – 1990 mësimdhënësve;
- rajoni 2 (Shtip, Probishtip, Radovich, Shën Nikolla, Koçan, Vinicë, Berovë, Peçev, Dellov, Makedonska Kamenicë, Strumicë dhe Vallandovë), trajnimi i 680 – 720 mësimdhënësve;
- rajoni 3 (Prilep, Kavadar, Negotinë, Gjevgjeli, Dojran, Manastir, Resnjë, Demir Hisar, Ohër, Strugë) trajnim i 990 – 1040 mësimdhënësve;
- rajoni 4 (Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Dibër), trajnim i 850-900 mësimdhënësve.

Ofertuesit e interesuar të cilët do të aplikojnë në konkursin publik janë të detyruar të përfaqësojnë të gjithë rajonet e lartpërmendura në veçanti. Ofertuesit e interesuar të cilët do të aplikojnë në konkursin publik mund të përfaqësojnë të gjithë rajonet e lartpërmendura apo të aplikojnë sipas rajoneve.

Akredituesi, ofertuesi më i volitshëm do të mbajë trajnimin njëditor me kohëzgjatje prej 8 orësh për mësimdhënësit e shkollave fillore të cilët realizojnë mësim në lëndën mësimore Puna me kompjuter dhe bazat e programimit në klasën III, IV dhe V.

Kusht për pjesëmarrje në procedurën për zgjedhjen e akreditimit të programeve për trajnim dhe ofertues të shërbimeve për aftësimin profesional të kuadrit edukativ – arsimor është plotësimi i kriterëve për të cilat duhet të dërgojnë këto dokument:

1. dokument për veprimtarinë e regjistruar të dhënë nga Regjistrari Qendrorë i Republikës së Maqedonisë;
2. gjendja vijuese e nxjerrë nga Regjistrari Qendrorë i Republikës së Maqedonisë,
3. gjendja e bilancit dhe bilanci i suksesit nga Regjistrari Qendror i Republikës së Maqedonisë
4. vërtetim se nuk është hapur procedurë për falimentim e nxjerr nga Regjistrari Qendror i Republikës së Maqedonisë,
5. vërtetim se nuk është ngritur procedurë për likuidim nga Regjistrari Qendror i Republikës së Maqedonisë,
6. vërtetim për tatime të shlyera, kontribute dhe të dhëna tjera publike të nxjerr nga Drejtoria e të hyrave publike e Republikës së Maqedonisë,
7. vërtetim të nxjerr nga Regjistrari Qendror i Republikës së Maqedonisë, nga regjistrari i dënimeve për veprat e bëra penale të personave juridik, se nuk i

është shqiptuar dënim i përkohshëm apo i pacaktuar apo ndalesë e përhershme për veprim të caktuar,

8. vërtetim se me aktgjykim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar sanksion kundërvajtës për kryerjen e profesionit, veprimin apo detyrës, kryesisht ndalesë e përkohshme për kryerjen e një veprimi të caktuar të nxjerr nga Regjistrari Qendror i Republikës së Maqedonisë,

9. vërtetim të nxjerrë nga Regjistrari Qendror i Republikës së Maqedonisë, nga regjistrari i dënimeve për veprat e bëra penale të personave juridik, se nuk i është shqiptuar dënim dytësor, ndalesë për pjesëmarrje në procedurë për thirrje publike, ndarje të kontratave për furnizime publike dhe kontrata për partneritet publik – privat.

10. deklaratë se kanë përvojë në realizimin e trajnimeve për përsosje profesionale me informata më të hollësishme, si vërtetim se ka realizuar së paku tre trajnime për mësimdhënës me tema të ndryshme në pesë vitet e fundi.

11. listë me minimum dhjetë (10) trajnues për lëmin adekuat, që: kanë së paku shkallën e VII të arsimit, përkatësisht 240 kredi që dëshmojnë me dërgimin e kopjes së diplomës apo vërtetimit për arsimimin e mbaruar dhe që kanë mbajtur së paku 2 trajnime nga lëmi adekuat që vërehet me dëshminë e vërtetimit origjinal apo udhëzime për trajnimin e realizuar të nxjerr nga institucioni/ndërmarrja për të cilën është kryer shërbim apo -janë ligjërues të së paku një programi studimor nga lëmi adekuat që dëshmojnë me dërgimin e vërtetimit origjinal të nxjerr nga institucioni për të cilin e kryen shërbimin,

12. programi për trajnim,

13. deklaratë se ka të siguruar pajisje hapësirore në të cilët do të realizojë trajnimet,

14. deklaratë se nëse është i akredituar si ofertues i volitshëm, do të sigurojë garanci bankare në lartësi prej 5% të vlerës së marrëveshjes së nënshkruar, për kryerjen në kohë dhe me cilësi të obligimeve që dalin nga marrëveshja.

Personi i autorizuar zyrtar nga Byroja e zhvillimit të arsimit i cili e udhëheq procedurën duhet në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të fletëparaqitjes për pjesëmarrje nga ofertuesi i interesuar sipas detyrës zyrtare ta kërkojë dokumentin sipas pikave: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 nga organi kompetent.

Dokumentet nga pikat 10, 11, 12 dhe 13 i përpilon, nënshkruan, vulos dhe dërgon personi përgjegjës i ofertuesit.

Kriteret e lartpërmendura janë **eliminuese**. Në çmimin e ofruar të përfshihet edhe TVSH dhe të gjitha shpenzimet dhe lëshimet tjera.

Kriteri për vlerësimin e ofertave është çmimi për mësimdhënës 60 pikë dhe cilësi e programit të ofruar 40 pikë.

Ofertuesit e interesuar mund të gjitha pyetjet në formë të shkruar t'i dërgojnë në Byronë e zhvillimit të arsimit më së voni shtatë (7) ditë para hapjes publike të ofertave. Si ofertues të shërbimeve për përsosjen profesionale të kuadrit edukativ – arsimor, (mësimdhënës të shkollave fillore) në R. e Maqedonisë mund të paraqiten institucione private dhe publike, shoqata të qytetarëve dhe shoqata tregtare.

Ofertuesit e shërbimeve mund të dërgojnë fletëparaqitje të pavarur për pjesëmarrje apo ofertë të pavarur apo mund të shoqërohen dhe të formojnë grup të ofertuesve me qëllim bashkërisht të dërgojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje apo ofertë në grupe në pajtim me Ligjin për furnizime publike.

Në konkursin publik nuk mund të paraqitet as si ofertues i shërbimeve e as si trajnues i angazhuar i punësuar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe në organet në përbërje, në Byronë e zhvillimit të arsimit, Qendrën shtetërore për provime, Qendrën arsimore për të rritur, Qendrën për arsim dhe trajnim profesional, Inspektoratin shtetëror të arsimit dhe drejtorit shkollë.

Hapja publike e ofertave do të jetë më 17.10.2017 në ora 10:00.

Dokumentacioni i nevojshëm për pjesëmarrje në shpalljen publike mund të merret në hapësirat e Byrosë së zhvillimit të arsimit, në rr. „Rugjer Boshkoviq” nr.20 –Shkup, zyra numër 23, më së voni deri më 10.10.2017 deri në ora 16:00.

Personi për kontakt: Gjulaj Isaki – Useini, gylajisakiuseini@bro.gov.mk, tel. 02/3089 – 064.

Numri i mësimdhënësve në shkolla, rajone dhe gjuha e trajnimit që do të jenë të përfshira me trajnim si dhe të gjitha detajet tjera për trajnimin dhe dokumentacionin e nevojshëm janë paraparë në dokumentacionin e tenderit.

Byroja e zhvillimit të arsimit



REPUBLIKA E MAQEDONISË KOMUNA E STRUGËS

Në bazë të nenit 21 nga Ligji për planifikim hapësiror dhe urbanistik („Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 199/2014, , 44/2015 193/2015 31/2016 163/2016) Kryetari i Komunës së Strugës, e sjell këtë:

L A J M Ě R I M

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të
Komunës së Strugës se shpallet

Thirrje publike për dorëzimin e iniciativës për punim të Planeve urbanistike

Thirrja publike shpallet në pajtim me nenin 21 nga Ligji për planifikim hapësiror dhe urbanistik (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 199/2014 44/2015,193/2015,31/2016 163/2016) në **kuartalin e tretë për vitin 2017**

*Në periudhë prej **31 ditëve**, të gjithë personat e interesuar fizik dhe juridik duhet të dorëzojnë iniciativa për përpunimin e Planeve urbanistike nga neni 7 të Ligjit për planifikim hapësiror dhe urbanistik.

*Lëndë e **iniciativave** mund të jetë sjellja e Planit të ri urbanistik ose ndryshim dhe plotësim të Planit ekzistues urbanistik ose Dokumentacion planor urbanistik me propozim konkret nga parashtuesi i iniciativës.

*Thirrja publike do të zgjas nga data **04.10.2017 deri në date 06.11.2017 – 31 ditë** .

*Thirrja publike do të publikohet në faqen e zyrtare të Komunës së Strugës www.struga.gov.mk, në tabelën publikuese të komunës, në sistemin informativ e-urbanizëm, përmes publikimit në informatorin zyrtar të komunës, dhe në një gazetë ditore në gjuhën maqedonase dhe një gazetë ditore në gjuhën shqipe.

*Personat e interesuar fizik dhe juridik iniciativat t'i dorëzojnë në formë të shkruar përmes arkivit të Komunës së Strugës ose në formë elektronike përmes sistemit informativ e-urbanizëm në afatin e përcaktuar.

*Për të gjitha iniciativat e pranuar parashtuesit do të informohen në formë të shkruar ose në formë elektronike përmes sistemit informativ e-urbanizëm në afat prej 15 ditëve nga përfundimi i afatit për parashtimin e iniciativave.

*Iniciativat e pranuar nga Thirrja publike do të përfshihen në programin për punim të planeve urbanistike për Komunën e Strugës për vitin 2016.

*Mjetet për iniciativat e pranuar për përpilimin e dokumentacionit të nevojshëm duhet të sigurohen nga parashtuesit e iniciativave – personat fizik ose juridik.

KOMUNA E STRUGËS
u.d.Kryetari i komunës,
Mustafa Zabzun

Nr. 10- 3346
29.09.2017
STRUGË

KOMUNA E STRUGËS

SHESHI “NËNË TEREZA” P.N
6330 STRUGË
TEL.
046 781-335
781-223
782-015
FAKS.
046 781-434
E-MAIL:
kryetari@struga.gov.mk
info@struga.gov.mk

Sektor

Sektor për planifikim hapësiror dhe veprimtari komunale.

Njësia:

Njësia për veprimtari komunale



1240 persona u ndaluan pa leje për vozitje

Filloristët bëhen “shoferë”

Këmbësorët në qytetin e Tetovës janë ankuar se shpesh herë hasin vozitës të rinj nëpër vetura dhe nga të njëjtit janë në rrezik permanent. Nga policia arsyetohen se kohëve të fundit kanë përforcuar kontrollin në rrugët e Tetovës dhe ata që janë pa leje për qarkullim, sanksionohen

Koha | Urim HASIPI

Tetovë, 1 tetor - Gjatë tetë muajve të këtij viti, 1240 persona janë ndaluar duke drejtuar automjetet të ndryshme pa leje për vozitje. Këto janë nga dhënat e Policisë së Tetovës, prej nga theksojnë se ky numër është rekord në vitet e fundit, ku janë kapur vozitës që drejtojnë automjete pa leje për vozitje. Kësisoj, fëmijë të shkollave fillore drejtojnë automjetet e prindërve të tyre. Ata me të njëjtat shkojnë në shkollë dhe qarkullojnë nëpër rrugët e qytetit. Sipas policisë të dhënat janë alarmante, sepse në ditë ndalohen dhjetë persona pa leje për vozitje me automjete.

“Ata më shumë kanë drejtuar vetura dhe motoçikleta. Nuk mungojnë as autobusët dhe taksi veturat që drejtohen pa leje. Bëhet fjalë për persona të



moshës nga 17 deri në 29 vjeç. Pjesa më e madhe e tyre janë nga Tetova dhe nga fshatrat e rrethinës. Në raste të rralla janë evidentuar edhe persona nga Shkupi që janë ndaluar në Tetovë, duke drejtuar makinat pa leje”, tha zëdhënësi i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë, Marjan Josifovski. Këmbësorët në qytetin e Tetovës janë ankuar se shpesh herë hasin vozitës të rinj nëpër vetura dhe nga të njëjtit janë në rrezik permanent.

“Shihet qatë se janë të vegjël që të drejtojnë makinat edhe ata shpesh i shohim në qendër të Tetovës, duke bërë lloj-lloj veprimesh të pahijshme, duke na rrezikuar jetën neve këmbësorëve. Policia

duhet që të jetë më shumë në terren që të ndalojë këto veprime të të rinjve në qytetin tonë dhe nevojitet që edhe prindërit të dënohen që u lejojnë fëmijëve të vozisin në moshë të re”, thotë Hamiti, një qytetar i Tetovës.

Nga policia arsyetohen se kohëve të fundit kanë përforcuar kontrollin në rrugët e Tetovës dhe ata që janë pa leje për qarkullim sanksionohen pa dallim. “Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë vazhdon që të apelojë te prindërit që të mos u japin veturën fëmijëve të tyre dhe që të mos e sjellin në pikëpyetje jetën e tyre dhe të pjesëmarrësve tjerë në komunikacion. Personat që nuk do të dëgjojnë këto apele, do të përballen me

dënime prej 300 euro, ndërsa ata që ua japin veturën këtyre personave do të përballen me dënim prej 400 euro”, deklaroi Marjan Josifovski, zëdhënësi i Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë.

Ai tha se kontrollin e kësaj natyre janë shpeshuar sidomos në bulevardin “Marshall Tito”, në bulevardin e lindenit, në rrugën industriale dhe në hyrje daljet e qytetit të Tetovës. Në këtë drejtim, vozitja e automjeteve me regjistrim të skaduar, dhe pa leje për vozitje, janë dukuri të cilat edhe më tutje dukshëm janë prezent në rajonin e Tetovës dhe Gostivarit, edhe përkundër aktivitetit të shumta të kontrollit, të cilat në

vazhdimësi i ndërmarrin pjesëtarët e policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë.

Për shkak të kësaj situatë që padyshim është e pafavorshme, Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë edhe njëherë apelon deri te qytetarët, veçanërisht deri te të rinjtë, që fillimisht të kalojnë testin e lejes për vozitje dhe më pas të ulen përpara timonit, por që edhe në kohë të regjistrojnë automjetet e tyre, për arsye se jo vetëm që vënë në pikëpyetje sigurinë e tyre personale, por edhe sigurinë e pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion, sepse automjetet e paregjistruara shpesh nuk janë në gjendje të rregullt teknike, ndërsa vozitësit

pastërvitur dhe të pa përvojë paraqesin rrezik potencial në rrugë, si dhe shpesh janë shkak të aksidenteve të komunikacionit. Në rajonin më të gjerë të Tetovës, muajin e kaluar nga komunikacioni janë larguar gjithsej 142 automjete. Më shumë prej tyre, gjegjësisht 129, për shkak të regjistrimit të skaduar, parregullsi teknike dhe mangësi të tjera. Për automjetet e paregjistruar, fenomen ky që këtë vit ka shënuar rritje, janë përgatitur padi adekuate dhe do të përballen me gjoba, të cilët për këtë lloj kundërvajtjeje lëviz nga 100 deri në 500 euro në kundërvlerë të denarit, përderisa gjoba për automjetet me parregullsi teknike, veçanërisht ato të cilat kanë pasur frenat e dëmtuar gjoba është 400 euro. Në gusht gjithashtu janë larguar nga komunikacioni 276 vozitës, nga të cilët 149 pa leje për vozitje, gjegjësisht ato të cilët nuk kanë pasur leje valide për vozitje, 105 vozitës fillestarë, të cilët kanë thyer kufizimet ligjore, të parapara për këtë kategori të vozitësve. Edhe të parët edhe të tjerët i presin padi dhe gjoba adekuate, të cilat lëvizin nga 200 deri në 300 euro në kundërvlerë të denarit, me vërejtjen se këtë vit në rajonin e Pollogut është dukshëm më i madh numri i vozitësve të egër gjegjësisht atyre që drejtojnë automjete pa leje adekuate për vozitje.

Shembuj padrejtësie

Fabrikë pa shqiptarë në fshatin shqiptar

Edhe pse fabrika e prodhimit të ujit mineral është mu në qendër të fshatit, hapësira e cila u takon banorëve të fshatit, në të nuk ka punësuar asnjë shqiptarë, edhe pse të gjithë janë të papunë!

Koha | Qenan HASANI

Manastir, 1 tetor - Edhe burimet, edhe fabrika për eksploatimin dhe përpunimin e ujit mineral “Pelisterka” i njohur në tregun të vendit dhe jashtë tij, gjendet mu në qendër të fshatit shqiptarë Mexhitli, fshat ky vetëm pesëqind metra larg kufirit dhe pikë-kalimit kufitar me Greqinë fqinje. Eksploatimi i kësaj pasurie natyrore ka filluar diku në vitet e largëta të gjashtëdhjeta, fillimisht me



teknologji primitive, pasatj me teknologji moderne. Falë cilësisë së lartë, uji i këtyre burimeve pushtoi tregjet në vend, por dhe jashtë vendit. Fabrika punon 24 orë në ditë pandërprerë, proces ky që ka imponuar edhe numër të dukshëm të të punësuarve e që arrin diku rreth pesëdhjetë. Dikur në këtë kapacitet industrial kanë punuar edhe shqiptarë nga fshati Mexhitli, të

cilët kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në ruajtjen e kapacitetit gjatë turbullirave që ndodhën në kohën e privatizimit të pronës shoqërore. Të tre rojtaret ishin shqiptarë të fshatit. Kishte edhe të punësuar të tjerë drejtpërdrejtë në prodhimtari.

Pas privatizimit, në vend të falënderimit për ruajtjen e fabrikës nga shkatërimi total nga palët pretenduese për të marrë

në pronësi, pronarët e rinj, në befas të të gjithëve, ata përjashtohen nga puna, duke mbetur pa kurrfarë perspektive, që edhe ishte shkak i vërtetë që shqiptarët e Mexhitlisë tci nënshtrihen migrimit për në Australinë e largët. Pas ngjarjeve të 81-shit fillon përbuzja dhe ndjekja e shqiptarëve.

“Pas ngjarjeve të Kosovës më 1981, autoritetet filluan të na

shikojnë me sy të bishave të egra, thotë Skënder Xhemaili, dikur edhe ai i burgosur dhe i dënuar me katër vjet e gjysme burgim për nacionalizëm dhe separatizëm shqiptarë, për të vazhduar pastaj rrëfimin: “Ishte qartë se për ne këtu qetë e të ndershme. Mund të paramendonim absurdin sllavë: në mesë të fshatit ndodhet fabrika, kurse s’ka asnjë shqiptarë të punësuar, si i thonë kësaj pune me fjalorin politikë? Kësaj i thonë thyeni qafën se s’ka vend për ju këtu, përgjigjet Skënderi.

Të këtij mendimi janë edhe ato pak burra të mbetur në fshat, të cilët të revoltuar thellë nga gjithë ajo ç’po ndodh me shqiptarët, jo vetëm të Mexhitlisë, por edhe të fshatrave tjera, ata nuk shfaqin Revoltë të madhe ndaj sllavëve, nga se, siç thonë ata, më të revoltuar janë me veprimet e politikanëve shqiptarë, të cilët për përmirësimin të poz-

itës së shqiptarëve të Manastirit, nuk kanë luajtur as me gishtin të vogël, kurse para zgjedhjeve premtojnë se, nëpër rrugët do të rrjedh mjalhtë. “Është mashtrim i madh t’u besohet fjalëve, pretimeve të “lypësve” të votave. Është më mirë të mos na vizitojnë”, shprehet Skënderi.

Ç’është më e keqja, shteti, Kombinati bujqësor “Pellagonija” me kohë ua ka uzurpuar edhe kullotat e fshatit, të mbetura prej atyre që janë shpërngulur për në Turqi. Edhe pse në disa raste kanë kërkuar drejtësinë edhe në institucionet e drejtësisë, kurrë nuk është pranuar e as që është zgjedhur kjo kërkesë, që dukshëm ndikon në kufizimin e blegtorisë që ka mbetur burimi i vetëm simbolik për sigurimin e ekzistencës. Të gjithë parashatrojnë pyetjen: Kur do fillojë drejtësia të funksionojë edhe për shqiptarët e diskriminuar skajshëmrisht?



Shpata që ndodhet në sallën XXVII, është e gjatë 88.5 cm e gjerë 57 cm, me dy tehe dhe me një formë të drejtë dhe në një vend të kthyer përmban disa shkronja latine. Prej këtyre shkronjave lexohen këto fjalë: "Herói i perëndisë, Iskander Beg"

Në shiritin e kohës

Si përfunduan armët e Skënderbeut në Vjenë?

Historinë se si armët përfunduan në Vjenë e jep konsulli i Shqipërisë në Austri gjatë Mbretërisë së Zogut, Leo Alexander Rfeundlich.

Në Arkivin e Shtetit në dosjen e Skënderbeut gjendet një shkrim ku tregohet historia e udhëtimit të tij. Artikulli i Freundlich, një njeri i pasionuar pas historisë së Shqipërisë, përdor rrëfimin e drejtorit të mbledhjeve të Muzeut Historik të Vjenës për të treguar të vërtetën e armëve të Skënderbeut.

Sipas tij, për herë të parë këto objekte janë përmendur në vitin 1578. Më 15 tetor të këtij viti, Mario Sforza, duka i Urbinos, i shkruan një letër arqidukës Ferdinand, ku i thotë se do t'i dërgojë atij armët e Skënderbeut, dhe të vëllait të tij.

Ky është një fakt që dëshmon se mes arqidukës dhe Mario Sforzas janë këmbyer shumë letra. Më 15 maj 1579 arqiduka i Tirolit i shkruante dukës së Urbinos, Maroi Sforza dhe e falënderon për armët e Skënderbeut dhe për të tjerat që do t'i binin në dorë, transmeton Gazeta Observer.

Ndërsa për herë të dytë këto armë përmenden në një letër të dukës Von Arescot, e shkruar me 25 korrik 1588, ku flitet për armët e tjera të Skënderbeut. Në inventarin e vitit 1585 këto objekte nuk ishin të shënuara ende. Ndërsa në inventarin e vitit 1593 shënohet: "Në fletën 69, dy shpata dhe elmi i Gjergj Skënderbeut".

Prej këtyre shkrësive dhe inventarit mund të konstatohet lehtë se elmi dhe dy shpatat e Skënderbeut kanë rënë në dorë të arqidukës Ferdinand midis vitit 1588-1593 nëpërmjet dukës Mario Sforza të Urbinos dhe të dukës Arescot. Ekzaktësisht në inventarin e vitit 1596, faqe 321, janë përmendur dhe shënuar elmi nr. 71 (127) dhe dy shpatat nr.92 (145) dhe 345 (550).

Aty shënohet: "George Skanderbeg: një elm i bardhë me rrafshë të arta sipër një kokë dhe artë me dy brirë, dhe dy shpata, njëra me një dorezë prej lëkure, e cila nga pesha e rëndë dhe prej shenjave të gjakut që duken ende, ngjan më e madhërishtme, ndërsa tjetra është me një



dorezë kadife ku është shënuar emri i Skënderbeut.

Në inventarin e pikturave të sekretarit privat Schrewnchk të titulluar "Armamentarium heroicum" të vitit 1601, ne shohim në tablonë 16, Skënderbeun me elmin nr.71 (127) dhe me shpatën nr.345 (550), ku shkruhet: Në një kornizë me ornamente të shumta rrinë në këmbë Skënderbeu i veshur me një pallto të gjatë me astar lëkure e mbërthyer në gjoks me shirita, me kokën dhe mjekrën e gjatë kthyer nga krahu i majtë, ku i duket profili.

Në krahun e djathtë ai

mban lart shpatën e zhveshur nr. 345 (550) dhe poshtë në tokë afër këmbës së majtë qëndron elmi nr. 71 (127).

Në kokë mban një beretë. Objektet që janë pikturuar në fotografi i ngjajnë shumë atyre në origjinal që ndodhen në muzeun e Artit Historik të Vjenës. Shihet qartë që këto dy objekte njiheshin që në vitin 1601 si sendet e Skënderbeut. Ja një përshkrim i imët mbi dy shpatat e mbi përkrenaren: Në sallën XXV Nr.71/127 ndodhet një përkrenare e shtrirë në një pedestal të ulët, e cila duhet të jetë prerë si mbas stilit italian. Në majë të përkrenares janë vendosur kryet dhisë, por asht fiksue mirë.

Përkrenarja përbëhet prej dy pjesëve, një pjesë prej bakri dhe pjesa tjetër sipër me një copë metali buzët e secilës janë zbukuruar me ar. Syve të dhisë u mungojnë gurët. Akoma duket vendi bosh, i cili të jep të kuptosh se brenda kanë qenë vendosur gurë. Në mesin e

“Përkrenarja përbëhet prej dy pjesëve, një pjesë prej bakri dhe pjesa tjetër sipër me një copë metali buzët e secilës janë zbukuruar me ar. Syve të dhisë u mungojnë gurët. Akoma duket vendi bosh, i cili të jep të kuptosh se brenda kanë qenë vendosur gurë. Në mesin e përkrenares është vendosur një rreth prej bakri.



përkrenares është vendosur një rreth prej bakri.

Në këtë rreth janë shkruar këto shkronja: I.N.P.E.RA.TO.RE.BT. Ky shkrim është shumë i vështirë për t'u kuptuar çfarë thotë: Deri më tani e kanë deshifruar si: "Jesus Nazarenus Principi Emathiae Regi Albaniae Terrori Osmanoru Regi Eperi Benedictat". Pesha e përkrenares është 3000gr.

Kjo përkrenare është një "unikum", i vetmi e i veçantë që gjendet në muzeun dhe i përket artit të punimit të metalit në stilin gotik të vonshëm. Përpara së gjithave kjo përkrenare në pikëpamjen estetike është një vepër e mrekullueshme dhe i ka hije vetëm një burri të fuqishëm të fortë e me vullnet të hekurt.

Shpata që ndodhet në sallën XXVII, rafti V.Nr.345(550) është e gjatë 88.5 cm e gjerë 57 cm, me dy tehe dhe me një formë të drejtë dhe në një vend të kthyer përmban disa shkronja latine. Prej këtyre shkronjave lexohen këto fjalë: "Herói i perëndisë, Iskander Beg".

Doreza është e përbërë prej druri të mbështjellë me lëkurë, pesha e kësaj shpate asht 1300 gr.

Shpata me dorezë është e veshur me lëkurë shagreni, ka nga anët e jashtme 4 arabeska të thella, tre rripa për hijeshim.

Anët e jashtme përkrenares prej fildishi dhe në anët e brendshme shohim disa germa të kuqe, të cilat janë shkruar më shekullin e XVI e që përmbajnë emrin "Scënderbeg".

Pesha është 600gr dhe pesha e përgjithshme 1900 gr. Kjo shpatë është e shënuar dhe pikturuar në librin e sekretarit privat të arqidukës së Tirolit, Jakob Schrenckh, "Armamentarium heroicum", në faqet XVI.

Përveç këtyre në sallën e armëve historike të muzeut të Vjenës gjendet dhe një tjetër, e cila quhet si një nga shpatat e Gjergj Kastriotit dhe është shënuar në inventarin mbajtur në vitin 1593.

Kjo shpatë të jep të besosh nga pesha e rëndë dhe nga gjatësia se Kastrioti me një të goditur i ndante në dy pjesë trupat e armiqve.

Kjo shpatë gjendet në sallonin XXV, rafti II Nr.92(143), gjatësia e saj 121 cm dhe doreza është e zbukuruar me ar dhe me lëkurë. Pesha e saj është 3.2 kg

E ardhmja e Gjermanisë pas zgjedhjeve



Joschka FISCHER

Zgjedhjet në Gjermani prodhuan një fitore në hije për CDU-në e Merkel, ndërkohë që përfaqësimi në Bundestag për herë të parë i AfD është fillimi i reve të zeza mbi qiellin gjerman

Rezultati i zgjedhjeve federale të Gjermanisë të dielën ishte i papritur dhe shqetësues, të paktën për standardet gjermane. Dy partitë kryesore, Social Demokratët (SPD) dhe Bashkimi Kristian Demokrat (CDU), bashkë me partinë simotër të saj bavareze, Bashkimi Social Kristian (SCU) u ndëshkuan në kutinë e votimit, pasi kishin qeverisur si një koalicion i madh nën kancelaren gjermane Angela Merkel për katër vitet e fundit. Performanca e SPD ishte më e keqja që nga çdo zgjedhje federale që prej të parave të Republikës Federale, në 1949.

Ngjashmërisht, aleanca CDU/CSU u kthye në të dytën më të keqe që prej 1949 duke qenë se CDU vuajti humbjet më të këqija në zgjedhjet federale në historinë e vet. Kjo është veçanërisht e veçantë, duke qenë se Bavaria do të mbajë zgjedhje të nivelit shtetëror

vitin e ardhshëm. Thënë këto, zgjedhja ishte një rrëshqitje ndaj koalicionit të madh të Merkel. Dhe në një pikë të caktuar, mund të shihet si një votë protestë ndaj Merkelit vetë. Ndërkombëtarisht, ajo vlerësohet si një lidere efektive dhe si garantuese e stabilitetit dhe autoritetit moral në Perëndim. Por në atdhe, qartazi ajo nuk shihet më si e tillë.

Gabimi më i madh i Merkel në këto zgjedhje ishte mbështetja në të njëjtën strategji mbrojtjeje që përdori në dy zgjedhjet e mëparshme, të cilat i fitoi ndjeshëm. Duket se ajo ka supozuar se shmangia e polemikave dhe ruajtja e qetësisë për

çështje kyçe në Europë do të funksiononin edhe një herë. Kjo tregoi gjykim të dobët, duke qenë se kriza e refugjatëve në vitin 2015 dhe pasojat e saj ndaj Gjermanisë, nuk thonë asgjë për rritjen e të djathtës ekstreme Alternativa për Gjermaninë (AfD), e cila mori rreth 13% të votave. Shumë gjermanë kanë pyetur veten se çfarë shtrihet përpara në të ardhmen e vendit të tyre dhe për identitetin kombëtar gjerman.

Merkel nuk ofron përgjigje të mjaftueshme për këto pyetje. Dhe ndërsa mbeti e heshtur, populistët si zv.kryetari i AfD Alexander Gauland mbushën boshllëkun me thirrje të larta ndaj nostalgjisë etnike dhe nacionaliste. Në fakt, fituesi i madh në këto zgjedhje ishte AfD, anëtarët e të cilit përfshijnë neo-nazistë dhe ekstremistë të tjerë. Sukses i partisë është turp për Gjermaninë. Pas 72 vitesh, e djathta ekstreme është kthyer në Bundestag – dhe si blloku i tretë më i fortë. Dhe AfD tashmë është partia e dytë më e madhe në shtetet federale që përbëjnë ish-Gjermaninë Lindore.

Gjermania nuk është i vetmi vend evropian ku populistët e krahut të

djathtë kanë pasur fitore elektorale në vitet e fundit. Por askund nuk është ringritja e të djathtës ekstreme më shqetësuese se në Gjermani, duke marrë shkas nga vetë historia. Për të parandaluar të djathtën nga dëmi i riparueshëm në demokracinë gjermane, partitë që i qëndrojnë vlerave demokratike duhet të marrin seriozisht përgjegjësinë e tyre për të formuar një qeveri të re. Merkel me siguri do të mbetet kancelare në qeverinë e ardhshme. Teksa anëtarët e CDU dhe të CSU e debatojnë çështjen në ditët e ardhshme, ata do të gjejnë se nuk ka alternativë tjetër më të besueshme dhe popullore sa ajo. Me apo pa humbjet elektorale, nuk mund ta largosh kancelaren pa pasur një zëvendësim për të. Merkel është me fat: thikat nuk janë nxjerrë ende; dhe nëse dalin, me gjasa nuk do të kthehen në gjak – të paktën për momentin.

Një tjetër rezultat i papritur i zgjedhjeve është se liderët e SPD tani po diskutojnë për t'iu bashkuar opozitës – sikur pjesëmarrja në qeveri të ishte një mallkim që duhet shmangur me çdo kosto. Kjo do ta bëjë procesin e formimit të qev-

erisë së ardhshme të gjatë dhe të dhimbshëm, që nuk është e pazakontë për politikën gjermane.

Me SPD që refuzon të marrë pjesë në një koalicion të madh, i vetmi opsion i mundshëm matematik që mbetet është një aleancë "Xhamaika" – që ka marrë emrin nga flamuri i Xhamajkës me të zezë, të verdhë dhe të gjelbër – që përbëhet nga CDU/CSU, Demokratët e Lirë liberal dhe të Gjellbrit. Por deri atje nuk do të jetë e lehtë: ndërsa partitë nuk do të kenë shumë telashe të arrijnë kompromiset e nevojshme politike, ata ndryshojnë shumë në mentalitetin e qeverisjes dhe stilin e lidërshiptit. Për më tepër, kalendari politik vendas me shumë gjasa do të zgjasë bisedimet e koalicionit. Liderët e partisë do të marrin qëndrime dhe do të përipiqen të shpëtonjë fytyrën në sytë e votuesve të tyre por kjo nuk do të ndodhë deri pas zgjedhjeve shtetërore në Saksonin e Poshtme në 15 tetor. Dhe edhe atëherë, një qeveri e re nuk do të formohet shpejt. Alternativat e vetme për një koalicion Xhamajkë janë një qeveri minoriteti CDU/CSU ose një zgjedhje e re pranverën e ardhshme, që me gjasa

vetëm sa do të forcojë pozicionin e AfD. Të dyja rezultatet do të jenë të këqija për Gjermaninë, që perceptohet gjerësisht – dhe ofron mbështetje – si një spirancë stabiliteti në Europë.

Kjo nënkupton se e ardhmja e demokracisë gjermane dhe stabiliteti evropian do të varen nëse arsyeja prevalon mes partive më të vogla të mbetura. Partitë Xhamajka kanë një përgjegjësi të mbështesin Merkel dhe të arrijnë në kompromis sa të mundën për të formuar një qeveri. Liderët e tyre, shpresojmë, do të jenë mjaftueshëm të zgjuar të punojnë së bashku në mirëbesim, në vend që të kërkojnë vetëm avantazhe të vogla partizane. Ana mund të fillojë duke bërë reforma në siguri dhe ekonomi dhe me modernizimin ekologjik dhe dixhital si tre shtyllat e një lloji të ri koalicioni. Sa për Merkel, dëshimi për të formuar një qeveri mazhoritare do të nënkuptonte me gjasa fundin e drejtimit të saj si kancelare.

Dhe më gjerësisht, vetëm sa do të nxiste një periudhë të re kaosi politik. Askush nuk duhet t'ia urojë këtë Gjermanisë – apo Europës.

(reporter)



Bardh FRANGU

Komuna si ndërmarrje publike

Vërtet të qeshet kur i dëgjon si flasin për asfalt, për kanalizim, për ujësjellës e për shkollë. Po këto shërbime i kemi kryer vetë si qytetarë edhe gjatë kohës së okupimit serb. Nëpërmjet vetë organizimit kemi mbledhur para për të gjitha këto shërbime dhe i kemi kryer

fundit, madje me shumë minuta vonesë, vetëm e vetëm që t'i dëshmojnë publikut se sa të rëndësishëm janë për ta. Natyrisht se vendet e tyre si zakonisht janë të rezervuara në rendin e parë.

E bëra këtë parantezë shkaku për ta vënë në pah faktin se liderëve tanë para së gjithash u mungon edhe një kulturë, përkatësisht një edukatë elementare, gjë e cila gjithnjë e më shumë po bëhet e

dukshme edhe nëpër këto debatet televizive në kuadër të fushatës paraelektorale. Sigurisht që gjatë këtij muaji do të qeshim me debatet në formë burleske, por ama gjatë katër vjetëve të ardhshme do të qajmë nga problemet që jo vetëm nuk do t'i zgjidhin këta, por, për më keq, edhe nga problemet që do t'i krijojnë vetë. Në fakt këta shërbimet lokalë akceptohen si të tillë nga niveli komunal se në nivel qendror këta nuk kanë më shumë se kuptimin e shërbitorëve të partisë, si të deleguar për ta shndërruar Komunën në ndërmarrje publike të partisë, duke u mbështetur në logjikën se politika vazhdon të jetë biznesi më profitabil në vendin tonë. Dhe këtë mision vazhdojnë ta kryejnë si është më së miri që nga paslufta e deri më sot. Pasi të zënë vend në karrigen e njeriut të parë të Komunës krejt çka duhet të bëjnë është fakti se duhet shpërblyer me një vend pune militantët që vrapojnë pas grum-

bullimit të votave. E kur qeveria lokale bie në duar të tyre, çfarë të mire mund të presin qytetarët? Këta heronj të vegjël tragjikomikë as që e kanë idenë se sa të pafuqishëm janë në zgjidhjen e problemeve me interes për qytetarët. Po nuk kanë edhe pse të lodhen për këtë, ndërsa nuk ekziston institucioni i përgjegjës, por nuk ekziston as sistemi i drejtësisë; mund të abuzojnë e të keqpërdorin sa të duan. Këta nuk kanë nevojë as të kërkojnë dhe as të japin përgjegjësi, këta kanë të vetmin obligim, që t'i shërbejnë si duhet shefit të partisë, i cili njëkohësisht është edhe në rolin e drejtorit gjeneral të ndërmarrjes publike, në këtë rast Komunës. Vërtet të qeshet kur i dëgjon si flasin për asfalt, për kanalizim, për ujësjellës e për shkollë. Po këto shërbime i kemi kryer vetë si qytetarë edhe gjatë kohës së okupimit serb. Nëpërmjet vetë organizimit kemi mbledhur para për të gjitha këto

shërbime dhe i kemi kryer. Po tani kur taksat tona keqpërdoren në format më kriminale, si mund të shpjegohet kjo? Si mund të shpjegohet që ne qytetarët duhet t'i paguajmë pushtetarët, ndërsa ata t'i paguajnë grupet e interesit për të na i shkatërruar pyjet, lumenjtë, fushat, madje për të na i zënë edhe hapësirat publike, deri edhe trotualet, nëpërmjet ndërtimeve të larta pa kriter dhe pa përfillur asnjë kusht urbanistik? Sigurisht që pushteti lokal shpërfaq krizën e pushtetit qendror, ndërsa është i ndikuar drejtpërsëdrejti nga ai. Dhe nuk mund të presim gjë më të mirë në organizimin e jetës dhe të kërkojmë shërbime më të mira dhe më cilësore. Sikur të ishin pak të përgjegjshëm këta liderët lokalë, në vend të premtimeve për krijimin e vendeve të reja të punës do të kishin guxim që të premtinin largimin nga puna të gjithë atyre militantëve partiakë që kanë stërngarkuar institucionet

publike. Kjo edhe për faktin se ata bëhen pengesë në kryerjen e shërbimeve cilësore dhe në anën tjetër abuzohet me taksat tona. Për më tepër, në këtë rast jemi të obliguar që të përfillim standardet evropiane në numrin e të punësuarve në administratë.

Duket krejt e natyrisht që ne do të vazhdojmë ta delegojmë vullnetin tek ata që do të vazhdojnë me politizimin e shkollave për të pasur një cilësi edhe më të dobët në arsim, do të vazhdojnë të delegojnë militantë nëpër institucione shëndetësore për të pasur shërbime edhe më të dobëta që kemi aktualisht. Bazuar në përvojat e deritashme, vota jonë nuk do të na ndihmojë që të dalim fitues as në përballje me bërllokun dhe me qentë endacakë. Sigurisht që këtyre zgjedhjeve mund t'u gëzohen vetëm fëmijët, ndërsa dëgjojmë nga shumica e kandidatëve për kryetarë komunash se prioritet do ta kenë sigurimin e kifleve për ta. (zeri)




Karvahal del me probleme në zemër

Real Madrid ka nxjerrë një raport mjekësor mbi Dani Karvahal, duke bërë të ditur se mbrojtësi spanjoll është i padisponueshëm për ndeshjet e ardhshme. "Në vazhdim të testeve mjekësore të bëra mbi Dani Karvahal, ai është diagnostikuar me probleme kardiake. Rikthimi i tij ende nuk është caktuar dhe do të monitorohet nga mjekët e klubit." - lexohej në komunikatën për shtyp të publikuar nga klubi "Los Blancos".

Me Icardin kam një marrëdhënie të mirë

Paulo Dybala është golashënuesi më i mirë i Serie A me dhjetë gola të shënuar në gjashtë ndeshje. Argentinasi ka filluar të grumbullohet rregullisht me kombëtaren, ku luan me Mauro Icardin, kapiteni i Interit dhe qendërsulmuesi i "Seleccion". Sulmuesi zikalter është në kuotën e gjashtë golave në këtë pjesë të parë të kampionatit. "Unë dhe Mauro kemi një marrëdhënie të mirë", ka thënë Paulo. "Jemi njohur kur luajmë te Palermo, tani kemi fatin të luajmë bashkë në kombëtare. Do të jetë një sfida e bukur këtë vit". Në lidhje me sfidën për titullin e golashënuesit më të mirë të Serie A: "Ai ka më shumë mundësi, sepse luan më përpara, por unë do të luftoj deri në fund", ka përfunduar "La Joya".



FIFA mund të dënojë Spanjën

Shanse për Shqipërinë në Botëror

"The Sun" shkruan se, nëse Barcelona përjashtohet nga La Liga, atëherë FIFA do të detyrohet të marrë masa të rrepta për kombëtaren spanjolle dhe ta përjashtojë për Botërorin "Rusi 2018", edhe pse është në vend të parë në grup. Ky do të ishte një lajm i mirë për kombëtaren shqiptare, që gjendet në grup me Spanjën në eliminatore të këtij Botërori.

Duket një skenar që ekziston vetëm në mendjet e shqiptarëve, por përdërisa prestigjiozja "The Sun" e analizon një mundësi të tillë, gjithçka mund të ndodhë. Dhe nëse ndodh, Kombëtarja shqiptare ka shanse të mëdha që të jetë pjesë e



kompeticionit më të rëndësishëm të futbollit në planet. Po, kuqezinjtë mund të marrin pjesë në Botërorin "Rusi 2018" dhe kjo me "ndihmën" e FIFA-s. Tensionet rreth referendumit të ardhshëm për pavarësinë e Katalonjës kanë shkaktuar kaos në Spanjë pas paralajmërimit se La Liga mund të mbetet pa Barcelona-n. "The

Sun" shkruan se, nëse Barcelona përjashtohet nga La Liga, atëherë FIFA do të detyrohet të marrë masa të rrepta për kombëtaren spanjolle dhe ta përjashtojë për Botërorin "Rusi 2018", edhe pse është në vend të parë në grup. Ky do të ishte një lajm i mirë për kombëtaren shqiptare, që gjendet në grup me Spanjën në eliminatore

e këtij Botërori. Kuqezinjtë do të merrnin pjesë në "play-off" dhe shanset për të zënë një vend në Botëror do ishin të mëdha. Shqipëria ndodhet në vendin e tretë dhe vështirë ta lëshojnë këtë vend. Italia mund të kualifikohet direkt, ndërsa kuqezinjtë do të shkonin në "play-off". Ndwrkohw, FIFA nuk ka dhënë asnjë koment në

lidhje me shpalljen e pavarësisë së Barcelonës dhe klubeve e tjera të Katalunjës pas votimit, qëndrim të cilin Spanja e cilëson do e cilësonte antikushtetues: "Duke ndjekur rregullin e përgjithshëm të FIFA-s, nuk do të ketë komente apo hamendësime për rrjedhën e ngjarjeve", u shpreh një zëdhënës i FIFA-s për "Reuters".

Aktualisht, kuqezinjtë ndodhen në vendin e tretë, me 13 pikë, katër më shumë se Izraeli. Dy ndeshjet e radhës Shqipëria do t'i luajë kundër Spanjës dhe Italisë dhe motivimi pas këtij lajmi duhet të jetë maksimal, të paktën për të siguruar vendin e tretë në grup, që nëse do të skualifikohet Spanja do të na çonte automatikisht në fazën "play off". Në mënyrë direkte, do të kualifikohet Italia.

Cikalleshi i lumtur për golin dhe rikthimin në kombëtare



Sokol Cikalleshi e festoi me gol rikthimin në kombëtaren shqiptare duke shënuar për herë të parë me skuadrën e tij të re, Osmanlisporin. Me nuhatjen e sulmuesit të mirëfilltë, kavajasi ndihmoi ekipin e tij të merrte fitoren e parë në kampionat në suksesin 3-0 ndaj Kasimpashas. Për emisionin "Zona Gol", Cikalleshi tregoi emocionet e golit të tij të parë me skuadrën e re dhe dedikimin për festimin e tij të veçantë. "Ishte ditë e lumtur për mua dhe për ekipin pasi ekipi ka pasur një fillimsezon të dobët por gjërat janë sistemuar disi. Jam i lumtur për fitoren e ekipit por dhe shënimin e golit dhe dedikimi ishte special sepse muaji tetor është muaji që unë dhe bashkëshortja presim fëmijën e parë", deklaroi sulmuesi. Sa i përket rikthimit në kombëtare dhe incidentit me Panuçi në muajin shtator, Cikalleshi dhe njëherë tjetër sqaroi se gjithçka lindi si pasojë e një keqkuptimi. Ndërkohë që dy ndeshjet e fundit të këtyre eliminatorëve e vendosin Shqipërinë përballë Spanjës dhe Italisë, me dëshirën për të zyrtarizuar vendin e 3-të në grup por dhe dëshirën për të bërë një paraqitje të mirë, siç kërkohet dhe vetë Cikalleshi.

Nga keq, në tmerr



Januzaj jashtë fushës në afat të papërcaktuar

Drejtuesit e Real Sociedad kanë konfirmuar: "Adnan Januzaj do të qëndrojë jashtë fushës për një periudhë të papërcaktuar". Futbollisti 22-vjeçar me kombësi shqiptare, që zgjodhi të përfaqësojë Belgjikën, shpresonte të rimëkëmbte karrierën e tij, pasi u transferua gjatë merkatos së verës nga Manchester Junajted, drejt ekipit spanjoll për një shumë prej £8milionë. Por tashmë, pas vetëm katër ndeshjes me ekipin e La Liga, Januzaj përballlet me rrezikun e të qëndruarit jashtë për një periudhë të gjatë kohe. Klubi i Real Sociedad konfirmoi se futbollisti kishte ndërjerë dhimbje të tmerrshme në gjurin e tij pas humbjes 3-1 përballë Zenit St. Petersburg në "Europa League" dhe skaneri ka dëshmuar se mund të ketë një problem serioz. Një njoftim zyrtar citonte: "Adnan Januzaj ka zhvilluar ndeshjen ndaj Zenit St. Petersburg pa u ankuar, apo shfaqur trauma të dukshme, por një orë më vonë ai nisi të ndjejë dhimbje të forta në gjurin e tij të djathtë. Skaneri të cilit iu nënshtrua dje dëshmoi një fuzion artikular të theksuar, që mund të ketë lidhje me operacionin e mëparshëm të meniskut. Plani fillestar është që futbollisti të pushojë dhe ti nënshtruhet fizioterapisë. Rikthimi i tij në aktivitet do të jetë progresiv, dhe do të varet nga përmirësimi i rikuperimit".

Mjeku ia shpëton jetën Useinit

Përplasja e minutës së 20-të e mesfushorit të Flamurtarit, Muhamed Useini me Aleksin e Luftëtarit në ndeshjen e shtunës të javës së katërt në Superligën e Shqipërisë mund të rezultonte fatale për tetovarin. Edhe pse ndoshta nga tifozët në stadium nuk u vërejt dhe nuk iu dha shumë rëndësi atij momenti dhe përplasja me Usein dhe Aleksin, numri 22 i skuadrës vlonjate kishte qenë në rrezik jete, pasi atij iu ishte kthyer gjuha. Ka qenë vetë mjeku i skuadrës së Flamurtarit, Ardian Luka, ai i cili i ka tërhequr gjuhën lartë, duke i shpëtuar jetën mesfushorit tetovar. "Useini humbi nd-



jenjat, i iku gjuha poshtë. Ishte një rast i rëndë, por ndërhyrja në kohë. Nuk kishte koshiencë në ato momente dhe shkuam në spital. Tani lojtari është në gjendje të mirë", - tha mjeku i skuadrës, transmeton "Vip-Sport". Useini në spital kishte qëndruar për pak orë,

ku mjekët kishin intervenuar duke i qepur atij mjekrën pas goditjes së fortë që kishte pasur me futbollistin kundërshtar të Luftëtarit, Aleks. Ndryshe ndeshja midis Flamurtarit dhe Luftëtarit në fund nuk njohu fitues, pasi u mbyll me rezultatin e fillimit 0:0.

Boks, u mbajt xhiroja e dytë

Paraqitje të mira të boksierëve shqiptarë

Shkup, 1 tetor - Të shtunën në palestrën e sportit "Enver Idrizi" në Çair, u mbajt xhiroja e dytë e Ligës së boksit të Maqedonisë ku organizator teknik ishte KB Shkupi, ndërsa pjesëmarrës ishin, "Çairi", "Bargalla", "Shkëndija no Limit", "Ternipe", "AS, Pink Panther", "Uneverzalec", "Ileri" dhe "Aperkat". Ndryshe, KB "Shkupi" u paraqit me pesë boksier, ku tre prej tyre u ngjiten në ring Jasin Lama në kategorinë e seniorëve fitoi Allmir Nurishovin me nokaut në rundin e dytë, Omer Iseni mposhti kundërshtarin e tij Viljams Manevski, ndërsa vlen të theksohet që boksieri i ri nga KB "Shkupi" Rijat Ajdini, i cili u ngjiti për herë të parë në ring edhe pse tregoi boks cilësor me vendim të gjyqtarëve ndeshjen e fitoi kundërshtari i tij Ejdin Jashar. Naser Haruni trajner i KB "Shkupi" është



shprehur i kënaqur si me organizimin poashtu edhe me paraqitjen e boksierëve të tij. "Jam i kënaqur nga paraqitja e boksierëve tanë, por më vjen keq për Hurmet Jonuzin dhe Suhjeb Imerin të cilët nuk kishin kundërshtarë. Unë jam i bindur se edhe ata do të arrijnë fitore. Dua që publikisht të falënderoj publikun ton i cili në mënyrë shumë korrek-

te i përcolli të gjitha luftëtarat, duke duartrokitur të gjithë fituesit", ka thënë Haruni për "portalb", transmeton gazeta KOHA. Derisa, "KB "Çair" në këtë xhiro u paraqit me 10 boksier, por vetëm shtatë prej tyre kishin kundërshtar, duke shënuar tri fitore. " Edhe pse Alimi i cili është pa përvojë, tregoi luftë të mirë dhe ishte pak më i mirë se kundërshtari

i tij që ka shumë përvojë të madhe dhe ishte fitues i "Gongut të Artë", Goce Janveski, po ne si klub u dëmtuam nga referat. Elmedin Istrefi i cili është kampion i Maqedonisë edhe kësaj radhe nuk pati kundërshtar. Por përsëri si klub jemi të kënaqur me paraqitjen e kësaj xhiro. Klubi jon udhëheq në vend të parë në Ligën e parë të Maqedonisë, ndërsa në ligën e të rinjve me këtë paraqitje kalojmë në vend të dytë. Ne si klub synojmë që në dy ligat të fitojmë titullin kampion", është shprehur Salihu. Xhiroja e tretë do të mbahet me 8 shtator ku organizator është KB "Ternipe", ndërsa turneu do të zhvillohet në sallën e Fakultetit të edukatës fizike, ndërsa renditja tabelore pas xhiros së dytë do të publikohet të hënën nga Federata e Boksit të Maqedonisë.

BEDRI SALIU, TRAJNER I KF 'SKUPI'



**SALIU,
THEMELUESI
I KF "SKUPI",
KLUBIT NGA
KU DALIN
FUTBOLLIST
TË NJOHUR**

"Enis Bardhi, i cili tani luan në Levanten qysh në moshë 6 vjeçare deri në moshën 15-vjeçare, i bëri hapat e para në klubin tonë dhe talenti i tij ishte i rrallë. Kishte një etikë të jashtëzakonshme të punës, e absorbonte çdo dituri, çdo teknikë dhe suksesi i tij ishte i pritur, ndërsa unë ndjehem krenar me arritjet e tij të deritanishme", pohon Saliu

Koha **Bujar KURTAJ**

Shkup, 1 tetor - I lindur në Shkup, ndërsa qysh në moshën fëmijërore pos arsimit e kaplon edhe pasioni për sportin. Dhe kështu paralelisht merrej edhe me futboll duke luajtur për klubet si "Vardari", "Rabotnicki" e "Treska", por që nuk zgjati shumë dhe si i ri përfundoi karrierën futbolliste, por duke iu përkushtuar më shumë shkollimit dhe si rezultat i kësaj ai sot është profesor i edukatës fizike në shkollën fillore "Ismail Qemali" në Shkup. Por, edhe pse përfundoi karrierën si futbollist, nuk u largua nga futboli, por vendosi të ndjek kurset për trajner te KF Sloga Jugomagnat tani FC Shkupi, ndërsa posedon edhe licencën për futboll të shkallës më të lartë FIFA. Derisa, aktualisht është themelues i KF "Skupi", nga ku kanë dalë emra të mëdhenj, ndërsa njëri prej tyre është Enis Bardhi. Fjala është për Bedri Saliun, i cili për këto dhe për jetën e tij sportive dhe jashtë saj, i rrëfen në intervistën për gazetën KOHA.

KOHA: Krahas arsimit të kaplon edhe pasioni për sportin, konkretisht futboli. Në cilin

klub i bëre hapat e parë dhe si ka rrjedhur karriera jote?

SALIU: Hapat e para në futboll si futbollist i bëra si fatos në klubin "Vardar" dhe junior në klubin "Rabotnicki". Pas mbarimit të stazhit të juniorëve, më huazojnë në KF "Treska", klub ku si i ri e përfundova karrierën time si futbollist. Pas mbarimit së karrierës si futbollist, iu qasa shkollimit, kurseve dhe seminareve të ndryshme të futbollit, derisa në vitin 1989 fitova licencën për futboll të shkallës më të lartë nga FIFA. Nga ana tjetër karriera ime si trajner filloi në vitin 1995 në KF Sloga J. tani FC "Shkupi", së bashku me legendën e futbollit shqiptar Bajrush Baftjari, të cilit i jam shumë falënderues për diturinë dhe fshehtësitë e futbollit të cilat ai mi zbuloi.

KOHA: Është interesante se je marr edhe me sportin e hendbollit. A është e vërtetë kjo dhe pse nuk vazhdove të merresh me këtë sport po ju përqendrove futbollit?

SALIU: Si nxënës i shkollës fillore "Liria", arsimtarë të edukatës fizike kisha legjendarin Mentaz Allajbegu. Në këtë shkollë i mësuam të gjitha sportet së bashku me

Shaban Sejdiun, Mensur Nexhipin, Faton Ismailin, me një fjalë të gjitha sportet i përvetësuam me ndihmën e Allajbegut dhe në formimin e klubit hendbollistik "Liria" ne u kyçëm ti ndihmojmë klubit në hapat e para të formimit të tij. Un gjithashtu jam marrë edhe me mundje, futboll, hendboll

së bashku me sportistët e lartpërmendur që arritën suksese shumë të larta secili në fushën e vet.

KOHA: Sigurisht se përkrahja nga familja nuk të ka munguar. Por, nga ajo që kemi mësuar është se në ndërtimin e karakterit tuaj sportiv ka

ndikuar edhe i ndjeri Mentaz Allajbegu?

SALIU: Siç e përmenda më lartë, i ndjeri Mentaz Allajbegu përveç që ka ndikuar shumë në zhvillimin sportiv timin, ai ka ndikuar shumë për ndërtimin e karakterit tim edhe si trajner. Do ta kisha përmendur një moment



kur Allajbegu na udhëhiqte në gara sportive çdoherë potenconte atë që nuk keni pse të frikoheni prej kundërshtarit kur edhe ai ka dy duar, dy këmbë një kokë, nuk ka asgjë më shumë se ju. Ashtu na stimulon dhe inkurajonte që të arrijmë suksese të larta, por edhe si trajner e përdori eksperiencën e tij dhe karakterin që e mbolli tek unë.

KOHA: Më shumë se dhjetë vite ke qenë trajner i KF Slloga Jugomagnat, tani FC Shkupi. Prej nga lindi pasioni që të bëhesh trajner dhe jo ndonjë menaxher, apo skaut?

SALIU: Pas mbarimit të karrierës si futbollist, rastësisht KF Slloga J. ngeli pa trajner ashtu që në momentin e duhur së bashku me Bajrush Baftjarin i ofrova punën time në këtë klub edhe vazhdova të punoj me sukses të madh gjatë këtyre 10 viteve dhe të lë gjurmë të thella në këtë klub me zbulimin e talenteve të rinj dhe kultivimin e ndërtimin e tyre si futbollist cilësorë. Edhe me punë menaxherive jam marrë, por në fillim ishte shumë e vështirë pasi licenca paguhesh shumë shtrenjtë. Tani kushtet për tu pajisur me licencë, kanë ndryshuar dhe ajo nuk paguhet fare. Më vonë u pa se më i suksesshëm isha në zbulimin dhe ndërtimin e talenteve, se në shifjen e tyre.

KOHA: Për tu bërë trajner, nevojiten edhe licencat. I posedon këto Bedri Saliu dhe nëpër sa seminare ke marr pjesë për të realizuar këtë?

SALIU: Qysh në Ish-Jugosllavi kisha licencën më të lartë nga FIFA që pata dhënë provimin në Zlatibor. Këtë licencë e kishin trajnerët më të njohur në ish-Jugosllavi dhe si mentor kishim instruktorët më të njohur të futbollit. Licenca tjera për trajner kam marrë në Medulin, në Paliç edhe në Kovergano të Italisë ku u pajisa me licenca më të larta të asaj kohe, por pas vitit 1995 ato licenca nuk i pranon Federata Futbollistike të Maqedonisë për shkak se janë të kohës së Ish-Jugosllavisë dhe duhet të radhitet edhe unë të filloj prej shkallës së parë B dhe A licencë që janë të pranuar nga UEFA.

KOHA: Cilat janë arritjet tuaja gjatë udhëheqjes tënde të KF Slloga (FC Shkupi)?

SALIU: Gjatë punës time në KF Slloga J. shumë herë jemi bërë kampion të Maqedonisë dhe me gjeneratat e reja, derisa kemi arritur të nxjerrim futbollist cilësorë të cilët ndërkombëtarisht kanë qenë të suksesshëm. Kënaqësia ime më e madhe është se nga futbollistët e suksesshëm shumica e tyre përveç që ishin futbollist të mirë, mbaruan arsimin superior edhe disa prej tyre shkuan edhe gjurmëve të mija si trajner profesorë të suksesshëm siç janë Visar Ganiu, Meriton Berisha, Jeton Musliu, të cilët përsëris u bënë trajner dhe pedagog shumë të suksesshëm.

KOHA: Pasi u largove nga Slloga J. hape shkollën e futbollit "Skupi". Prej nga lindi ideja që të hapësh këtë shkollë dhe ta emërosh me emrin "Skupi"?

SALIU: Pasi hapa një teren sportiv në lagjen Fushë Topanë me barë artificial dhe reflektorë, ndërsa aso kohe te Slloga J. mungonin kushtet elementare për trajnim, me iniciativën e disa prindërve si Kemajl Ajdini, Behar Haxhihamza e disa të tjerë, themelua Klubin futbollistik "Skupi" dhe filluam hapat e para në këtë klub.

KOHA: Cilat janë arritjet tuaja më të mëdha me këtë klub, duke marr parasysh se ke marr shumë pjesë nëpër shumë



turnirë, kurse njëri prej tyre është edhe ai "Norway Cup"?

SALIU: Përveç që kemi marrë pjesë në shumë turnirë ndërkombëtare, në rajon dhe më gjerë në Evropë, ne jemi edhe fitues të shumë turnirëve prestigjioze si 'Norway Cup - dy herë fitues të Kupët 2006 dhe 2016; 4 herë fitues të Kupës 'Trofeo Mediterano' në Barcelonë; Fitues të kupës 'Marez Ma Barcelonë'; si dhe kemi marr pjesë dhe kemi arritur suksese në turnirët në Vjenë, Danimarkë, Izmir të Turqisë Tiranë, Prishtinë etj.

KOHA: Nuk ka dyshim se gëzon reputacionin si një ndër trajnerët me më perspektivë të Maqedonisë, ndërsa ajo që është më e rëndësishmja njihesh si zbulues i talenteve duke marr parasysh se pikërisht nga KF "Skupi" kanë dal futbollist të cilët sot po lejnë shenjë, ndërsa njëri prej tyre është Enis Bardhi?

SALIU: Po është e vërtetë se Enis Bardhi, i cili tani luan në Levanten qysh në moshë 6 vjeçare deri në moshën 15-vjeçare, i bëri hapat e para në klubin tonë dhe talenti i tij ishte i rrallë. Kishte një etikë të jashtëzakonshme të punës, e absorbonte çdo dituri, çdo teknikë dhe suksesi i tij ishte i pritur, ndërsa unë ndjehem krenar me arritjet e tij të deritanishme.

KOHA: A kemi kontakte me Bardhin dhe a vjen ju viziton juve dhe klubin ku ka luajtur si fëmijë?

SALIU: Çdo herë që Bardhi vjen në Shkup, ai vjen dhe na viziton. Tani së fundmi na bëri nder pasi erdh dhe bëri hapjen solemne të turnirit ndërkombëtarë që organizoi 'Skupi' për përvjetorin e themelimit të klubit. Për mua por edhe të pranishmit ishte një privilegj i madh që në mesin tonë ishte një yll siç është Enis Bardhi.

KOHA: Po aktualisht te "Skupi" ka lojtar që mund të shkojnë hapave të Bardhit dhe të tjerëve?

SALIU: Sigurisht se ka. Ka shumë fëmijë super të talentuar, por problem kyç është që nën

moshën 18-vjeçare si shtet jashtë BE-së nuk mund të luajnë në ndonjë klub Evropian.

KOHA: A ke menduar të braktisësh "Skupin" dhe të fillosh të marrësh dhe të udhëheqësh ndonjë ekip të Ligës së parë apo të dytë e pse jo edhe në Kosovë?

SALIU: Mungesa e Pro licencës që kërkohet për udhëheqjen e ekipit të ligës së parë pasi siç e thash më parë licencat e Ish-Jugosllavisë nuk pranohen më në Maqedoni, janë arsyt pse nuk kam udhëhequr ndonjë klub të ligës së parë.

KOHA: Si e komenton faktin se në Shkup janë hapur shumë shkolla të futbollit. A mendon se kjo është në rregull ose?

SALIU: Shumë është pozitive hapja e shkollave të reja të futbollit, pasi përfshihen të gjithë fëmijët nëpër këto klube të futbollit. Në kohën time ka qen shumë e vështirë dhe kemi pasur problem shumë të madh, pasi mundeshim vetëm në tre klube të ushtrojmë tani mundësit janë më të mira.

KOHA: Cili është momenti më i mirë dhe më i keq gjatë jetës tuaj sportive?

SALIU: Momente të këqija nuk kam pasur, ndërsa momenti më i mirë ishte në vitin 2006 ndeshja 'Skupi' - Sao Paolo nga Brazili në kuadër të ndeshjes finale të 'Norway Cup', ndeshje e cila u luajt para pesë mijë shikuesve dhe gjithë auditoriumit norvegjez pasi ndeshja transmetohej në televizionin nacional. Derisa, kënaqësia më e madhe ishte fitorja jonë ndaj skuadrës nga Brazili dhe fitorja e trofeut

KOHA: Kush është në jetën private Bedri Saliu?

SALIU: Un jam bashkëshort dhe prind i dy fëmijëve Urimit dhe Blerinës. Bashkëshortja ime Sebahatja ka qenë përkrahja ime më e madhe gjatë rrugëtimit tim. Pa përkrahjen e bashkëshortes dhe fëmijëve të mi, nuk do të kisha mundur ti arrij të gjitha këto suksese. Këto janë meritore për punën e bërë gjer tani.



“ Momente të këqija nuk kam pasur, ndërsa momenti më i mirë ishte në vitin 2006 ndeshja 'Skupi' - Sao Paolo nga Brazili në kuadër të ndeshjes finale të 'Norway Cup', ndeshje e cila u luajt para pesë mijë shikuesve dhe gjithë auditoriumit norvegjez pasi ndeshja transmetohej në televizionin nacional. Derisa, kënaqësia më e madhe ishte fitorja jonë ndaj skuadrës nga Brazili dhe fitorja e trofeut



I parashikoi Ançelotit shkarkimin që në konferencë

Gazetari nigerian kthehet në njeriun e ditës

Gazetari nigerian, i cili jeton në Gjermani, nuk ngurroi t'i bënte pyetje rreth shkarkimit të mundshëm trajnerit italian, edhe pse u shoqërua nga të qeshurat si të Ançelotit, ashtu edhe gazetarëve të tjerë të pranishëm në sallë. Videoja e konferencës është shpërndare më shpejtësi në internet dhe në 24 orët e fundit, gazetari nigerian ka qenë njeriu i ditës për pyetjen e guximshëm që bëri dhe që në fund rezultoi ajo e duhura



Oma Akatugba është kthyer në njeriun e ditës pasi arriti të parashikonte shkarkimin e Karlo Ançelotit nga Bajern Munih para ndeshjes me PSZH-në. Gazetari nigerian, i cili jeton në Gjermani, nuk ngurroi t'i bënte pyetje rreth shkarkimit të mundshëm trajnerit italian, edhe pse u shoqërua nga të qeshurat si

të Ançelotit, ashtu edhe gazetarëve të tjerë të pranishëm në sallë. "A jeni i shqetësuar se mund të humbi vendin e punës nëse mundeni nesër nga PSZH", pyeti ai, ndërsa Ançeloti u mundua ta kalonte gjithçka me humor. "Pyetje e fortë, nga je ti?", ishin fjalët e trajnerit. "Jam nga Nigeria dhe futbollit evropian është shumë popullor në Nigeri, prandaj jam këtu", vijoi

gazetari. "Jam i lumtur që nigerianët kujdesen për jetën time", u mundua të ironizonte Ançeloti. "Por nuk mendoj se do të ndodhë. Nesër është një ndeshje e rëndësishme, është e vërtetë që nuk e nisëm në maksimum sezonin, por është vetëm fillimi. Ndaj do të jetë një ndeshje e rëndësishme nesër, jo vendimtare", tha ai. Por pavarësisht mënyrës se si Ançeloti e përshkroi sit-



uatën në konferencën për shtyp para ndeshjes, fjalët e gazetarit rezultuan që të ishin një parashikim i mirëfilltë për atë që do të ndodhte pas sfidës me PSG-në. Videoja e konferencës është shpërndare më shpejtësi në internet dhe në 24 orët e fundit, gazetari nigerian ka qenë njeriu i ditës për pyetjen e guximshëm që bëri dhe që në fund rezultoi ajo e duhura.



Kin hyn në planet e Florentino Perez

Ai është njeriu i momentit. Harry Kin është në një periudhë spektakolare të karrierës së tij, pasi këtë të shtunë ka shtuar edhe më shumë numrin e golave të shënuar në Premier Ligë. Pa asnjë dyshim, sulmuesi i përfaqësueses së Anglisë që aktivizohet te Tottenham në Premier Ligë, ka dëshmuar se është numri '9' më i mirë në botë. Një pozicion që te Real Madrid është vënë në dyshim prej kohësh. Benzema nuk bind më shumë te Real Madrid dhe largimi i Moratas ka lënë një boshllëk në skuadër, sikurse ka pranuar edhe vetë Zinedin Zidane në një deklaratë të mëparshme. Kjo është arsyeja, që sipas "Don Balon", presidenti i Real Madrid, Florentino Perez po lëviz të gjitha armët e tij për të siguruar shërbimet e numrit '9' më në formë për momentin. Marrëdhëniet fantastike mes klubit nga Madrid dhe Tottenham janë dëshmuar në të kaluarën nëpërmjet transferimeve të Modric dhe Bale, ndërsa tashmë po afrohet radha e Kin. Sulmuesi është shndërruar në fiksimin e ri të Florentino Perez, sidomos pas performancës së tij të fundit dhe kjo është arsyeja pse numri 1 i "Los Blancos" synon të bëjë të tijin një bomber që shënon gola dhe zhblokon ndeshje të vështira. Harry Kin hyn forcërisht në axhendën e Real Madrid.

Publicitet

KONKURS

Për pjesëmarrje në festivalin për fëmijë "BILBILAT E KORABIT" 2017

Të interesuarit duhet të përmbushin këto kushte:

- Të drejtë konkurrimi kanë autorë të këngëve për fëmijë në gjuhën shqipe, të papublikuara e me tekste nga bota e fëmijëve.
 - Këngët konkurruese dorëzohen të gatshme, të incizuara në CD e të shoqëruara me tekstin e këngës të shkruar në letër.
 - Vetëm këngët e pranuar nga juria e festivalit do të konkurrojnë për çmime të festivalit.
 - Materialet e gatshme duhet të dorëzohen në zyrat e Festivalit "Bilbilat e Korabit" që gjenden në Qendrën për kulturë Dibër.
 - Konkursi është i hapur deri më 15 Tetor 2017.
 - Festivali do të mbahet në muajin Tetor 2017, në Qendrën për kulturë Dibër.
- Informata në tel: 070-639-993
e-mail: bilbilatekorabit@hotmail.com
Festivali "Bilbilat e Korabit" 2017

Prishtë stadiumi, lëndohen tifozët, ndërpritet ndeshja Amiens-Lill



Ndeshja e Ligue 1 në Francë mes Amiens dhe Lill është ndërprerë dhe nuk është zhvilluar sepse janë rrëzuar barrierat e tifozëve në sektorin ku ish vendosur miqtë. Tifozët e lënduar nga ky incident i paprecedent kanë marrë menjëherë ndihmën e shpejtë nga shërbimi i emergjencës.

Fatmirësisht nuk ka pasur viktima, por ka dhjetëra tifozë që janë shtruar në spital. Incidenti ndodhi në minutën e 15-të të ndeshjes së luajtur në stadiumin e Amiens "Stade de la Licorne", me kapacitet 12 mijë vende. Në fakt kur miqtë shënuan me anë të Fode Ballo-Toures, i cili shkoi të festonte te tifozët miq, të cilët gjatë entuziazmit shkuan te hekurat rrethues të stadiumit, të cilat nuk mbajtën peshën dhe u rrëzuan duke marrë me vete tifozët e mbështetur në to.

Messi më kërkoi të shkoja te Barça gjatë ndeshjes

Paulinjo ka zbuluar se një bashkëbisedim i zhvilluar mes tij dhe Lionel Messit gjatë një ndeshjeje i ka hapur rrugën transferimit të tij te Barcelona. Ish-mesfushori i Tottenham ka nënshkruar me klubin katalanas në gusht, me Barcelonën që ka shpenzuar 40 milionë euro për ta marrë nga klubi kinez i Guangzhou Evergrande. Gjithsesi, tani është zbuluar se Messi kishte filluar të punonte për rekrutimin e tij që në muajin qershor, kur të dy lojtarët kanë luajtur kundër njëri-tjetrit në një miqësore të zhvilluar mes Brazilit dhe Argentinës. Pavarësisht rivalitetit që ekziston mes dy vendeve, ylli i Barcelonës ka përfutur nga rasti për ta pyetur kundërshtarin e tij në lidhje me mundësinë që të luajnin bashkë në Spanjë. "Po bëhesha gati që të gjuaja një goditje dënimi në një ndeshjeje mes Brazilit dhe Argentinës", ka thënë Paulinjo për "El Periodico". "Papritur, pashë Messin mbrapa meje që po afrohej



dhe ai më tha 'do të shkojmë te Barcelona apo jo?' Unë i thashë, 'nëse ti do të më çosh atje, mundesh. Do të shkoj'. Isha aq i emocionuar sa i thashë Willian, 'gjuaje ti goditjen e dënimit'. Pas ndeshjes këmbëva fanellën me Messin. Nuk më la ta gjuaja atë goditje dënimi, por tani jam këtu", deklaroi Paulinjo.

Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

MKD
СЕРТИФИКАТ
MKC EN ISO 9001:2009

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë
SHIPALL

Kërkesë për dhënie e Lejes për hulumtime hidrogeologjike me qëllim ndërtimin e puseve. Në pajtim me nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit të ujërave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14 dhe 146/15), deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë është dorëzuar Kërkesë për dhënie e Lejes për hulumtime hidrogeologjike me qëllim ndërtimin e puseve me nr. ark. PA1 nr. 11/5-938/2017.

Parashtrues i kërkesës
SHA MAKSTIL Shkup
Komuna e Gazi Babës
Lokacioni konkret është në PK 2232 Gazi Babë, bëri gjetjen e tyre me një bazë të sistemit gjeozezik Gausit Krieger me koordinatat në vijim

Pika	Koordinata X	Koordinata Y
T-1	4 651 978	7 358 915
T-2	4 651 981	7 359 759
T-3	4 651 972	7 359 771
T-4	4 651 692	7 359 786
T-5	4 651 684	7 358 944
T-6	4 651 730	7 358 921

Informata në lidhje me kërkesën, opinioni i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail k.zekiri@moepp.gov.mk
Opinion i përfshirë në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të kërkesës, ka të drejtë të dorëzojë mendime dhe komente në formë me shkrim deri në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, bulevardi Goce Dellçev nr. 18 ndërtesa e RTM (kati 10), 1000 Shkup.



Epiteti "makiavelist", sipas Fjalorit Anglisht të Oksfordit, do të thotë "dinak, intrigant dhe mashtrues", dhe përdoret rregullisht nga gazetarët për figura të ndryshme politike. Por a mund të përdoret edhe për vetë Nikolo Makiavelin (1469-1527)? Më poshtë po paraqesim ligjëratën e Endrju Kempëll në Universiteti College të Londrës...

Makiavelist është një person që ndjek parimet e Makiavelit, dhe dikush "që ndjek interesin vetjak në vend të moralit". Ky përkufizim, së bashku me përcaktorët "dinak, intrigant dhe mashtrues", është reduktuar shpesh në maksimumin "qëllimi justifikon mjetin". Gazetarët e përdorin shpesh këtë epitet për politikanët, por shqyrtimi i veprës së Makiavelit, dëshmon se ky term gjithashtu mund të aplikohet edhe për vetë Makiavelin - por vetëm me disa aspekte të caktuara. Makiaveli e shkroi "Princin" në vitin 1513, ndërsa ndodhej i mërguar larg nga Firenze. Ai i kishte shërbyer qeverisë fiorentine në pozicione të ndryshme nga viti 1498, duke u bërë përfundimisht sekretar i kancelarit të dytë, një detyrë që përfshinte edhe misionet e shumta diplomatike. Gjatë këtyre udhëtimeve jashtë vendit, Makiaveli takoi shumicën e personazheve që do të shfaqen edhe tek vepra e tij kryesore, si Çezare Borxhia, i biri i Papës Aleksandrit VI. Karriera politike e Makiavelit filloi të shkëlqejë pasi familja sunduese Medici u dëbua nga Firenze në vitin 1494. Qeveria e parë që e zëvendësoi, 'teokracia' e murgut domenikan Xhirolamo Savonarola, përfundoi me ekzekutimin e këtij të fundit në vitin 1498, para se Piero Soderini të zgjidhej gonfalonieri (udhëheqës) i përjetshëm në vitin 1502. Po atë vit Medicët, të mbështetur nga trupat spanjolle, përmbysën Soderinin dhe rimorren kontrollin e Firencës.

Shumë shpejt Makiaveli u akuzua për konspiracion, u torturua dhe burgos, para se të internohej në pranverë të 1513-ës në fermën e tij në Sant'Andrea në Perkuzina jashtë qytetit. Në 10 dhjetor 1513, Makiaveli përshtuante jetën e tij të përditshme në një letër drejtuar Françesko Vettori. Pas darke, shkruante ai, pëlqente të tërhiqej në studion e tij dhe të "bisedonte" me filozofët dhe mendimtarët e lashtë, përpara se të shkruante shënime mbi këto biseda. Këto debate, dhe përvojat e tij si kance-

Po sa makiavelist ishte vetë Nikolo Makiaveli?

Emri i tij është bërë simbol i intrigës

lar i dytë, formësuan thelbin e "Princit, siç e pranon edhe vetë Makiaveli në parathënien e tij. Ai pohoi se dhurata më e çmuar që mund t'i ofronte Lorenzo di Piero de Medici, nipi i Lorençit të Mrrekullueshëm (1449-1492), i njohur si udhëheqësi de fakto i Firences, ishte "kuptimi i tij mbi veprat e njerëzve të mëdhenj", të cilën ai e kishte fituar falë "një njohje të gjatë me çështjet bashkëkohore, dhe një studim të vazhdueshëm të botës së lashtë".

E VËRTETA E VËRTETË

Qe kjo përzjerje e përvojës personale dhe studimeve, ajo që krijoi 'zembrën e errët' të Princit, domethënë kapitullin XV-XIX, në të cilat Makiaveli përshkruan virtutet e nevojshme të një "princi të ri". Ky dallim është i rëndësishëm, sepse shqetësimi i vetëm e Princit të ri duhej të ishte "ruajta e gjendjes së tij", si në rrafshin personal ashtu edhe politik, prandaj Makiaveli kishte përshatur këshillat e tij në përputhje me rrethanat. Sikurse e bëri të qartë në fillim të kapitullit XV, ai kishte pak kohë për republikat e idealizuara apo utopitë: "përderisa qëllimi është të them diçka që do të dëshmohej praktike për të interesuarit, kam menduar se është rruga e duhur të paraqit gjëra që janë të vërtetat reale, dhe jo siç janë imagjinuar". Dëshira e Makiavelit për të reflektuar "të vërtetën", sikurse e e kuptonte atë, e detyroi të ndryshojë ose shpërfillë modelet klasike dhe të etikës kristiane, që kishin dominuar teoritë politikës mesjetare dhe të Rilindjes për shekuj me radhë. Burimi kryesor i Makiavelit për kapitullin mbi virtutet princërore ishte vepra e Ciceronit "Mbi detyrën", më e popullarizuara e prozës klasike latine në epokën e Rilindjes. Një nga veprat e fundit e fundit të Ciceronit, ishte një diskutimi i parimeve themelore të detyrës morale dhe rregullat praktike për sjelljen personale, të ndarë në tre libra, ku i treti shqyrtonte konfliktin midis ndershmërisë morale dhe leverdisë. Qasjet e Ciceronit dhe Makiavelit ndaj kësaj çështje, ishin tejet të kundërta. Për Ciceronin, nuk kishte asnjë konflikt: "nuk është asnjëherë e përshtatshme të kryhen veprime të këqija, pasi e gabuara është gjithnjë e pamoralshme; dhe



është gjithmonë e dobishme të jesh pozitiv, sepse mirësia është gjithmonë e moralshme".

Nga ana tjetër, në kapitullin XV të "Princit", Makiaveli zbuloi një qasje më pak njëngjyrëse mbi këtë çështje: "në rast se një princ dëshiron të ruajë sundimin e tij, ai duhet të jetë i përgatitur të mos jetë i virtutshëm, dhe ta përdorë ose jo virtutin sipas nevojave". Disa vese mund t'i sjellin princit "siguri dhe prosperitet", ndërsa virtutet e caktuara mund të shkaktojnë rënien e tij.

FORCA DHE DINAKËRIA

Kur vinte puna tek mashtrimi, Ciceroni ishte po aq e qartë. Lavdia e vërtetë nuk vinte nga pretekstet apo mashtrimi, madje edhe në kohë lufte, kur shfaqeshin një mori



veprimesh të pandershme e megjithatë ende të përshtatshme. Ciceroni shkruante se forca dhe dinakëria i përkasin luanit të fuqishëm dhe dhelpër dinake, përkatësisht duke qenë të dy "krejtësisht të padenja për njeriun". Makiaveli përdori të njëjtën analogji dhelpër-luan në kapitullin XVIII-të të "Princit", megjithëse në një mënyrë haptazi të ndryshme. Princi i ri duhet të dijë se si sillen dhelpëra dhe luani, pasi forca pa dinakërinë do të çonte në shkatërrimin e tij: "Një sundimtar i matur nuk mund dhe s'duhet të nderojë fjalën e tij kur kjo e vendos në një pozitë jo të favorshme". Arsyetimi i tij ishte cinik, por i sinkertë: "Nëse të gjithë njerëzit ishin të mirë, ky rregull do të ishte mirë; por për shkak se njerëzit

janë krijesa të mjera që nuk e mbajnë fjalën e tyre, edhe ju s'duhet të mbani fjalën tuaj ndaj tyre". Dy gjëra dyfish negative sipas mendimit të Makiavelit, prodhonin herë pas here një element pozitiv.


Makiaveli pati një qasje të ngjashme edhe ndaj mizorisë. Për Ciceronin, nuk ka mizori që mund të jetë e dobishme, pasi "mizoria është pjesa më e neveritshme e natyrës njerëzore, "të cilën me shpesh e praktikojmë". Makiaveli e shqyrtoi këtë çështje në kapitullin VIII, duke analizuar karrierën e dy sundimtarëve mizorë por efektivë: Agatoklit (361-289 P.E.S), tiranit grek të Sirakuzës dhe mbreti i Sicilisë; dhe Oliveroto nga Fermo (1475-1502), një mercenar i cili vrau xhaxhain e tij për të marrë kontrollin e qytetit të tij. Pasi rrëfen aktet e tyre, Makiaveli shkruan: "Ne mund të themi se mizoria është përdorur mirë (nëse është e lejueshme për të folur në këtë mënyrë mbi atë që është e keqe), kur ajo përdoret vetëm në një rast dhe kur nga ajo varet siguria e dikujt ". Ajo mund të ketë qenë e keqe, por princi i ri duhet ta përdorte për të ruajtur pozitën e tij. Makiaveli studioi luhatjet e natyrës njerëzore, jo vetëm në mënyrën që kishte menduar Ciceroni. Megjithatë Makiaveli nuk ishte kundër Ciceronit në të gjitha aspektet. Ky i fundit theksonte rëndësinë e patronazhit, por që kundër dhuaratave në para, për shkak se dhënësit së shpejti do t'i shteronin burimet e tij dhe do të detyrohej t'u armbente pronën e të tjerëve për të financuar bujarinë e mëtejshme. Në kapitullin XVI Makiaveli rekomandon një qasje të ngjashme, duke deklaruar se është më mirë të cilësosh dorështrënguar se sa bujar, sepse me kalimin e kohës princi do të kuptojë se ai është në gjendje të jetojë brenda mundësive të tij, çka është një formë e bujarisë ndaj tyre.

SHMANGIA E URREJTJES

Makiaveli nuk inkurajoi asnjëherë sjelljen imorale për interesin e vet. Për më tepër, ka pasur një kufi të fundëm, se kur princat e rinj duhej të silleshin në mënyrë imorale: ata s'duhet të pësonin urrejtjen e subjekteve të tyre. Shmangia e urrejtjes ishte kufiri i çdo sjellje devijante, një element që Makiaveli e ka theksuar në disa raste tek

"Princi": njerëzit ankohen për kopracët, por unë nuk i urrej ata (kapitulli XVI); është më mirë të të kenë frikë se sa të të duan, por edhe shmangia e urrejtjes është e preferueshme (Kapitulli XVII); ndërsa kalaja më efektive nuk është e urreyer nga ata që ju sundoni (Kapitulli XX). Sikurse e nën të qartë, këshilla e tij pasqyron rrethanat e lexuesit e tij të synuar. Mjerisht, të paktën për reputacionin e Makiavelit, këto rrethana ndryshuan në mes të vitit 1513, kur shkroi edhe "Princin", dhe në vitin 1532, kur vepra u botua (vetëm një nga veprat e Makiavelit, Arti i Luftës i vitit 1521, u botua gjatë kohës që ishte gjallë). Në ato 19 vite Reformacioni ishte përhapur në të gjithë Evropën, kështu që shërbimi që Makiaveli ia kushtoi fesë në tekst - të qenit fetar ishte një nga cilësitë që princi duhet të kishte, ndërsa një mëshirë e tepuar e dëmtoi aftësinë e gjeneralit romak Skipion - mori një rëndësi që ai s'mund ta kishte parashikuar. Disa nga më reagimet e hershme dhe më të dhunshme ndaj "Princit", si ajo e Kardinalit Rexhinald Pol (Kryepeshkopi i fundit katolik i Kantërbërit), i cili deklaroi në vitin 1539 se kjo veper që "shkruar nga gishti i djallit", apo edhe vepra e Inoçent Zhenitil "Anti-Makiavel" e vitit 1576, qenë pasojë e ngjarjeve fetare - Reformacionin Henrikian (ndryshimet fetare gjatë mbretërimit të Henrikut VIII) dhe Masakra së Shën Bartolomeut në vitin 1572 (dhjetëra mijëra hynegotë ose protestantë sikurse njihen sot u vranë gjatë luftërave fetare në Francë). Kritika e Zhenitil ndaj "Princit" ishte ndoshta përgjegjëse për popullaritetin e madh të termit 'makiavelik' në kuptimin e saj modern negativ. Deri në fund të shekullit XVI-të, Makiaveli ishte shndërruar në një personazh të retorikës, makinator i dramës elizabetiane dhe jakobeane sesa një figurë e autoritetit. Megjithatë, shumë prej kritikëve të Makiavelit nuk e kishin lexuar "Princin" dhe nuk u përpoqën të "bisedojnë" me të në një mënyrë që Makiaveli kishte bërë me autorët e lashtë.

Siç e dëshmojnë edhe citimet e shkurtra të paraqitura më lart, Makiaveli nuk e meriton plotësisht një demonizim të tillë. Qëllimi i vetëm që justifikon mjetet e "dinakërisë, intrigës dhe mashtrimit", sipas mendimit të Makiavelit, është ruajtja e pozitës së princit të ri. Ai mund të ketë mbështetur "përshtatshmërinë në preferencë ndaj moralit", por vetëm për shkak se njerëzit qenë "krijesa të mjera" të cilët silleshin shumë keq. Pasqyra për princin e ri të Makiavelit, reflekton papërsosmëritë e subjekteve dhe kohës së tij, po aq sa edhe cilësitë pozitive të sundimtarit. (bota.al)



“Rrjedhimisht, komisionit të ri duhet t’i jepet kohë që të përgatisë dhe të propozojë versionin e ri për të cilin shumë nga anëtarët e komisionit të ri kanë pasur një qasje të duhur dhe të drejtë”, tha Donika Kadaj-Bujupi

Kosovës i kanë kaluar afatet për aplikim në UNESCO

Aplikimi i Kosovës për anëtarësim në UNESCO duket se mund të dështojë. Të paktën kështu shkruan sot gazeta Blic e Serbisë e cila duke u mbështetur në burimet e veta, thotë se Kosovës i kanë humbur afatet. “Këshilli Ekzekutiv i UNESCO-s fillon më 4 dhe mbaron më 18 tetor ku diskutohet agjenda e Konferencës së Përgjithshme e cila do të mbahet nga 30 tetori deri më 14 nëntor. Sipas rregullores së punës, të paktën një muaj para kësaj, është e nevojshme që të paraqitet propozimi për futjen e një pike në rendin e ditës. Që i bie se Kosova është vonuar”, thonë burimet e Blic. Por sipas këtij raporti, mënyra e vetme për aplikim është për të shkruar drejtpërdrejt me shtimin e një pike të rendit të ditës, e cila duhet të votohet me një shumicë të thjeshtë. Sipas Blicit kjo mund të bëhet me kërkesën e Shqipërisë, që mund ta fus në rend të ditës votimin për Kosovën. Por edhe këtë opsion e ka hedhur poshtë ambasadori serb në UNESCO, Darko Tanasković. “Duke pasur parasysh faktin se kërkesa e Kosovës për praninë në UNESCO në vitin 2015 u hodh poshtë, kërkesa e re duhet të kalojë nëpër të gjitha procedurat dhe dërgimin e letrave te Drejtori i Përgjithshëm i UNESCO-s, me rekomandimet e tij për Ekzekutivin, rekomandimet e Këshillit për Konferencën e Përgjithshme. Nuk ka as procedura ligjore dhe asgjë tjetër që mund ta shkurtojë këtë procedurë, edhe nëse ata mbrohen nga Shqipëria”, tha Tanasković. Kosova është tërhequr edhe nga aplikimi në Interpol, me arsyetimin se ka pasur mungesë të votave.

Demarkacioni me Malin e Zi ende mbetet një sfidë serioze për institucionet e vendit. Kryeministri Ramush Haradinaj shpreson se komisioni i ri do ta vlerësojë saktë kufirin midis dy shteteve derisa thotë se Kosova nuk a votë për versionin aktual. Ndërsa, kryetari i LDK-së Isa Mustafa mendon se duhet të kryhen kushtet e caktuara nga BE-ja për liberalizimin e vizave. Në Vetëvendosje presin nga komisioni i ri ta bëjë rishikimin e marrëveshjes nga fillim



Demarkacioni, pozicionet e Haradinajt e Mustafës të pandryshuara

Isa Mustafa edhe tash kur ndodhet në opozitë dhe nuk është kryeministër, në një deklaratë për rtv21.tv ka bërë të ditur se vazhdon ta mbajë qëndrimin e njëjtë për marrëveshjen e demarkacionit, të nënshkruar në Vjenë më 26 gusht 2015. “Tash unë nga kjo pozitë nuk dëshiroj të jap udhëzime se si kjo gjë duhet të bëhet, sepse duhet t’i marrin përgjegjësitë qeveria e tanishme edhe Kuvendi, por jam i bindur se ne duhet të plotësojmë kushtet e BE-së”, tha Mustafa. Ai më tutje konstatoi se duhet gjetur zgjidhje për lëvizje të lirë të qytetarëve të Kosovës në Zonën Shengen. “Unë mendoj se duhet të gjindet zgjidhja për liberalizimin e vizave, por edhe për plotësimin e kushtit të Bashkimit Europian për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi”, tha Mustafa. Njëri nga kriteret e mbetura të Komisionit Europian që institucionet kosovare duhet ta plotësojnë për liberalizim

vizash është demarkacioni me Malin e Zi. Kushti tjetër është një historik solid i luftës kundër korrupsionit dhe krim-it të organizuar. Por Ramush Haradinaj tha për RTV 21 se për versionin aktual të demarkacionit nuk ka vota në Kuvend. “Nuk ka votë Kosova për këtë version. Kjo është e vërtetë. Kush doni me ia qitë lapsin e gjani që s’janë dy të tretat për këtë version”, tha Haradinaj. Edi Rama, Kryeministri i Shqipërisë, kur Haradinaj vizitoi Tiranën të mërkurën, tha që beson se

Haradinaj do të lëvizë nga pozicioni i tij opozitar për demarkacionin, tash kur është në qeveri. Por Haradinaj në vendimin e tij të parë si kryeministër shkarkoi pikërisht komisionin që caktoi vijën kufitare me Malin e Zi, sipas marrëveshjes së gushtit 2015, duke emërua anëtarë të rinj të këtij komisioni. Haradinaj tha për RTV 21 se komisioni i emëruar prej tij do ta gjejë të vërtetën e kufirit me Malin e Zi. “Ata që janë në komision, ata e gjejnë të vërtetën. Atë të vërtetë ne ose do ta bëjmë marrëveshje me

Malin e Zi, ose nuk ka marrëveshje”, tha Haradinaj. Edhe deputetja e Vetëvendosjes Donika Kadaj-Bujupi pret që komisioni i ri ta korrigjojë marrëveshjen aktuale. “Rrjedhimisht, komisionit të ri duhet t’i jepet kohë që të përgatisë dhe të propozojë versionin e ri për të cilin shumë nga anëtarët e komisionit të ri kanë pasur një qasje të duhur dhe të drejtë”, tha Donika Kadaj-Bujupi, duke shtuar se po pret që ata të dalin me versionin e korrigjuar.

PACOLLI KËRKON PËRFSHIRJEN E SHBA-VE NË DIALOGUN KOSOVË-SERBI

Zëvendëskryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka thënë se përfshirja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë është e domosdoshme, raporton “Zeri.info”. Sipas Pacollit, kjo për faktin se edhe në të kaluarën SHBA-të kanë pasur rol vendimtar në përfundimin e luftërave të përgjakshme në ish-Jugosllavi, ndërtimin e paqes dhe garantimin e stabilitetit në Evropën Juglindore, respektivisht Ballkanin Perëndimor. Sipas tij, një marrëveshje përfundimtare-historike në mes të Kosovës dhe Serbisë pa përfshirjen e SHBA-ve është pothuajse e paimagjinueshme.



Anëtarësimi në Këshillin e Evropës, një rrugë e gjatë për Kosovën

Edhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O’Connell ka thënë se procesi i anëtarësimit në Këshill të Evropës kërkon shumë reforma, sidomos në fushën e ligjit dhe të drejtave të njeriut. Sipas tij, kjo nuk është vetëm çështje e votimit nga shtetet anëtare

Kosovën ende e presin sfida sa i përket anëtarësimit në Këshill të Evropës (KE). Të drejtat e njeriut respektohen por jo në standardin e vendeve evropiane, të cilat janë anëtare të KE-së. Kështu vlerësojnë në Institutin e Avokatit të Popullit dhe Këshillin për Mbro-

jtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut. Avokati i Popullit, Hilmi Jashari thotë se anëtarësimi i Kosovës në Këshill të Evropës është një sfidë në vete. “Ne segmentin e të drejtave të njeriut kemi ende sfidë. Sa i përket Këshillit të Evropës, Kosova ende nuk është pjesë e këtij mekanizmi, nuk është pjesë gjithashtu edhe e sistemit të drejtësisë i cili realisht përfshin Gjykatat e Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mirëpo kjo rrjedhë si pasojë e ratifikimit në rend të parë të konventës dhe të genit anëtarë i Këshillit të Evropës dhe për ne ka qenë hendikep definitivisht, sepse qytetarët e vendi të Kosovës përjashtim prej vendeve të tjera të Ballkanit, kanë qenë në vijën e zezë gjatë gjithë kohës së këtij procesi, sepse nuk ka pas mundësi për

me ju qas Gjykatës Evropiane sepse ndoshta është organi më i sofistikuar në marrëdhëniet ndërkombëtare sa i përket të drejtave të njeriut dhe ajo afekton definitivisht të drejtat”, ka thënë ai. Jashari ka thënë se duhet përkrahje e Kuvendit dhe përfaqësuesve të popullit në mënyrë që të zbatohen rekomandimet që kërkohen për anëtarësim në KE. “Ne si institucion i Avokatit të Popullit e kemi këtë mandat mirëpo neve gjithashtu na duhet përkrahje më e madhe edhe Kuvendit, përfaqësuesve të popullit. Në vitin e kaluar i kemi kërkuar kryeministrit të vendit me nxjerrë një vendim me krijë një grup ndërmënysh dhe ajo ka ndodh fatmirësisht dhe po shpresojmë me Qeverinë e re takimet e para me i realizu që të ketë një moni-

torim të vazhdueshëm sa i përket zbatimit të rekomandimeve sepse jemi institucioni kyç, institucioni kushtetues që merremi me këtë punë”, ka thënë Jashari. Ndërsa Kryetari i KMDLNJ-së, Behxhet Shala, ka thënë se Kosova si një vend në tranzicion që përballet me shumë probleme si ekonomike e sociale nuk mund t’i zbatojë të drejtat e njeriut sipas standardeve evropiane. “Realisht Kosova si një vend në tranzicion me një ekonomi të dobët, me situatë të sigurisë të ndjeshme, me një politikë të paqëndrueshme e ka shumë problem t’i zbatojë të drejtat e njeriut sipas standardeve të kërkuara nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës, mirëpo për Kosovën vlejnjë ato standarde minimale të respektimit të drejtave të njeriut dhe Kosova i plotë-

son ato standarde por për një shtet i cili nuk mund të sigurojë qetësi për qytetarët e vet, një vend pune, shëndetësi cilësor, arsim cilësor dhe shërbime të tjera, atëherë është problem që të mburret me respektimin e të drejtave të njeriut”, ka thënë ai. Shala thotë se Kosova ka një legjislacion të mirë për të drejtat e njeriut, por sipas tij është një rrugë e gjatë për anëtarësim. Ai thotë se Bashkimi Evropian është ai që po shkel të drejtat e qytetarëve të vendit duke i cenuar të drejtën e lëvizjes qytetarëve të Kosovës. “Kosova nuk ka mundësi t’i përbush ato standarde të cilat po i kërkon BE pasi është vet ajo që e shkel një të drejtë të madhe ndaj qytetarëve të Kosovës, të drejtën e lirisë së hyrjes”, u shpreh ai. “Kosova nuk dallon shumë nga vendet

e rajonit, në qoftë se merret parasysh parametrat apo standardet për të drejtat e njeriut, Kosova nuk qëndron me keq se Serbia, Mali i Zi, Maqedonia, Shqipëria.

Mirëpo këto nuk mjaftojnë që të jemi korrekt apo të jemi të barabartë me shtetet e BE-së të cilat kanë një traditë shumë më të gjatë, kanë një legjislacion të fuqishëm i cili zbatohet, kanë prosperitet ekonomik që Kosova nuk mund ta arrijë ndoshta për 500 vjet”, shtoi Shala. Edhe ambasadori i Britanisë së Madhe në Kosovë, Ruairi O’Connell ka thënë se procesi i anëtarësimit në Këshill të Evropës kërkon shumë reforma, sidomos në fushën e ligjit dhe të drejtave të njeriut. Sipas tij, kjo nuk është vetëm çështje e votimit nga shtetet anëtare.



Përkundër vullnetit të Madridit qeveria rajonale e Katalonjës e mbajti një referendum për pavarësinë. Por nuk është vetëm Katalonja, në Evropë ka edhe rajone të tjera që dëshirojnë pavarësimin nga qeveritë qendrore

Jo vetëm Katalonja, kërkesat për pavarësi në Evropë janë të mëdha

Në gjysmën lindore të Evropës shpërbërja e Bashkimit Sovjetik dhe e ish-Jugosllavisë kanë bërë që të krijohen shumë shtete të reja. Në Evropën Perëndimore në të kundërt duket se shtetet e vjetra nacionale janë të konsoliduar prej kohësh. Por në këto themele gëlon dëshira për pavarësi e rajoneve në një sërë vendesh evropiane, madje në disa prej tyre ka edhe përpjekje militante. Shanset për realizimin e një kërkesë të tillë janë të ndryshme në vende të ndryshme.

KATALONJA. Askund tjetër në Evropë nuk është kaq e fortë tendenca për pavarësinë sa në Katalonjë. Ndërsa në kohën e diktaturës së Frankos shtypje ndjenja katalonjase, rajoni tashmë ka arritur një masë të gjerë autonomie politike dhe kulturore - ndër të tjera edhe duke pasur parlamentin e vet rajonal. Por kjo nuk u mjafton shumicës së 7.5 milionë katalonjasve. Ata duan një shtet më vete, kryesisht për arsye ekonomike. Ata thonë, se Katalonja është rajoni më i pasur prej nga thith shteti spanjoll në tërësi. Rreth 20 për qind e produktit bruto spanjoll në vend realizohet në rajonin lindor përreth Barcelonës. Më 1 tetor qeveria rajonale ka shpallur referendumin për pavarësinë. Qeveria konservatore në Madrid e Mariano Rajoyt e refuzon referendumin dhe e konsideron atë antikushtetues e po përpjekt juridikisht e madje edhe me forcën e policisë që ta bllokojë atë duke sekuestruar fletët e votimit.

RAJONI I BASKËVE. Shumë katalonjas orientohen nga rajoni i baskëve. Në të gjithë Spanjën qeveria qendrore në Madrid mbledh taksat dhe i shpërndan ato në rajone të veçanta - por jo në rajonin e baskëve dhe në provincën që i përket atij Navarra me kryeqytet Pamplonan. Rajoni i baskëve i administron në mënyrë të mëvetësishme taksat dhe i paguan një shumë minimale Madridit. Rajoni i baskëve është ekonomikisht më i dobët se Katalonja. Ndonëse edhe nacionalizmi bask dhe gjuha baskë janë shtypur nën diktaturën e Frankos, një pakicë e vogël e nacionalistëve të sotëm baskë është militante. Organizata baskë në ilegalitet, ETA, në rreth 50 vjet ka vrarë mbi 800 vetë, për të arritur qëllimin e vet shkëputjen nga Madridi.



Më 2011 ETA hoqi dorë nga dhuna. Por as sulmet dhe as bisedimet politike nuk e kanë mundësuar një referendum, pa folur më për pavarësinë. Një referendum në nëntor 2014 u kthye në një votë simbolike. Vetëm qeveria qendrore në spanjolle mund të mbajë një referendum të tillë, sipas Kushtetutës spanjolle, por qeveria në Madrid e refuzon atë po ashtu si edhe referendumin në Katalonjë.

SKOCIA. Qysh prej 300 vjetësh ekziston unioni mes Skocisë dhe pjesës tjetër të Mbretërisë së Bashkuar. Por skocezët ka kohë që kërkojnë një autonomi më të zgjeruar. Një parlament më vete ata e kanë. Por partia nacionale skoceze kërkon mëvetësinë. Më 2014 Londra lejoi referendumin për pavarësinë. Ndonëse shumica e skocezëve votuan kundër ndarjes, më 2016 fryma e pavarësisë u ringjall për shkak të referendumit ndaj BE-së në Britaninë e Madhe dhe procesin e daljes së saj nga BE-ja. Pas vendimit të britanikëve për daljen nga BE-ja kryeministrja e Skocisë Nicola Sturgeon u orientua nga nacionalistët: përderisa zgjedhësit në Skoci kanë votuar me shumicë për



mbetjen e Britanisë së Madhe në BE, është e papranueshme, që Skocia automatikisht të dalë bashkë me Britaninë e Madhe nga BE-ja. Kur të bëhen të njohura më shumë detaje për BREXIT, në vjeshtën e vitit 2018 ajo do të mbajë një referendum për pavarësinë ngjashëm si në vitin 2014.

FLANDRA. Në zgjedhjet e fundit parlamentare në Belgjikë më 2014 Aleanca e re flamande nën Unter Bart De Wever doli forca më e madhe politike në Flandër. De Wever është i bindur, që shteti i tërë belg gjithsesi do të "shpërbëhet" dhe se Flandra pa Valoninë do të jetë më mirë ekonomikisht. Një Flandër të pavarur ai synon ta arrijë përmes bisedimeve. Separatizmi flamand është një rast i veçantë: Belgjika

gjithsesi përbëhet nga flamandët që flasin holandisht dhe valonët që flasin frëngjisht duke përfshirë këtu edhe komunitetin gjermanofon dhe Brukselin që ka dy gjuhë zyrtare. Nëse Flandra shkëputet, Belgjika do të humbiste më shumë se gjysmën e popullsisë si dhe forcën ekonomike. Nga Belgjika do të mbejten shumë pak. Pika më e nxehtë e debatit është në këtë rast statusi i Brukselit, që është edhe selia e BE-së dhe e NATO-s. Se çfarë do të ndodhte me Valoninë, është edhe kjo e paqartë. Madje ideja e atashimit Francës, Luksemburgut apo madje Gjermanisë ka qarkulluar përkohësisht. Sidoqoftë debati tashmë është i tejkaluar e deri më sot belgët kanë afruar dhe më shumë ndër vete.

"PADANIA". Lëvizja separatiste në Veri të Italisë është e motivuar thjeshtë nga ekonomia. Veriu me rajonet e Lombardisë, Aostës, Piemontit, Ligurias, Venetos dhe Emilia-Romagnas realizojnë me ndër-marrjet e tyre industriale dhe bankat pjesën më të madhe të produktit social italian. Shumë italiano-veriorë besojnë, se Italia e Mesme dhe ajo e Jugut konsumojnë paranë e fituar me mund në Veri të vendit.

Partia Lega Nord në vitet 1990 donte shkëputjen e plotë të veriut "Padanias", që rrjedh prej emërimit italian "pianura padana" për luginën e Posë. Sot Lega Nord është bërë më e moderuar. Tani ajo synon vetëm, që veriu ta mbajë për vete pjesën më të madhe të parave të xhiruara dhe t'i administrojë vet ato, në vend që ato t'i kalojnë Romës.

TIROLI I JUGUT. Në Tirolin e Jugut bashkohen faktorë ekonomikë, historikë dhe kulturorë. Tiroli i Jugut deri në fund të Luftës së Parë Botërore i përkiste Perandorisë Austro-Hungareze, më pas ai u caktua Italisë. Pas fazës së italianizimit në kohën e Musolinit Tiroli i Jugut pas Luftës së Dytë Botërore fitoi më shumë autonomi politike dhe gjuhësore. Madje në pjesën më të madhe të ardhurat shtetërore ky rajon lejohet t'i mbajë vet. Tirolezët jugorë dukeshin për një kohë të gjatë të kënaqur. Por kriza e borxheve shtetërore i rindezi përkohësisht ndjenjat e separatizmit. Italia është pas Greqisë vendi me më shumë borxhe në Eurozonë, e ekonomia nuk po rimëkëmbet. Shumë tirolezo-jugorë, të cilët janë mirë ekonomikisht, nuk duan të kenë të bëjnë me problemet e Italisë dhe prandaj kërkojnë "shkëputjen nga Roma".

KORSIKA. Shteti francez prej kohësh është përpjekur, që ta spostojë nga jeta publike dhe në shkolla gjuhën krosikane në ishull. Përpjekjet për autonomi janë luftuar. Grupet militante, kryesisht ai FLNC, për shumë vite janë përpjekur të shkëputen me dhunë nga Franca, duke kryer sulme kundër përfaqësuesve apo simboleve të shtetit të Francës apo edhe shtëpive të pushimit në kontinent. Më 2014, FLNC deklaroi se do të heqë dorë nga lufta në ilegalitet. Por potenciali i konfliktit mbetet: propozimet e rezervuara për autonomi të qeverisë socialiste franceze nën Lionel Jospin në vitin 2000 e nxorrën opozitën konservatore në barrikada. Ajo besonte, se edhe rajone të tjera si Brentanja apo Alzasa mund të kërkonin pavarësinë. Tradicionalisht në Paris merren fare pak parasysh gjuhët rajonale, sepse tek to shihet të rrezikohet uniteti i vendit.

BAVARIA. Fare pak bavarezë mendojnë seriozisht për krijimin e një shteti më vete. Por sidoqoftë Bavaria gëzon zyrtarisht qysh sot termin "shteti i lirë". E me këtë Bavaria ka mundur të mbijetojë mirë. Ky është landi me sipërfaqen më të madhe ndër landet federale të Gjermanisë, me 13 milionë banorë ky rajon ka më shumë banorë se Suedia apo Portugalia dhe po ashtu ka rendimentin më të lartë ekonomik ndër landet federale. Nëse ekziston dëshira për më shumë mëvetësi të bavarezëve, atëherë kjo rrjedh kryesisht prej kështimit financiar mes landeve, sistemit ky përmes të cilit harmonizohen pjesërisht dallimet në mirëqenie mes landeve të pasura dhe të varfëra. Bavaria do të preferonte të paguante më pak në arkën e përbashkët. Por edhe këtu ka separatistë të mirëfilltë. Politikani kristiansocial Wilfried Scharnagel në librin e botuar më 2012 bën thirrje, se "Bavaria mund t'ia dalë edhe vetëm" duke kërkuar kështu shkëputjen nga njëësia e shtetit gjerman. Por deri më tani nuk është krijuar ndonjë lëvizje më e madhe se kaq. (DW)



Matja e forcave mes qeveris qendrore të Spanjës dhe nacionalistëve katalonjas po vazhdon. Guardia Civil (garda civile) hyri në qendrën e IT-së të qeveris rajonale dhe sekuestroi sistemin e numërimit të votave. Policia qëndronte përballë përkrahësve të referendumit që demonstrojnë në për pavarësinë e Katalonjës. Autoritetet spanjolle po përpiqen me intensitet për ta ndaluar referendumin për pavarësinë e Katalonjës



Mendohet se pa aktivitetin e Vizentalit në ndjekje të kriminelëve, pavarësisht nga koha dhe nga vendi, nuk do të kishte as gjyqe për kriminelët e luftës për ish-Jugosllavinë, as për Ruandën. Krijimi i gjyqit të përhershëm ndërkombëtar për kriminelët e luftës në Hagë në vitin 2002, është i lidhur drejtpërdrejt me punën e Vizentalit, që ai e filloi që në vitin 1946. Ai gjyq do të bëjë që, edhe pse nuk do të çohen dot para drejtësisë të gjithë kriminelët, frika e dënimit do t'u rrijë e varur mbi kokë, ajo frikë do të jetë njëfarë ndëshkimi për ta dhe në njëfarë mënyre do të shkurajojë krime të tjera para se të ndodhin

Simon Vizentali nuk e harroi asnjëherë kohën e kaluar në kampet naziste. Gjithë përvojën e tij të tmerrit, ai u përpoq ta shndërronte në një motiv të rëndësishëm kundër dhunës, duke punuar për të vendosur përpara drejtësisë kriminelët. Asnjëherë nuk u ndal. Dhe kur në moshën shtatëdhjetëvjeçare gruaja iu lut që t'i linte punët, të cilave u qe përkushtuar deri atëherë dhe të fillonte një jetë normale si gjithë të tjerët për vitet që i kishin mbetur. Por, për të, ai "normalitet" konsiderohej tradhti. Ai ishte i vendosur që të ecte përpara drejt asaj që kishte nisur: drejt gjetjes dhe dhënien drejtësisë së kriminelëve nazistë, bërjes së qartë të brezave të rinj se ato që harroheshin, përsëriteshin. "Që nga çlirimi nuk ka pasur asnjë ditë që të kem harruar se kam qenë një i mbijetuar. Unë i shpëtova Holokaustit dhe jam munduar të ruaj kujtesën e të vdekurve... E shoh atë që po bëj si një parajlmërim për vrasësit e nesërm, si një parajlmërim që ata të mos gjejnë paqe", shprehej ai. Vizentali u mor me këtë punë për rreth gjashtëdhjetë vjet, që nga koha kur shpëtoi nga kampet naziste e derisa vdiq. Idealizmi i tij që i plotë, ndjenja e detyrës e kthyer në mision, po ashtu. Emrat "Simon Vizental" dhe "Gjahtari i nazistëve" kanë hyrë në historinë e pas-Holokaustit si sinonime. Megjithatë, Simon Vizentali është shumë më shumë se gjahtar i nazistëve: ai është njëkohësisht luftëtar për drejtësi; luftëtar i mbajtjes gjallë të kujtesës së gjenocidit nazist, me qëllim jo vetëm për të ditur se ç'ndodhi, por edhe për të bërë që ajo që ndodhi të mos përsëritet më; si dhe autor librash. Në një kohë kur njerëzit kërkonin ta harronin Holokaustin, ai i bëri ata ta kujtonin. Ai ndërroi viktimat, u dha të mbijetuarve qetësi dhe shpresë, duke çuar para drejtësisë kriminelë nazistë të fshehur e të shpërn-

Njeriu që krijoi gjyqin e përhershëm për kriminelët në Hagë



darë nëpër botë dhe bëri të jetonin çdo minutë me frikën e zbulimit, kapjes dhe dënimit ata që mbetën të fshehur. Luftën kundër harresës dhe indiferencës Vizentali e konsideronte si një veprim me rëndësi të jashtëzakonshme. Në raste të ndryshme ai ka thënë: "Puna më e madhe që kam bërë ka qenë lufta kundër harresës, lufta për mbajtjen gjallë të kujtesës. Është shumë e rëndësishme ta bëjmë popullin të ndiejë se armiqët e tij nuk janë harruar. Ky është një parajlmërim për vrasësit e nesërm. Në qoftë se nuk do të parajlmërojmë vrasësit e nesërm me veprime, miliona të tjerë do të vdesin prej tyre... Drejtësia për krime kundër njerëzimit nuk duhet të ketë kufizime kohore... Me siguri, monstra si Hitleri dhe Stalini lindin përditë... ata presin që ne të harrojmë. Kur historia të shohë pas, dua që populli të marrë vesh se nazistët nuk i shpëtuan ndëshkimit, edhe pse mundën të vrisnin miliona. Ky është një mesazh

edhe për vrasësit e nesërmes: ata nuk do të gjejnë paqe... Në qoftë se injorojmë të shkuarën, në qoftë se deformojmë apo mohojmë atë që ndodhi, e shkuara do të përsëritet. Vetëm duke kujtuar do të mundemi ne dhe fëmijët tanë, dhe fëmijët e fëmijëve tanë, të ndërtojmë një të ardhme të sigurt, një të ardhme në të cilën jeta e njeriut të mos humbë vlerat e veta... E bëj këtë punë, sepse duhet ta bëj. Nuk shtyhem nga ndjenja e hakmarrjes... por nga ajo e kujtesës dhe drejtësisë. Në qoftë se harrojmë të gjithë, mund të ndodhë e njëjta gjë pas njëzet, pesëdhjetë apo njëqind vjetësh..." Për Vizentalin, të kujtuarit e viktimave dhe e mizorive të luftës do të ndihmonte edhe në rindërtimin e jetës së atyre që shpëtuan. Mijëra të mbijetuar kudo në botë do të qetësoheshin disi kur të mësonin se kriminelët do të qëndronin këtej e tutje ose para drejtësisë, ose nën frikën e përhershme të saj. "Mbijetesa është një privilegj i cili përmban edhe

detyrime, - thotë Vizentali. - Gjithnjë pyesja veten se çfarë mund të bënim për ata që nuk mbijetuan. Për vete, e kam gjetur përgjigjen... Do të bëhem folësi i tyre, do të mbaj gjallë kujtesën e tyre, do të siguroj që të vdekurit të jetojnë në atë kujtesë. Por ne, të mbijetuarit, kemi një detyrim jo vetëm ndaj të vdekurve, por edhe ndaj gjeneratave të ardhshme: ne duhet t'u kalojmë atyre përvojat tona, në mënyrë që ato të mësojnë prej tyre. Ne kemi për detyrë të bëjmë që brezat e rinj të kuptojnë se sa e veçantë, se sa e pabesueshme, se sa e pazakontë ka qenë periudha e Holokaustit, ndonëse mund të jetë shumë e vështirë për ta t'i pranojnë tregimet tona si të vërteta. E pakapshme mbetet e pakapshme... Ne duhet t'u kalojmë gjeneratave të ardhshme përvojën tonë, në mënyrë që ata të përfitojnë prej saj. Informacioni është mbrojtje. "Nuk mjafton që gjithçka të regjistrohet në libra. Një libri, ndryshe ndaj një personi, nuk

mund t'i bëhen pyetje. Një dëshmitar është një dëshmitar i gjallë. Prandaj, në takime me të mbijetuar, kam thënë gjithnjë: 'Ju keni fëmijë, ju keni nipër e mbesa, ju duhet të flisni me ta. Ju duhet t'u thoni atyre gjithçka keni provuar dhe t'i nxisni ata t'ju bëjnë pyetje'. Tregimet gojore ndihmojnë shumë që kujtesa të mbahet gjallë. Luftëtarët e rezistencës nuk duhet të kënaqen me përkujtime të rezistencës së asaj kohe, ata duhet të tregojnë rezistencë edhe sot. Ka edhe sot diktatura çnjerëzore që dhunojnë njerëz. "Duhet t'i themi popullit se si gjenerata jonë e nënvlerësoi Hitlerin dhe nacionalsocializmin dhe se si besimi ynë në progres, në kulturë, në drejtësi dhe në miqësi u zhvlerësua shumë shpejt. Gjenerata jonë qe shumë e pakujdeshme në fillim, ne ndiqnim në heshtje daljen e partive naziste në vende të cilat Hitleri i kishte planifikuar t'i godiste, në vende ku shumica ndërsehej ndaj pakicave dhe populli hutohej dhe nuk shihte rrezikun kryesor". Filozofia e Vizentalit është e bazuar në traditën judaiste e cila pranon, vlerëson dhe ka parasysh lidhjen e fortë midis së shkuarës, së tashmes dhe së ardhshmes, si pas së cilës tek e tashmja ka elementë të së shkuarës dhe tek e ardhmja do të ketë elementë të së tashmes; se, as e tashmja dhe as e ardhmja nuk janë të sigurta, pa pasur parasysh të shkuarën. Botëkuptimi judaist e konsideron të shkuarën si shumë të rëndësishme dhe e ruan atë me fanatizëm. Hebrejtë nuk janë nga ata që thonë: "Të shohim përpara, se po pamë mbrapa, ose mbetemi në vend, ose shkojmë mbrapa". Jo, ata thonë: "Të ecim përpara, duke shikuar mbrapa, sepse ashtu shkojmë të sigurt përpara". Kjo është ecja e kujdeshme, tjetra, ajo që sheh vetëm përpara, pa parë as anash, pa le më mbrapa, është ecje kuturu. Hebrejtë kanë mbi dy mijë vjet që njohin një histori të tyre të kanonizuar mbi të cilën nuk guxon njeri të vërë dorë, ta rishikojë apo ta ndryshojë. Ata festojnë të njëjtat festa, festojnë të njëjtat persona e heronj; ata përkujtojnë paraardhësit e tyre, prindërit e tyre, më me kujdes nga ç'festojnë të tjerët të porsalindurit, apo ditëlindjet. Ndryshe nga shumë popuj të tjerë, për të mos folur

për popuj pa baza, për popuj majmunë, hebrejtë sot kanë të njëjtat emra që kanë pasur edhe dy mijë vjet më parë, kanë të njëjtën gjuhë, kanë të njëjtat shkronja, kanë të njëjtën fe, kanë të njëjtat zakone. Kjo i ka bërë ata të kenë identitet plotësisht të përcaktuar, të kenë lidhshmëri në qenien e tyre, lidhshmëri midis brezave. Kjo i ka bërë ata të dallueshëm prej të tjerëve. Historia e tyre, për nga kohëzgjatja, është e krahasueshme vetëm me atë të indianëve. Shumë kultura që kanë lulëzuar në kohë të shkuara, sot nuk kanë trashëgimtarë. Judaizmi, sikurse hinduizmi indian, jeton dhe jeton në të njëjtin popull, paçka se shumë prej e atij populli është pa atdhe.

Parim kryesor i judaizmit është drejtësia, ndryshe nga ai i krishterimit që është mëshira. Ligjet e drejtësisë së judaizmit janë të përcaktuara me përpikëri dhe konsiderohen të shenjta. Bazat e tyre janë dhënë mbi dy mijë vjet më parë në librin e tyre të shenjtë "Tora", libër që mund të konsiderohet si Kushtetuta e tyre. Ato baza janë zgjeruar më tej nga dijetarët e tyre për të përfshirë çdo fushë të jetës, duke marrë formën e kodeve civile a penale që nuk mund të lëvizin, apo të ndryshohen prej askujt. I nisur nga dy parimet apo karakteristikat e judaizmit: nga kujtesa dhe nga drejtësia, ndofta edhe pa vetëdije, Vizentali hebre, por jo fetar, punoi dhe kërkoi që Holokausti të mos harrohej dhe mbi kriminelët që e kryen atë të veprohej dhe të veprohej me drejtësi. "Kujtimi i së keqes bëhet mburojë ndaj vetë së keqes", thotë Eli Vazel (Elie wiesel). Drejtësia judaiste i kërkonte fajtorit më shumë se pranimin e fajit, apo kërkesën e ndjesës, ajo i kërkonte atij ndëshkim në përputhje me shkallën e fajit apo të kriminit, në përputhje me shkallën e dëmit që ka bërë. Për Vizentalin, drejtësia e kriminelëve nazistë do të realizohej përmes gjykatave. Ai thoshte: "Kuptimi i jetës sime do të realizohet atëherë, kur vrasësit e nesërm, ata që ndofta nuk kanë lindur ende, të kuptojnë se nuk do të gjejnë qetësi. Ky parajlmërim është me shumë rëndësi për gjeneratat e ardhshme". Ai përsëriste se asnjë vrasës nazist, sado i moshuar që të ishte, nuk duhej lejuar që të vdiste në paqe, nuk duhej lejuar që të vdiste pa u gjykuar dhe pa dhënë llogari, nuk duhej të vdiste duke marrë me vete sekretet e krimeve të tij, nuk duhej të vdiste pa marrë vesh të tjerët se ç'mizori kishte kryer. Edhe pse ndëshkimi nuk do të mundte kurrë të shlyente veprat monstruoze të nazistëve, dalja e së vërtetës, ndërgjegjësimi i botës për ato që ishin kryer, do të vlente si një masë mbrojtëse që ato të mos përsëriteshin më. Edhe pse kërkonte ndëshkim për kriminelët nazistë, dënimin kapital nuk e ka pranuar. Vizentali nuk pati ndonjë shkolle, specializim a përvojë për






punën që do të kryente. Puna që nisi, e specializoi. Ai nuk punoi për ndonjë forcë policore, për ndonjë qeveri apo agjenci private. Ai punoi në një zyrë të varfër dhe me kontribute vullnetare mbante veten dhe punën. Ndhmësit e tij punonin gati falas, por besonin në punën që kryenin. Kur njerëz të ndryshëm shkonin në zyrën e tij për të treguar historitë e tyre, vinin re se ai i dëgjonte me shumë emocione. Ai qante bashkë me ta, ai nuk i përpunonte historitë e tyre, ai i jetonte ato. Ai mund të rrinte kohë të gjatë me një person që tregonte ngjarje nga jeta e tij edhe kur ato ngjarje nuk paraqitnin ndonjë rëndësi të përgjithshme, apo rëndësi për hetim. Ai krijoi një arkiv të dëshmitë të ish-të burgosurve të kampeve të përqendrimit. Informacioni i mbledhur dhe i sistemuar aty do të vihej në dispozicion të gjyqeve që do të zhvilloheshin më pas ndaj kriminelëve nazistë. Përveç dëshmitë që mundi të grumbullonte nga shumë persona, ai pati dhe përvojën e tij të kampeve, ku kaloi gati të gjithë periudhën e luftës. Ndonëse në kampet naziste iu shuan afro 90 pjesëtarë të familjes së tij dhe të gruas, ai nuk foli kurrë për hakmarrje personale dhe nuk u mor kurrë me të. Çdo fakt e çdo dëshmi që mblidhte, ai ia kalonte gjyqeve. Vizentali mbajti lidhje me shumë luftëtarë të rezistencës të cilët i sillnin informacion për ata që kërkoheshin. Kur ata i kërkonin që, po t'i lejonte, të mund t'i vrisnin drejtpërsëdrejti nazistët e gjetur, Vizentali nuk pranonte.

Ai u thoshte se drejtësia ishte më e rëndësishme se hakmarrja: "Ne duhet të tregojmë se nuk jemi si nazistët. Ligji dhe drejtësia duhet të jenë baza e ndëshkimit dhe jo hakmarrja". Vizentali ndoqi dhe paditi jo vetëm ata kriminelë që kishin kryer krime ndaj hebrenjve, por edhe ata që kishin kryer krime ndaj tjerëve. Në vitin 1993, pas një pune të gjatë të ndjekjes së kriminelëve nazistë, Vizentali i tha botës: "Për të mirën tuaj, mësoni nga tragjedia jonë. Nuk ka ndonjë ligj të shkruar se viktimat e ardhshme do të jenë përsëri hebrenj. Mund të jenë edhe të tjerë. Ne pamë se tragjedia filloi në Gjermani me hebrenjtë, por nuk shpëtuan edhe popuj nga afro njëzet kombe. Kur e fillova këtë punë, thashë: 'Do të kërkoj vrasësit e të gjitha viktimitë, jo vetëm të hebrenjve. Do të luftoj për drejtësi pa pushim, detyrimi moral nuk ka cak'". Vizentali kërkonte që çdo gjë që kishte ndodhur në të shkuarën të shpallej, pa marrë parasysh se disave mund të mos u pëlqente. Për të, nuk duhej mbajtur asnjë e fshehtë, në qoftë se do të kërkohej që të këqijat të mos përsëriteshin. "Nuk ka zgjidhje tjetër, përveçse t'i hidhemi së shkuarës dhe të mësojmë prej saj. Nuk ka kuptim të zvogëlojmë fajin, në mënyrë që të jetë më e lehtë për bijtë dhe bijat e kriminelëve që të pranojnë punët e ndyra të nënave, baballarëve, gjyshërve, gjysheve të tyre..." "Historia e njerëzimit, - thotë Vizentali, - është historia e krimeve të përsëritura. Kështu, informacioni merr rëndësinë e mbrojtjes. Me anë të tij ne mund të ndërtojmë dhe duhet të ndërtojmë sigurinë ndaj përsëritjes". Dhe, më pas, shton: "Shkolla mund të dështojë përmes heshtjes së saj, kisha përmes mëshirës së saj dhe shtëpia përmes mohimit dhe heshtjes së prindërve. Gjenerata e re duhet të dëgjojë dhe të dijë atë që gjenerata e vjetër refuzon ta tregojë". Për Vizentalin e keqja nuk ishte mundur përfundimisht. Ai paralajmëronte: "Urrejtja mund të ushqehet kudo, idealizmi mund të kalojë në sadizëm kudo... Kombinimi i urrejtjes me teknologjinë është rreziku më i madh që kërcënon njerëzimin... Dhuna është si bari i keq që nuk thahet edhe në thatësinë më të madhe". Vjetari biografik i vitit 1975 e karakterizonte Vizentalin në këtë mënyrë: "Me mprehtësi inxhinieri, me seriozitet talmudist, me talent të jashtëzakonshëm për mendim investigativ, ai bashkon pjesë të errëta, të mangëta e, në dukje, të parëndësishme e pa lidhje, dhe me to ndërton padi të forta për t'u bërë ballë kërkesave të gjyqeve. Dosjet e përpiluara në këtë mënyrë, u paraqitshin autoriteteve përkatëse. Kur, ashtu siç ndodhte shpesh, gjyqet nuk vepronin, qoftë nga indiferenca, qoftë nga ndjenjat ende naziste, apo për arsye të tjera, ai i drejtohej opinionit publik përmes gazetave dhe mjeteve të tjera të komunikimit. Ai e dinte se publiciteti dhe opinionit publik ishin armë të fuqishme".

Pas Gjyqit të Nurembergut nga fundi i viteve 1940, Vizentali mbeti zëri i vetëm dhe këmbëngulës për gjykimin e të gjithë atyre që kishin kryer krime, sidomos kur fuqitë botërore filluan të mendonin më shumë për Luftën e Ftohtë, sesa për përfundimin e punës me nazistët. Ato fuqi në këtë kohë, u munduan të shfrytëzonin më shumë e më mirë specialistët nazistë për qëllimet e tyre. Mendohet se pa aktivitetin e Vizentalit në ndjekje të kriminelëve, pavarësisht nga koha dhe nga vendi, nuk do të kishte as gjyq për kriminelët e luftës për ish-Jugosllavinë, as për Ruandën. Krijimi i gjyqit të përhershëm ndërkombëtar për kriminelët e luftës në Hagë në vitin 2002, është i lidhur drejtpërdrejt me punën e Vizentalit, që ai e filloi që në vitin 1946. Ai gjyq do të bëjë që, edhe pse nuk do të çohen dot para drejtësisë të gjithë kriminelët, frika e dënimit do t'u rrijë e varur mbi kokë, ajo frikë do të jetë njëfarë ndëshkimi për ta dhe në njëfarë mënyre do të shkurajojë krime të tjera para se të ndodhin. Vizentali demonstroi se si një person i vetëm mund të ndikojë në ndryshimin e gjërave të rëndësishme për botën. (bota.al)

Zotëria që shpëtoi botën

Ishte rastësi që ai ishte përgjegjës; ndoshta një person tjetër do të ndiqte protokollin në letër, ndoshta bota nuk do të ekzistonte më. Jeta e tij është ajo çerek ore, por ajo çerek ore e shpëtoi botën: janë të pakta jetët - kaq të plota, kaq boshe - që kanë vendosur aq shumë



Martín CAPARRÓS, El País

Thonë se bota kurrë nuk ka qenë aq pranë shkatërrimit, sa atë ditë. Ishte 26 shtatori i vitit 1983 dhe presidenti Ronald Reagan ishte duke bërë një thirrje në Kombet e Bashkuara kundër komunistëve, Franca vazhdonte të vendoste veton për hyrjen e Spanjës në Evropë, diktatorët argjentinas i jepnin amnisti vetes së tyre amnistinë dhe Simon & Garfunkel po ndaheshin një herë e përgjithmonë. Atë ditë, në Spanjë, një qendër tregtare ishte duke u inauguruar në La Vaguada dhe kishte shumë frikë për sulme terroriste; ligji i ri mbi arsimin i kërkuar nga socialistët, i cili zvogëlonte peshën e fesë në shkollë, ishte në qendër të sulmeve të peshkopëve dhe politikanëve të Partisë Popullore.

KUR NË DUAR KE FATIN E BOTËS

Atë ditë, Stanislav Petrov ishte 44 vjeç dhe ishte nënkolonel i Ushtrisë Sovjetike, përgjegjës për qendrën e zbulimit të sulmeve bërthamore, të Bashkimit Sovjetik. Nga ai bunker, ai drejtonte rrjetin e madh të radarëve, satelitëve, teknikëve dhe analistëve që përpiqeshin të mbronin territorin e tyre nga raketat bërthamore amerikane. Në mesnatë, në qendër, u ndez alarmi: kompjuterët kishin zbuluar një raketë në fluturim mbi Rusi, me 24,000 milje në orë. Petrov kërkoi konfirmim; kompjuterët këmbëngulën, por satelitët nuk po e shihnin raketën. Petrov besonte (në raste të tjera) se makinat dhe algoritmet mund të gaboheshin. Ai vendosi të priste: në pesë minutat e ardhshme, ranë katër alarme të tjera. Një nga ato raketa kishte fuqi shpërthyesë dy herë më të lartë, se të gjitha bombat e Luftës së Dytë Botërore. Duhet të jetë kaq e çuditshme të mendosh se ke në duar, fatin e botës. Nëse Petrov do të kishte ndjekur protokollin dhe do të kishte paralajmëruar epurorët, në pak minuta qindra raketa ruse do të ishin lëshuar në drejtim të territorit të SHBA. Në një orë, lufta bërthamore do të vriste dhjetëra miliona njerëz. Petrov priti. Kompjuterët i ratifikonin të dhënat, por nuk kishte konfirmim vizual. Duhet të jetë kaq e çuditshme të mendosh që, nëse merr vendimin e gabuar, ai që paguan është i gjithë njerëzimi. Stanislav Petrov kishte lindur në Vladivostok në vitin 1939; atij nuk i pëlqente të



ishte ushtar, por për të kishte qenë gjithmonë një punë e lehtë. Përveç se në ato momente: nuk kishte vend për dyshime. Ai vendosi se alarmi duhej të ishte një gabim: nuk ishte e arsyeshme që amerikanët të lëshonin vetëm pesë raketa dhe jo me qindra, siç parashikonin të gjithë. Pak minuta më pas, radari konfirmoi se asnjë sulm nuk ishte duke ndodhur. Petrov sapo kishte shpëtuar botën. Bota nuk e dinte dhe vazhdoi përpara, sikur të mos kish ndodhur asgjë. Ushtria ruse e ruajti sekretin: sistemi i tyre i mbrojtjes kishte treguar një defekt shumë të madh për t'u folur ha-

shndërrua në një plak duhanpirës, nevrrik, i mërzitshëm, i mbyllur në një apartament të vogël në periferi të Moskës, i ngopur me faktin që të gjithë donin të flisnin me të, vetëm për ato pesëmbëdhjetë minuta.

Ai gjithashtu nuk dukej se kishte shumë më tepër për të treguar, se atë çerek ore, kur zgjedhja e tij e lumtur ishte të mos bënte asgjë; kur ai vendosi që mosveprimi ishte veprimi më i mirë i mundshëm.

Ishte rastësi që ai ishte përgjegjës; ndoshta një person tjetër do të ndiqte protokollin në letër, ndoshta bota nuk do të



pur, dhe kjo është arsyeja pse ne e kemi mësuar, vetëm dy dekada më vonë. Për një arsye të çuditshme, kur mësojmë këto gjëra, nuk shtyhem që të pyesim, se sa të tjera injorojmë: të pyesim pra, se çfarë mund të jetë duke ndodhur sot, e që ne do ta mësojmë një ditë në të ardhmen.

BOMBAT JANË ENDE ATY

Stanislav Petrov nuk qëndroi shumë gjatë në ushtri. Gruaja e tij vdiq dhe ai kërkoi të tërhiqej. U

ekzistonte më. Jeta e tij është ajo çerek ore, por ajo çerek ore e shpëtoi botën: janë të pakta jetët - kaq të plota, kaq boshe - që kanë vendosur aq shumë.

Bombat janë ende aty: Shtetet e Bashkuara, Rusia, Kina, Franca, Mbretëria e Bashkuar, India, Pakistani dhe Koreja e Veriut kanë mijëra bomba në gjendje për të shkatërruar gjithçka. Por për disa arsye duket se gjëja nuk na shqetëson më. E megjithatë, si gjithmonë, jemi në duart e një rasti të panjohur.





Në nëntor nis prodhimi i VOLVO XC40



Volvo ka publikuar zyrtarisht fotografitë dhe detajet teknike të modelit të tij më të ri SUV, transmeton KosovaPress. Kompania ka bërë pak modifikime në aspektin e dizajnit, të cilat janë bërë për shkaqe ekonomike dhe praktike. Elementet e stilit në pamjen e jashtme janë marrë kryesisht nga gjenerata më e re e modeleve të Volvo dhe një stil i ngjashëm është zbatuar dhe në kabinën e udhëtarëve. Volvo për udhëtarë në kabinë ka siguruar më shumë hapësirë përdorimi, si dhe për vendosjen e laptopave, tabletit ose shisheve me ujë. Sistemi multimedial lidhet lehtë me pajisjet e mençura përmes funksioneve Android Auto dhe Apple CarPlay. XC40 posedon platformën e re mekanike CMA, të cilën Volvo e ka zhvilluar bashkërisht me kompaninë amë, Geely-jem. Versioni bazë i motorit është T3 benzina me 156 kuaj fuqi, ndërsa T4 disponon me 190 kuaj fuqi, derisa në krye të ofertës për benzina gjendet T5 me 247 kuaj fuqi. Versioni dizel D3 posedon 150 kuaj fuqi, ndërsa D4 posedon 190 kuaj fuqi. Volvo XC40 do të prodhohet duke filluar nga nëntori në Gent të Belgjikës, ndërsa njësitë e para do të arrijnë deri te blerësit në fillim të vitit të ardhshëm. Çmimi fillestar për modelin T3 është 31.000 euro, derisa njësitë më të shtrenjta do të kushtojnë 40.000 euro. XC40 do të ketë konkurrencë të fuqishme në tregun evropian, përballë rivalëve BMW X1, Audi Q3 dhe Mercedes GLA.



Pagesat do bëhen me shenjat e gishtërinjve


Një supermarket në Londër është duke testuar një sistem biometrik për pagesë, i cili përdorë linjat unike të shenjave të gishtërinjve, për të bërë pagesën për mallrat dhe shërbimet. Një lexues elektronik përdorë linjat e shenjave të gishtërinjve për të gjeneruar një kod unik. Kjo teknologji është zhvilluar nga gjiganti elektronik

Hitachi, ndërsa kompania Sthaler është e licencuar për plasimin në treg. Drejtori ekzekutiv në Sthaler, Nick Dryen ka thënë që kjo teknologji më së shumti i dedikohet gjeneratës së re, duke u mundësua një mënyrë efikase dhe të sigurt të pagesave. Së shpejti kjo metodë do të fillojë të përdoret në masa më të mëdha.



BABYPOD 20, projektohen pajisjet që mbron foshnjat nga përplasjet

Pajisjet hi-tech të transportit me fibra karboni, të quajtura Babypod 20, janë projektuar me një inxhinieri të avancuar të ekipit Williams të Formula One. Teknologjia e avancuar e kujdesit shëndetësor AHT, kërkoi nga ekipi Williams që të aplikojnë ekspertizën e tyre në sportin e Formulës 1 për të krijuar një mjedis të sigurt për foshnjat e porsalindura që kanë nevojë për transport të veçantë



Teknologjia e avancuar angleze e kujdesit shëndetësor në bashkëpunim me ekipin Williams të Formula Uno-s, kanë projektuar ambulanca të posaçme për foshnjat e porsalindura. Pajisjet e quajtura BabyPod 20 të pajisura me fibra karboni janë projektuar për një transport më të sigurt të foshnjave gjatë transportimit të tyre duke shmangur inkubatorët e rëndë dhe të kushtueshëm. E njëjta teknologji që përdoret në Formula Uno për të siguruar pilotët nga rreziqet e mundshme ndaj përplasjeve, po përdoret për të ndihmuar foshnjat e porsalindura duke i mbajtur të sigurt në ambulanca. Pajisjet hi-tech të transportit me fibra karboni, të quajtura BabyPod 20, janë projektuar me

një inxhinieri të avancuar të ekipit Williams të Formula One. Teknologjia e avancuar e kujdesit shëndetësor AHT, kërkoi nga ekipi Williams që të aplikojnë ekspertizën e tyre në sportin e Formulës 1 për të krijuar një mjedis të sigurt për foshnjat e porsalindura që kanë nevojë për transport të veçantë. Drejtori Teknik i inxhinierisë së avancuar, Paul McNamara

tha se ky projekt që po ndërmerret për të siguruar një platformë të lehtë dhe të fortë për transport të sigurt të foshnjave është e njëjta sfida që inxhinierët përpiqen të implementojnë në shasinë kryesore të makinave të Formula Uno-s. Transporti i foshnjave të porsalindura kërkon përdorimin e inkubatorëve të rëndë dhe që kanë nevojë për furnizim me energji

elektrike. Babypod 20 është projektuar për të siguruar mjedisin e duhur për foshnjat duke kursyer para dhe me mundësi për tu bashkangjitur çdo barrelë transporti, qoftë në karrocë ose në një ambulancë, makinë apo edhe helikopter. Drejtori i ekipit inxhinierik Williams tha se shumë risi që janë projektuar për makinat garuese të Formula Uno-s, po bëhen gjithnjë e më të përdorshme në makinat normale dhe ata duan që teknologjia e avancuar të përdoret në të gjitha fushat për përmirësimin e jetesës. Pajisjet Babypod 20 janë duke u përdorur tani nga shërbimi i menjëhershëm i transportit të fëmijëve në Britaninë e Madhe.

Ekipi i Williams shpreson në prodhimin e 500 pajisjeve Babypod gjatë vitit të parë.

Tu japësh fëmijëve një smartphone, është njësoj si t'u jepni një gram kokainë

Nëse u jepni fëmijëve tuaj një smartphone është "si t'u jepni një gram kokainë". E ka shpjeguar për The Independent Mandy Sailgari, një psikologe e varësive të përhershme dhe marrëdhënieve familjare. Dr. Sailgari është shefe e Klinikës së Rehabilitimit Harley Street Charter dhe dy të tretat e pacientëve të saj janë djem të moshës 16 deri 20 vjeç, por shumë janë edhe më të rinj. Gjatë dekadës së fundit, numri i adoleshentëve të ndih-

muar nga kjo strukturë është rritur në mënyrë eksponenciale. "Gjithmonë them se nëse i jepni një fëmijë të vogël një smartphone ose tabletë është sikur t'i jepni një shishë vere ose një gram kokainë", thotë terapistja, duke paralajmëruar prindërit për rreziqet e rrjeteve sociale. Shumica e pacientëve të saj janë vajza ndërmjet moshës 13 dhe 15 vjeç, të përfshira në të ashtuquajturën "sexting": dërgimi i imazheve seksualisht eksplicite,

përmes celularit të tyre. "Shumë vajza në veçanti janë të bindura se dërgimi i një fotoje lakuriq përmes smartphone-t të tyre është gjë normale," thotë psikologjia. Pak ditë më parë kishte hapur shumë diskutime lajmi për ekzistencën e një qendre detoksifikimi për smartphone dhe pajisje elektronike për adoleshentët amerikanë. Struktura ndodhet pranë Seattle dhe ofron ndihmë për të rinjtë që kalojnë shumicën e ditës para video-lojërave ose në in-

ternet. "Pse i kushtojmë më pak vëmendje këtyre gjërave sesa drogës apo alkoolit?", vazhdon Mandy Sailgari. "Të bindësh adoleshentët që të braktisin telefonin e tyre të mençur është shumë e komplikuar, për ta është një dorë e tretë, por nuk mendoj se është e pamundur, shkollat që u kërkojnë të rinjve të kalojnë kohë larg telefonit të tyre janë të shkëlqyera. Ju mund të mësoni vetëdijshëmimin e fëmijëve tuaj", përfundon doktoresha.





Përse dukemi më bukur para pasqyrës se sa në foto?

Para se të dilni nga shtëpia, në pasqyrë dukeni bukur, mirëpo fotografitë tregojnë diçka tjetër. Pra, kujt t'i besohet? Çdo person është ballafaquar me atë shfaqje në pasqyrë dhe në fotografi, nganjëherë madje as që ngajjnë. Por përse gjithmonë është kështu ndryshe? Çështja është që jeni të relaksuar kur shiheni në shtëpi, gjendeni në territorin tuaj dhe me siguri jeni në humor të mirë.

Pasqyra ju dërgon shfaqje të të gjitha emocioneve, të cilat pikërisht vetëm ju mund t'i shihni. Fotografia ju tregon pamjen e vërtetë, ashtu siç jeni, pa emocione dhe ndjenja të cilat ju shtohen në dukje. Në pasqyrë më së shpeshti shikoheni nga të njëjtat kënde, ndërsa në fotografi shfaqen nga kënde të ndryshme nga të cilat nuk jeni edhe aq të mësuar të shihni veten, andaj vetvetiu kur dikush ju fotografon, nuk jeni gjithmonë në pozën në të cilën e shihni veten më së miri. Çdo lokal ka ndriçim të ndryshëm, mirëpo çdo ndriçim ka temperaturën të cilën nuk e vëreni në shfaqje e pasqyrës, mirëpo i vëreni në fotografi.

Fotoaparati shënon të gjitha mangësitë të cilat ndriçimi i mirë di t'i theksojë. Në shfaqjen e pasqyrës më së shpeshti shihni versionin "ideal" të vetes, ndërsa fotografia tregon se si ju shohin të tjerët.

Ndiq mijëra fëmijë super t'zgjuar për katër dekada e gjysmë, dhe do të mësosh një apo dy gjëra se si të rrisni njerëz të suksesshëm. Një nga zbulimet më të mëdha: Edhe fëmijët me IQ të nivelit të gjenive, kanë nevojë për mësues, që t'i ndihmojnë ata të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Që nga fillimi i vitit 1971, "Studimi i Rinisë Matematikore të Parakohshme", ose SMPY, ka gjurmuar 5.000 fëmijë të zgjuar në Amerikë - 1%, 0.1% dhe madje 0.01% në krye të të gjithë nxënësve. Është studimi më i gjatë i fëmijëve të talentuar në histori. Ja se çfarë zbuloi studimi:

- 1%, 0.1% DHE 0.01% E FËMIJËVE NË MAJË, BËJNË NJË JETË TË JASHTËZAKONSHME. SMPY fillimisht i testoi fëmijët duke përdorur SAT, provime të hyrjes në universitete dhe teste të tjera të IQ. Më pas studiuesit nisën të shohin faktorë shtesë, si regjistrimi në kolegji dhe rrugët e karrierës më vonë në jetë. Ajo që zbuluan është se fëmijët me më shumë dhunti vazhduan të marrin doktorata dhe diploma, si dhe të mbajnë të drejta patentash, në një përqindje më të lartë se fëmijët me më pak dhunti. Shumica e tyre janë tek 5% me të ardhura më të larta. "Na pëlqen apo jo, këta njerëz vërtetë e kontrollojnë shoqërinë tonë", thotë Xhonatan Uai, psikolog në Programin e Identifikimit të Talenteve në Duke University.

- FËMIJËT GJENI NUK MARRIN VËMENDJE TË MJAFTUESHME. Problemi është se fëmijët gjeni shpesh marrin shumë pak vëmendje nga mësuesit e tyre, të cilët mund të jenë të prirur që të injorojnë studentët e spikatur, që tashmë e kanë përmbushur potencialin e tyre. Kur studiuesit e SMPY

Ç'mësuan psikologët kur studiuuan 5000 fëmijë gjeni



panë se sa shumë vëmendje u jepnin mësuesit këtyre fëmijëve të talentuar, ata gjetën se shumica dërrmuese e kohës së klasës ishte shpenzuar për të ndihmuar nxënësit me arritje të ulëta. SMPY sugjeron që mësuesit duhet të shmangin mësimin e një kurrikulumi "një masë për të gjithë", dhe në vend të kësaj të përqendrojnë përpjekjet për krijimin e planeve individuale të mësimit për studentët.

- KALIMI I NJË KLASË FUNKSIONON. Për të ndihmuar fëmijët të arrijnë potencialin, mësuesit dhe nxënësit duhet të konsiderojnë kalimin e një fëmije me dhunti një klasë më lart. Kur studiuesit krahasuan një grup kontrolli me studentët të talentuar të cilët nuk e kishin lënë pa bërë një klasë me ata që kishin kaluar menjëherë ma lart, këta të fundit kishin 60% më

shumë gjasa për të fituar patentat dhe doktorata - dhe më shumë se dy herë më shumë gjasa për të marrë doktoraturë në një fushë të lidhur me shkencën, teknologjinë, inxhinierinë ose matematikën.

- INTELIGJENCA VARION. Të jesh i zgjuar nuk do të thotë thjesht të kesh aftësi për të mësuar përmendsh fakte ose për të kujtuar emrat dhe datat. SMPY ka gjetur në mënyrë të përsëritur, gjatë analizave të shumëfishta, se disa nga fëmijët më të mençur posedojnë një kapacitet të madh për arsytetime hapësinore.

Këta fëmijë kanë një talent për sistemet e vizualizimit, të tilla si sistemi i qarkullimit tek njeriu ose anatomia e një Honda. Në vitin 2013, vëzhgimet e mëpasshme gjetën një lidhje të fortë midis aftësive të arsytimit

hapësinor dhe numrit të patentave të paraqitura, si dhe dokumenteve e publikuara të shqyrtuara nga kolegët.

- TESTET E STANDARTIZUAR NUK JANË GJITHMONË HUMBJE KOHE. Testet e standardizuara - SAT mbi të gjithë - nuk mund të matin çdo gjë që mësuesit dhe prindërit duhet të dinë për një fëmijë. Por të dhënat e SMPY sugjerojnë që SAT dhe të tjera teste të standardizuara të inteligjencës kanë një fuqi parashikuese - ndërkohë që sërish logjarisin faktorë si statusi socio-ekonomik dhe niveli i praktikës. Camilla Benbou, një nga studiueset në SMPY, tha se këto teste janë përdorur më së miri për të kuptuar se në cilën fushë fëmijët janë të mirë, në mënyrë që mësuesit të përqendrojnë vëmendjen e tyre në fusha të ndryshme.

A e dini çfarë i ndodh trupit kur fusni gishtin në kërthizë?



Me siguri, nga kureshtja, ndonjëherë ia keni futur vetes apo dikujt tjetër gishtin në kërthizë. Një veprim i tillë ndikon në traktin urinar. Kështu, mund jo vetëm të stimuloni dhe të nxisni indin e kërthizës por edhe indin e abdomenit i cili gjendet përreth tij. Me rastin e stimulimit të këtyre, dërgoni porosi deri te palca e kurrizit, e cila i dërgon sinjale traktit tuaj

urinar. Nëse do të kishim shtypur indin përreth kërthizës nuk do të kishim pasur të njëjtin efekt, sepse indi brena vetë kërthizës është i pandjeshëm. Për këtë arsye, kur prekim indin e kërthizës, stimulojmë indin në stomak i cili dërgon sinjale deri te palca kurrizit, ndërkaq ajo dërgon më tutje deri në tru informacionin që kemi nevojë të urinojmë.

Zbulohet mënyra efektive për ta shmangur sheqerin në kafe

Hulumtimi i publikuar në "Journal of Health Psychology" pohon se mënyra më e lehtë për ta larguar sheqerin prej kafesë është ta ndaloni përdorimin e tij. Shumica prej nesh i shtojmë kafesë sheqer, krem ose qumësht. Hulumtuesit kanë testuar mënyra të ndryshme për ta reduktuar sheqerin në kafe në 127 persona që pinë kafe çdo ditë. Adhuresit e kafesë u ndanë në tri grupe:

grupin e kontrollit i cili ndërpreu menjëherë pirjen e kafesë me sheqer, grupin i cili gradualisht e reduktoi sasinë e sheqerit, dhe grupin i cili me vetëdije pinte kafe me sheqer. Grupi i cili gradualisht e reduktoi sasinë e sheqerit në kafe duhej që gjatë dy javëve çdo ditë ta eliminojë sheqerin. U tregua se kjo metodë graduale funksionon në reduktimin e kripës në salcën e domateve, transmeton

Koha.net. Papritmas, në këtë rast, studiuesit zbuluan se reduktimi gradual i sheqerit në kafe në fakt i bëri njerëzit që çdo herë e më shumë të mos u pëlqejnë kafeja. Grupi i fundit e aplikoi teorinë e pirjes së vetëdijshme të kafesë. Të anketuarit duhej ta përqendrojnë vëmendjen e tyre të plotë në kafe. Ata e shikuan filxhanin me kafe, e ndjenin aromën dhe shijen derisa e pinin kafënë.

Ata duhej të bëheshin të vetëdijshëm për ndjenjat e reja dhe teksturën e kafesë. Rezultatet i habitën studiuesit të cilët supozonin se reduktimi gradual i sheqerit dhe pirja e vetëdijshme e kafesë do t'i ndihmonte të anketuarit që ta ndalonin përdorimin e sheqerit në kafe. Quditërisht, ndërprerja e thjeshtë e sheqerit në kafe u dëshmuua të jetë mënyra më efektive.






E rrallë! Udhëtimet e rrezikshme në Bangladesh

Shumë banorë të Bangladeshit çdo ditë udhëtojnë me trena, madje më saktë sipër tyre duke rrezikuar jetën e tyre. Duke qenë se numri i trenave është pamjaftueshëm, ndodh ky fenomen. Që nga viti 2006, fotografi


GMB Akash, ka realizuar fotografi të mjaft emocionuese të pasagjerëve të ndodhur mbi tren. Këtë album ai e ka titulluar “Nothing to Hold On To” (Kur s’ke ku mbahesh).




DASHI (20/III-20/IV)

 Puna dhe jeta private ju marrin shumë energji, por do t'ju dhurojnë edhe rezultate të kënaqshme. Mos humbni rastet për të udhëtuar e për të frekuentuar ambiente ku mund të bëni takimin e duhur.


DEMI (21/IV-20/V)

 Këshilla e vetme që ju jepet sot është të guxonit pa pasur frikë. Përgatituni të shfrytëzoni në avantazhin tuaj rastet e favorshme që ju ofron kjo ditë. Parashikohet një ngritje në detyrë, fillimi i një aktiviteti privat dhe suksese e mirënjohje në sektorin privat.


BINJAKËT (21/V-20/VI)

 Hëna te shenja e Shigjetarit nuk ju favorizon shumë. Grumbullimi i stresit mund t'ju bëjë të merrni vendime impulsive dhe të përballonit me një mospërfillje çështje që në dukje janë të thjeshta dhe banale.


GAFORRIA (21/VI-22/VII)

 Edhe pse keni një sërë ideash e projektesh në mendje, sot do të jetë mirë të ndaloni pak për të parë më mirë situatat. Në qoftë se vini në diskutim një situatë sentimentale, nuk ka asgjë të keqe, çdo marrëdhënie ka nevojë të analizohet.


LUANI (23/VII-22/VIII)

 Hëna te shenja e Shigjetarit, një shenjë zjarri si e juaja, do t'ju bëjë të gjeni më në fund kurajën për të mbrojtur parimet tuaja dhe për të zgjidhur me aftësi një çështje të vështirë. Le të flasim për punën.


VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)

 Yjet në kundërshtim me shenjën tuaj do t'ju bëjnë të kaloni shumë gjëra të pakëndshme. Do t'ju duhet të përballonit diçka të papritur ose një pengesë të vogël, por mos u trishtoni, sepse do të arrini të gjeni forcën e duhur për të kaluar këtë moment të vështirë.


PESHORJA (23/IX-22/X)

 Do të jenë shumë stimuluese influksat planetare të ditës së sotme. Mos e lejoni që kjo ditë t'ju ikë pa menduar për dashurinë. Do të jenë shumë të favorizuara udhëtimet, kontaktet me larg dhe aktivitetet sportive.


AKREPI (22/X-21/XII)

 Fantazia dhe organizimi sot do të jenë dy armët tuaja më të forta, ato që do t'ju lejojnë të kaloni me sukses situata të vështira dhe të risni të ardhurat tuaja. Flini disa orë më shumë dhe kaloni disa keqkuptime në jetën familjare.


SHIGJETARI (22/XI-21/XII)

 Ditë e shkëlqyer. Do të jetë kurioziteti motori që do t'ju shtyjë të kërkonit diçka të re, ose më stimuluese në aktivitetin tuaj profesional, të pasur me mundësi të mira në qoftë se merreni me tregji ose punoni në sektorin e komunikimit.


BRICJAPI (22/XII-20/I)

 Hyrja e Diellit te shenja e Peshqve ju dhuron energji, optimizëm dhe një shpirt të bukur krijues. Marrëdhënia me partnerin mund të paraqesë ndonjë vështirësi, por gjithsesi do të keni mundësi t'i zgjidhni gjërat shpejt.

UJORI (20/I-19/II)

 Me energjitë e mëdha psikofizike që keni mund të filloni një biznes ose një projekt që keni në mendje. Në mbrëmje, do t'ju lindë dëshira të kaloni momente të bukura me partnerin ose të argëtoheni me miqtë tuaj më të mirë.

PESHQIT (20/II-19/III)

 Sot, s'do të keni shumë kohë për argëtim dhe pushim, sepse Hëna është në kundërshtim me shenjën tuaj. Gjithashtu do të reflektoni mbi shumë gjëra dhe do të jenë të rëndësishme vendimet që do të merrni në sektorin profesional.



NE KETE DATE

2 TETOR 1951

Mensur Mamuti	KINEMATOGRAFI KOSOVAR NE FOTO	QENDISJE	FILM I EKREM KRYEZIUT, XHIRUES I TE CLIT ISHTE PERSONI NE FOTO	BEKOJ						
MIKU, JARANI										
QË KA TE BEJE ME UJIN										
KUSHDO, CILIDO										
REOMIRI		SHKRONJATË NJEPASNJESHME								
LARGOHEM, SHKOJ		FSHAT NE TETOVE		GRUP TETOVAR I ROKUT						
TUFË FLOKËSH QË U SHTOHEN GERSHETAVE PER TI ZGJATUR										
THIRRJE										
KOHA	NJË PLANET I PENDUAR	M	HUAMARRJE	VEGËL BUQËSORE, TRINA	QYTETANTIK N EAZINË E VOGËL	MBULESA E SIPERME E SHTEPISE				
DOKUMENTAR I KINEMATOGRAFIT NE FOTO						VANADIUMI				
PROFESIONI I KINEMAT. NE FOTO										
XH						FILLOVA				
ARSYE, SHKAK					HEROI SOKOLI					
BURIMI I FRYMEZIMIT POETIK (SH.)					NGJYRA E LEKURES SE FYTYRES				PORTUGALLIA	FENER
FLORIRI				IATI (ARAB.)					KAMPION	OZONI
ISH TRAINERI I BOKSIT, LAH				AUSTRIA						
								SAHAT		

ZGJIDHJET: SHOKU, UJOR, KËDO, R, IJ, IKI, KOJE, APPEL, M, ÇATI, PEHLIVANËT, XHIRUES, NISA, SHKAS, MIC, P, MUZAT, KAFE, ARI, EBU, AS, NIMANI, ORË.

Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

		5	7	8	9							6			3	9		
		4	5		6							1	5		7	8		
			4		1		2					6	5					
9	6	2					8	1	7						6	2	1	
4									6			6					8	
7	5	1					2	4	3			1	4	8				
			1		5								3		4		2	5
			9	8		3	6					8			2			6
			6	9	2	7						7			1			

Shumë i lehtë: 215789364, 394526178, 687431925, 962354817, 438217596, 751968243, 826175439, 179843652, 543692781. Mesatar: 487162539, 215937846, 396854712, 579483621, 623591478, 148726395, 931648257, 854279163, 762315984.



Zbulohet helm në ushqimin e foshnjave

Në disa markete në qytetin Friedrichshafen në kufirin jugor të Gjermanisë është zbuluar se ushqimi i foshnjave është përzier me helm. Sipas mediave gjermane, si rezultat i kontrolleve të bëra në mostrat e marra nga ushqimet e foshnjave të kompanive të ndryshme që shiten nëpër markete, është zbuluar se në këto ushqime ka përbajtur helm në sasi që



mund të shkaktojë rrezik për jetën e foshnjave. Në letrat kërcënuese

të dërguara në zinxhirin e dyqaneve si Aldi, Rossmann, Lidl, DM, Müller, Edeka, Norma dhe Rewe thuhet se në rast se nuk dërgojnë 10 milionë euro do të vazhdojnë t'i shtojnë helm ushqimeve të foshnjave. Policia filloi hetimet lidhur me personin apo personat të cilët kanë bërë shantazhe. Ushqimet e foshnjave në marketet në fjalë janë konfiskuar.

KALENDARI HISTORIK 2 TETOR

976 - Hisham II shpallet kalif i Kordobës.
1492 - Mbreti Henry VII i Anglisë pushton Francën.
1540 - Venediku dhe Turqia nënshkruajnë marrëveshje për paqe.
1853 - Austria ndalon hebrenjtë për të poseduar truall.
1924 - Lidhja e Kombeve aprovon protokollet e Gjenevës.
1935 - Armata italiane e Musolinit sulmon Abisininë (Etiopinë).
1941 - Gjermanët iniciojnë sulm ndaj Moskës.
1949 - BRSS njih Republikën Popullore të Kinës.



1986 - Tentim vrasja e dështuar ndaj Kryeministrit indian Raxhiv Gandi.
2001 - NATO vendosë të mbështetë SHBA në sulmet ushtarake pas 11 shtatorit.
2009 - Rio de Zhaneiro zgjidhet qyteti nikoqir i Lojërave Olimpikë Verore në vitin 2016.

A E DINI SE...



Teknologjia e kohës moderne i bën fëmijët më të aftë që të përdorin një telefon të mençur, mirëpo a po ndikon në zhvillimin e syve të tyre? Përderisa gjithmonë janë dhënë këshilla që fëmijët të shohin TV nga larg, të mos qëndrojnë pranë ekranit të kompjuterit gjatë etj. Së fundmi disa studime kanë gjetur që fëmijët kanë nevojë që të qëndrojnë më gjatë jashtë shtëpisë, nën dritën natyrale. Qëndrimi jashtë në natyrë i fëmijëve ka një efekt mbrojtës dhe ulë gjasat që një fëmijë të ketë nevojë për korigjim në të pamurit dritëshkurtër në të ardhmen. Problemet me të pamurit dritëshkurtër nënkuptojnë kur nuk i shihni gjërat qartë larg, përderisa afër e keni shikimin normal.



Kafeteria në Londër nuk e shërben shqiptarin për shkak të rrobave

Një ndërtimtar shqiptar është përjashtuar nga një kafeteri në Londër për shkak të rrobave të tij. Alban Saiti 35-vjeçar provoi të merre një kafe në "Raoul's", por një gjë e tillë nuk iu lejua "sepse kishte rroba të ndyta". "Ne nuk mund të ju shërbejmë juve. Ju jeni të ndytë", i kishte thënë kamerieri Saitit, transmeton Koha.net. Kosovari ka thënë për "The Sun" se i ishte përgjigjur menjëherë kamerierit sepse ishte ndërje

shumë keq. "I thash 'Unë nuk punoj në një zyre, jam ndërtimtar. Çfarë duhet të bëj, të zhvishem?'". Saiti thotë se ka jetuar në Londër që 20 vjet dhe se nuk është poshtëruar kurrë kaq keq në jetën e vet. Ndërkohë pronarja e kafeterisë, Geraldine Leventis ka thënë se "Saiti nuk ishte i pistë, por kishte rroba të ndërtimtarëve me njolla në pantallona". "Nuk po them asgjë kundër, por në të kaluarën kemi pasur ndërtimtarë që kanë ardhur



dhe i kemi kthyer sepse kanë pasur rroba të ndërtimtarëve. Njerëzit e kundërshtojnë atë vendim. Por ne nuk i largojmë njerëzit pa arsye. Kërkojmë falje nëse kjo nxjerr probleme", ka thënë ajo.

Kujdes me reçipetat! Ja çfarë thonë ekspertët

Recipetat janë ndër aksesorët më të rëndësishëm të gratë. Së fundmi ato janë të shumëllojshme; me xhel, pa rripa, me mbushje. Por, në fakt recipetat nuk duhen mbajtur tërë kohën veshur pasi nuk i bëjnë aspak mirë gjoksit, madje sjellin shumë dëme. Brightside sjell disa fakte për të treguar se çfarë ndodh kur mbajmë gjithë kohën recipeta (mund të ketë edhe femra që i mbajnë natë, kur flenë). Mbajtja e recipetave gjatë gjithë kohës shkakton dobësimin e



muskujeve të gjoksit. Kjo bën që gjoksi të bjerë, të shkaktojë të çara të vogla e të zbutet. Nëse mbani recipeta gjatë gjithë kohës

elasticiteti natyral i lëkurës rritet. Studiuesit kanë vërtetuar se ekziston një lidhje e fortë e recipetave me gjendjen e

gjoksit. Pothuajse 90% e grave të diagnostikuara me ndryshime 'brocystic' patën përmirësime kur hoqën dorë nga recipetat, dhe ato i zëvendësuan me kanatjere pambuku. Recipetat sjellin edhe dhimbje qafe dhe muskujsh në shpinë. Kjo, pasi rripi i recipetave bllokoi qarkullimin e gjakut dhe bën të kontraktohen muskujt. Prandaj ka ardhur momenti që të hiqni për pak kohë dorë nga recipetat. Para se të vishni kanatjeren mos harroni t'i masazhoni!

BARSOLETA



FJALËKRYQI DHE POLICI

Ja si e zgjidh fjalëkryqin polici:

1. Veshje solemne (2 shkronja) - zi
2. Thirrje telefonike (3 shkronja) - xrr
3. Qytet në Itali (3 shkronja) - Rom
4. Lloj kafshe me shtëpizë (3 shkronja) - qen
5. Shihe foton (5 shkronja) - e pashë
6. Vëllai i gruas (5 shkronja) - Arben
7. Armë e ftohtë (7 shkronja) - pendrek
8. Pija më e shëndetshme (4 shkronja) - birra
9. Sëmundje e pashërueshme (6 shkronja) - vdekja
10. Prodhim i pulës (4 shkronja) - supa
11. Bashkëjetesa e burrit dhe gruas (6 shkronja) - banesa
12. Masa për vlerësimin e gurëve të çmuar (6 shkronja) - paraja
13. Burri i motrës (3 shkronja) - Ali

THËNIA E DITËS

Nuk ka rëndësi si ndihesh sot, ngrihu, vishu dhe shfaqu...!
(Paulo Coelho)

